

Msc. Eneida Pema

Dr. Irida Hoti

LIBËR PËR MËSUESIN
Gjuha shqipe 11

BOTIME



Përmbajtje

| | |
|--|-----|
| Hyrje | 5 |
| Program lëndor | 6 |
| Plani sintetik gjuhë shqipe XI | 13 |
| Testojmë njohuritë gramatikore nga klasa X | 17 |
| Moduli I | 20 |
| Moduli II | 42 |
| Moduli III | 64 |
| Testojmë njohuritë gramatikore | 70 |
| Moduli IV | 90 |
| Testojmë njohuritë gramatikore | |
| Moduli V | 120 |
| Testojmë njohuritë gramatikore | 150 |

Mësues të dashur!

Ky libër mësuesi ju vjen në ndihmë në punën tuaj të përditshme, me anë të planifikimeve dhe udhëzimeve që ofron. Udhëzimet e tij bazohen në programin e IZHA-s, miratuar nga MAS-i. Libri i mësuesit, ashtu si edhe vetë teksti mësimor, janë hartuar në frymën e të nxënit me kompetenca. Ju do t'i orientoni nxënësit tuaj drejt krijimit të kompetencave, drejt punës kërkimore, gjetjes dhe zgjidhjes së situatave problemore.

Përveç udhëzimeve që të ofron dhe të detyron programi mësimor, në këtë libër sugjerohen planifikimet vjetore, 3-mujore dhe ditore. Ju mund t'u përmbaheni atyre planifikimeve, por jeni të lirë të bëni planifikimet tuaja, në përputhje me kërkesat e programit dhe nivelin e nxënësve tuaj.

Mirëpresim çdo këshillë dhe mendim nga ju.

Punë të mbarë!

Programi lëndor

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Në arsimin e mesëm të lartë, kjo fushë përbëhet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Letërsi, Gjuhë e huaj e parë dhe Gjuhë e huaj e dytë. Të gjitha lëndët e kësaj fushe synojnë zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës. Lënda e gjuhës shqipe ka një rëndësi të veçantë në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë.

Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit:

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime rreth sistemit gjuhësor të

shqipes;

- fitojnë njohuri dhe demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar në mënyrën e duhur (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit).

Lënda e gjuhës shqipe, gjithashtu, siguron mundësi që nxënësit të ndiejnë fuqinë e gjuhës si një mënyrë për të shprehur përvojat e tyre dhe për të shmangur vështirësitë që ndajnë individët. Nxënësit, gjatë zhvillimit të kësaj lënde, ndërtojnë dhe zhvillojnë kompetencat gjuhësore, në mënyrë që të bëhen anëtarë kritikë dhe aktivë në shoqëri. Duke u mbështetur në studimin e teksteve të llojeve dhe tematikave të ndryshme, programi nxit vlerësimin e trashëgimisë së pasur kulturore dhe letrare. Nëpërmjet këtyre teksteve, nxënësit dallojnë dhe vlerësojnë jo vetëm strukturën dhe karakteristikat e vetë teksteve, por edhe mesazhet dhe kuptimet e tyre.

Gjuha shqipe, si çdo lëndë tjetër, mundëson zotërimin e kompetencave kyçe, të përcaktuara në kornizën kurrikulare. Këto kompetenca janë të domosdoshme për një individ, i cili duhet të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Këtë “mision” lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Duke u bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës, pesë kompetencat e saj janë:

- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Të lexuarit e teksteve të ndryshme
- Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Puna për ndërtimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave lëndore ka nisur që në arsimin bazë. Në këtë cikël arsimit, nxënësit janë pajisur me njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për jetën dhe për tregun e punës. Mirëpo kompetenca zhvillohet dhe përsoset gjatë gjithë jetës dhe nuk ka pikëmbërritje. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përballen me sfida të reja. P.sh., nga kontekste familjare dhe informale (me shokët e shoqet e klasës dhe me mësuesit), nxënësit tani do të flasin e do të diskutojnë në kontekste më formale (në një debat në shkollë, në aktivitete me mësues, në veprimtari të

ndryshme) dhe do të ushtrohen edhe për të folurit në publik.

Programi i gjuhës shqipe bazohet në parimin e integritetit të njohurive dhe në parimin e rimarrjes së tyre, vit pas viti, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato.

Qëllimet e lëndës së Gjuhës shqipe

Lënda e gjuhës shqipe synon t'u japë nxënësve mundësi që:

- të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për gjuhën dhe komunikimin;
- të pasurojnë fjalorin e tyre, të fitojnë njohuri gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit, të zbatojnë rregullat e gjuhës së folur dhe të shkruar, si dhe të krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme me leximin, nëpërmjet të cilit fitojnë kënaqësi dhe marrin informacion;
- të diskutojnë dhe të ndërveprojnë me të tjerët, të komunikojnë, të shprehin qartë dhe të argumentojnë mendimet dhe idetë e tyre, të zotërojnë “artin” e të folurit dhe të dëgjuarit, të marrin pjesë në diskutime dhe në debate të ndryshme, duke dhënë kontributin e tyre në të gjitha fushat e jetës;
- të përvetësojnë aftësitë e duhura për të analizuar, për të interpretuar, për të vlerësuar dhe për të prodhuar tekste për një larmi funksionesh, të zbatojnë njohuritë dhe strategjitë e procesit të të lexuarit për t'u bërë lexues të pavarur, si dhe për të kuptuar dhe për të gjykuar tekste dhe materiale të llojeve të ndryshme;
- interpretojnë dhe vlerësojnë informacione të ndryshme për botën në përgjithësi.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*).

Nxënësi:

- shprehet, përmes një forme komunikimi, për një temë të caktuar në një material (prezantim) prej 200 fjalësh dhe veçon çështjet kryesore të ngritura në atë material;
- diskuton në grup, jo më shumë se 10 minuta, duke dhënë dhe duke marrë informacion për një temë të caktuar nga fushat e të nxënit ose nga jeta e përditshme;
- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej 3 paragrafësh, u përgjigjet pyetjeve të shtruara për llojin e tekstit dhe stilet e të shkruarit;
- përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës në kontekste dhe forma të ndryshme të shkrimit, si: ese, *e-mail* (postë elektronike), letër formale dhe joformale etj.;
- shkruan një tekst për një temë nga jeta e përditshme, me 3 paragrafë, duke respektuar strukturën, drejtshkrimin dhe elementet e tjera, pastaj e prezanton para të tjerëve me shqiptim të drejtë;
- shkruan një ese, jo më shumë se dy faqe, për vlerat estetike të pjesëve të caktuara artistike (poezi, prozë, pjesë muzikore, pjesë arti, vallëzim etj.), duke respektuar organizimin dhe hapat e shkrimit të një eseje;
- prezanton një projekt artistik, humanitar, eksperimentues etj. nga fusha të ndryshme mësimore, të hartuar individualisht dhe në grup, duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe teknologji të tjera.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

Nxënësi:

- prezanton, në forma të ndryshme të të shprehurit, mënyrën e grumbullimit, të zgjedhjes dhe të klasifikimit të informacioneve për një temë të caktuar, ofron argumente për zhvillimet aktuale lidhur me temën përkatëse (p.sh.: temë nga shkenca, nga kultura, nga arti, nga sporti etj.);
- krahason, të paktën, tri burime të ndryshme të informacionit për trajtimin e së njëjtës temë, i prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse, duke përdorur TIK-un;
- modelon zgjidhjen e një problemi të dhënë (në klasë apo jashtë saj) për një temë të caktuar nga një fushë mësimore;
- krijon një vepër artistike me pamje dy- dhe tredimensionale me mesazhe nga një fushë mësimore.

Kompetenca e të nxënit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

Nxënësi:

- demonstroi shkathtësi funksionale në lexim-shkrim, në jetën e përditshme, në përmbushjen e kërkesave të ndryshme për kryerjen e një detyre apo aktiviteti dhe gjatë të nxënit të dijeve të reja në ndonjë fushë të caktuar mësimore;
- shfrytëzon, në mënyrë efektive, përvojat paraprake gjatë zgjidhjes së situatave të ndryshme në jetën e përditshme;
- përgatit me sukses një përmbledhje të dosjes personale (portofolit), për vetëvlerësimin e përparimit të vet në një fushë mësimore të caktuar, dhe veçon disa nevoja të domosdoshme për përmirësimin e avancimit të mëtejshëm;
- paraqet idetë personale para të tjerëve për mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti të caktuar, duke dhënë mendime në formë skice, grafiku, vizatimi etj.;
- shfrytëzon, në mënyrë të pavarur, udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni për të kryer një veprim, aktivitet, detyrë, sipas qëllimeve që i cakton vetes.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

Nxënësi:

- harton një projekt duke shkëmbyer informacion me të tjerët, duke u konsultuar me ta dhe duke i informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar e vlerësuar burimet njerëzore, materiale e monetare, në përputhje me rezultatet e pritshme;
- analizon gjendjen e mjedisit (në klasë, në shkollë, në komunitet apo më gjerë) dhe pasojat e ndotjes, propozon alternativa për mbikëqyrje dhe menaxhim të drejtë të gjendjes së vlerësuar më të ndjeshme;
- merr pjesë në aktivitete të ndryshme në nivel klase, shkolle, bashkie dhe më gjerë (p.sh., konkurse mësimore, gara sportive, aktivitete kulturore, muzikore etj.), diskuton me të tjerët për rezultatet e arritura dhe për procesin e organizimit dhe jep argumente në forma të ndryshme shprehëse se si të rritet pjesëmarrja në aktivitete dhe si të përmirësohet procesi i organizimit të tyre.

Nxënësi:

- analizon përparësitë dhe dobësitë personale duke evidentuar masat përmes të cilave

synon të mbështetë avancimin personal;

- merr pjesë aktivisht në lojëra, në gara sportive dhe në aktivitete të tjera kulturore, duke menaxhuar emocionet e veta;
- ilustron, me shembuj para të tjerëve, modelet/praktikat e sjelljeve që reflektojnë mënyrat e mbrojtjes dhe të kultivimit të kulturës së vet, vlerave, besimeve dhe kulturave të të tjerëve në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj së mirës së përbashkët*)

Nxënësi:

- demonstroi shembuj të pjesëmarrjes demokratike dhe drejton forma të ndryshme të diskutimit për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes demokratike në nivele të ndryshme (p.sh., në familje, në shkollë, në komunitet, në nivel vendor dhe qendror);
- demonstroi veprime të ndryshme që shprehin tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve në komunitetin ku jeton (në klasë, në shkollë, në lagje dhe me gjerë);
- diskuton me të tjerët dhe paraqet interesin personal për çështje publike, shoqërore, historike, natyrore etj.

Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

Nxënësi:

- përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive;
- përdor mjetet digjitale për të përpunuar, krijuar, realizuar dhe demonstruar tema mësimore nëpërmjet pamjeve të filmuara apo të animuara;
- gjen, organizon, analizon, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- zhvillon aftësitë krijuese, duke zbatuar njohuritë e marra në shkencën kompjuterike dhe mediat digjitale.

Lidhja e Gjuhës shqipe me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema që integrojnë fushat e të nxënës dhe që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë e të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në kornizën kurrikulare janë përcaktuar temat ndërkurrikulare të mëposhtme.

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrja morale
- Bashkëjetesa paqësore

Mësimi i gjuhës shqipe, për specifikat dhe hapësirat që ka, lejon krijimin e situatave mësimore nëpërmjet të cilave mundësohet trajtimi i këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme zhvillojnë te nxënësit identitetin kombëtar, si dhe njohjen e vlerësimit të kulturës botërore. Tema, si të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve

në grup që mund të zhvillohen gjatë orëve mësimore. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore gjatë të cilave nxënësit shprehën në forma të ndryshme: ese dhe shkrime e krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe, të zhvilluara në lëndën e gjuhës e shqipe, ndihmojnë aftësimin e nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

Lidhja e Gjuhës shqipe me fushat e tjera të të nxënit

Gjuha shqipe, duke qenë jo vetëm disiplinë, por edhe gjuhë e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënit, ka lidhje të qarta dhe plotësuese me fushat dhe lëndët e tjera mësimore.

Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe lidhet me lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”:

- Letërsia i ofron gjuhës një model të përsosur të përdorimit të gjuhës, ndërsa studimi i gjuhëve të huaja siguron transferimin e njohurive gjuhësore nga një lëndë në një tjetër, por edhe vlerësimin e mundësive shprehëse të gjuhës shqipe.

- Lënda e gjuhës shqipe (aftësitë e të lexuarit) mbështet kuptimin e ushtrimeve dhe të **teksteve matematikore**. Kjo lëndë është e nevojshme për formimin e koncepteve dhe proceseve matematikore. Aftësitë e mira gjuhësore e lejojnë nxënësin të përmirësojë elementet pamore, përfshirë edhe organizimin e grafikëve të informacionit, planifikimin, organizimin e ideve dhe përcaktimin e një procedure; të dyja lëndët e ndihmojnë nxënësin të zhvillojë aftësinë për të paraqitur një argument ose për të kryer një analizë nga këndvështrime të ndryshme; të dyja lëndët përdorin një qasje deduktive.

- Kuptimi ose analiza e teksteve **të shkencave të natyrës** kërkon aftësi të mira leximi. Po kështu, p.sh., leximi i një teksti i ndihmon nxënësit të marrin njohuri rreth natyrës, siç njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.

- Në mënyrë të veçantë, lënda e gjuhës shqipe është e lidhur me **historinë dhe shkencat shoqërore**, përderisa të gjitha tekstet që studiohen nga nxënësit kanë një kontekst historik dhe socio-kulturor.

- Mësimi i **arteve** të ndryshme mbështetet nga lënda e gjuhës shqipe. Kështu, analiza e teksteve të ndryshme me tematikë nga arti ndihmon nxënësit për lëndët e arteve. Gjithashtu, studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme, si p.sh., i reklamave, kërkon integrim me artet për elementet pamore të reklamave etj. Duke pasur parasysh gjithçka më sipër, mësuesit, me pasion dhe përkushtim, mund të realizojnë pa fund integritime mes fushave dhe lëndëve në situata të ndryshme të nxëni. Ky integrim i lejon nxënësit të mos marrin njohuri të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta.

Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Puna për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës nuk është e copëzuar dhe fragmentare. Çdo orë mësimore kontribuon për to.

Kompetencat ndërlidhen dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Kështu, kompetenca e të lexuarit të teksteve të ndryshme (njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e kësaj kompetence) ndikon në aftësimin e nxënësve për të shkruar, ndërsa formimi i nxënësve rreth sistemit gjuhësor të shqipes ndikon në

zhvillimin e kompetencave të tjera. Më poshtë janë dhënë përshkrimet e kompetencave të lëndës.

a) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Të folurit është mjeti themelor i komunikimit me të tjerët dhe gur themeli i të mësuarit në të gjitha lëndët mësimore. Duke folur dhe duke biseduar, nxënësit jo vetëm japin informacion, por edhe sqarojnë kuptimin dhe domethënien e koncepteve të ndryshme, identifikojnë dhe zgjidhin probleme, zgjerojnë njohuritë, si dhe shprehin mendimet, ndjenjat e opinionet e tyre. Kur ata diskutojnë rreth një informacioni, njohin dhe pranojnë edhe këndvështrimet e bashkëbiseduesve të tjerë, si dhe mjetet gjuhësore apo stilin që ata

përdorin. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre për të komunikuar dhe për të prezantuar ide në klasë dhe në situata formale. Nëpërmjet këtyre situatave, nxënësit aftësohen edhe për të folurit në publik. Ata mësojnë të flasin qartë, bindshëm e me vetëbesim dhe të jenë tërheqës për të tjerët:

- duke përdorur gjuhën standarde, sidomos kur këtë e dikton situata dhe dëgjuesit;
- duke diskutuar në grupe të vogla dhe të mëdha, duke marrë role të ndryshme në menaxhimin dhe në moderimin e diskutimeve e të debateve, si dhe duke përfshirë e angazhuar të tjerët për të përmbushur afatet e qëllimet;
- duke respektuar, gjatë prezantimeve me gojë, karakteristikat e një fjalimi, shpjegimi, raportimi, debati etj.;
- duke përzgjedhur fjalët e fjalitë e përshtatshme dhe duke përdorur mjete retorike e të figurshme;
- duke përdorur dhe duke vlerësuar TIK-un gjatë prezantimeve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj.

b) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, nxënësit reflektojnë ndaj informacioneve të llojeve dhe të fushave të ndryshme; përmbledhin, parafrzojnë dhe vlerësojnë përmbajtjen e informacionit të dëgjuar; analizojnë stilin dhe strukturën e një fjalie ose të një teksti të dëgjuar; përqendrohen te folësi, diskutojnë dhe zgjerojnë idetë e dëgjuara; mbajnë shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm etj.

c) Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Edhe pse disa nxënës që hyjnë në klasën e njëmbëdhjetë, janë lexues të pavarur, shumë prej tyre mund të kenë nevojë për mbështetje, me qëllim që të zhvillojnë më tej aftësitë në lexim.

Pra, ky proces duhet të vijojë edhe në arsimin e mesëm të lartë.

Përveç kësaj, të gjithë nxënësit përballen me sfidat që shtrën programi i gjuhës shqipe, i cili kërkon nga nxënësit të përvetësojnë koncepte gjithnjë e më abstrakte, të përdorin struktura gjuhësore më komplekse, si dhe të kenë fjalor më të pasur se në arsimin bazë. Lënda e gjuhës shqipe i ndihmon nxënësit që të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues aktiv dhe kritik është ai që jo vetëm i kupton njohuritë në një tekst, por edhe i përdor ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë, nxënësit zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit, si dhe njihen me një shumëllojshmëri

tekstesh. Njohja me tekste të ndryshme u jep mundësinë nxënësve që të zbulojnë interesat dhe priret e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e karrierës së tyre.

d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Të shkruarit u jep mundësi nxënësve të mësojnë për veten e tyre dhe të lidhen me botën. Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë, duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit. Gjatë tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe për zgjedhin ide për të shkruar për qëllime, audienca dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Nxënësit zbatojnë gjatë të shkruarit karakteristikat e teksteve dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore.

e) Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësim dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Ata i konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen ta përdorin gjuhën saktë dhe brenda rregullave gramatikore. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre, për të folur qartë dhe saktë, për të gjykuar gjuhën e një teksti që dëgjojnë ose lexojnë etj. Në këtë cikël, nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatojnë rregullat drejtshkrimore dhe të pikësimit.

PLANI SINTETIK GJUHË SHQIPE XI

| | |
|--------------------------------|--------|
| Njohuri të reja | 49 orë |
| Përpunim njohurish | 23 orë |
| Projekt 4 orë Testime 3 orë | |
| Gjithsej | 72 orë |

Fusha: GJUHA DHE KOMUNIKIMI*Lënda: Gjuhë Shqipe**Shkalla: 5**Klasa: XI**Viti shkollor: 2017-2018***PLANI ANALITIK PËR TREMUJORIN E PARË (SHTATOR – DHJETOR)**

| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe | | | | |
|---|-----------------------|---------------------|--|--|
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës | | | | |
| Nr | Kompetenca / Tematika | Temat mësimore | Situata e të nxënit | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve |
| | | MODULI I | | |
| 1 | Të lexuarit | Tekstet përshkruese | Lexohen paragrafë të ndryshëm përshkrues dhe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit lidhur me objektet dhe mënyrat e përshkrimit. | Përvijim i mendimit, Të nxënit ndërveprues, Stuhi mendimi, Hartë konceptesh, Diagram Veni, Punë në grup, Praktike e drejtuar |
| | | | | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime, - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit. |
| | | | | Materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimit, libri i nxënësit, tabela, shkumësa me ngjyra. |

| | | | | | | |
|---|--------------------|--|---|--|---|--|
| 2 | Të lexuarit | Analizë: Tekst përshkruar i një vendi | Prezantim i shkurtër rreth vlerave të përshkrimit të Konicës në veprën nga është marrë pjesa. | Të nxënit ndërveprues Prezantim filmik, Lexim me ndalesa, Praktikë e drejtuar, Punë në grupe | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit, pas zhvillimit të punës në grupe. | Materiale të shtypit të shkruar, albume me pamje nga Shqipëria, libri i nxënësit. |
| 3 | Morfologji | Përemrat, llojet e tyre | Teksti “Shqipëria - Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore” | Puna me fisha, Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë në grup | Vlerësim për dallimin dhe përdorimin e saktë të përemrave. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, fisha, tabelë. |
| 4 | Të lexuarit | Analizë: Tekst përshkruar i një objekti | | Të nxënit ndërveprues, Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë në grupe | Vlerësim për: - diskutimin e ushtrimeve të punuara; - analizën e tekstit përshkruar të një objekti; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit. | Materiale të shtypit të shkruar, albume fotografike, libri i nxënësit, tabela, shkumës me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 5 | Morfologji | Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara | Teksti “Shtëpitë shqiptare” | Punë në grup | Vlerësim për: - dallimin e trajtave të shkurtra dhe të shkurtra të bashkuara, - shpjegimin e përdorimit të tyre. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë. |

| | | | | | | |
|---|---------------------|-------------------------------------|--|---|---|---|
| 6 | Morfologji | Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Stuhi mendimi, Punë në grup | Vlerësim për: - dallimin e rasteve të gabuara të përdorimit të trajtave të shkurtra dhe të shkurtra të bashkuara. - përdorimin e saktë në fjali si nyje dhe si trajta të shkurtra të: <i>të, i, e</i> . | Teksti mësimor, bllok gramatike, tabelë. |
| 7 | Të shkruarit | Përshkrimi i një vendi | Lexohen paragrafë të ndryshëm përshkruan dhe vërehen teknikat e shkrimit, mbietrat e përdorur. | Të nxënësit ndërveprues Stuhi mendimi, Hartë konceptesh, Punë në grup. | Vlerësim për: - shkrimin e esesë sipas formatit të kërkuar; - fjalorin e përdorur gjatë shkrimit të esesë; - përdorimin e mjeteve stilistike në paragrafët subjektivë përshkrues. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>flipchart</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 8 | Të shkruarit | Përshkrimi i një vendi | | | | |
| 9 | Leksikologji | Sinonimet | Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe | Stuhi mendimi, DDM | Vlerësim për dallimin e fjalëve sinonime që kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt, përcaktojnë se nga dallohen sinonimet ndërmjet tyre. | Teksti mësimor, videoprojektor, skeda, bllok gramatike, tabelë, “Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe”, “Si të shkruajmë shqip”. |

| | | | | | | |
|----|--------------|---|--|--|---|--|
| 10 | Të dëgjuarit | Rëndësia e të dëgjuarit në komunikimin njerëzor | Dëgjojen sekuenca lajmesh, leksionesh, tregimesh. Nga nxënësit kërkohet të ndjekin me vëmendje dhe të riprodhojnë informacionin e dëgjuar. | Diskutim njohurish paraprake, Stuhi mendimi, Punë në grup, Leksion i përqendruar, Përmbledhje e strukturuar, Shkrim i shpejtë/Rishikim | Vlerësim për - tregimin e respektit, empatisë (ndjeshmërisë) dhe interesit ndaj folësit; - demonstrimin e vullnetit gjatë kryerjes së detyrave; - përdorimin e imagjinatës dhe kreativitetit për zgjidhjen e problemeve së të tjerëve. | Materiale dëgjimore, CD, libri i nxënësit, tabela, <i>sleep-charter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 11 | Të lexuarit | MODULI II Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve rrëfyese | Lexohen fragmente të teksteve rrëfyese dhe diskutohet rreth veçorive të tyre. | Përvijim i mendimit, Të nxënësit ndërvetësues, Stuhi mendimi, Hartë semantike, Diagram Veni, Punë në grup, Përmbledhje e strukturuar. | Vlerësim për - pjesëmarrjen në diskutime; - materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>sleepcharter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 12 | Të lexuarit | Teknikat e shkrimit të kronikës, ditarit, biografisë dhe autobiografisë | Lexohen shembuj të ndryshëm të autobiografisë, biografisë, kronikës dhe ditarit. | Stuhi mendimi, Hartë semantike, Punë e pavarur, Praktikë e drejtuar, Përmbledhje sintetike. | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>sleep-charter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |

| | | | | | | |
|-----------|---------------------|---|--|---|--|--|
| 13 | Të lexuarit | Analizë teksti rrëfyes | Paraqitet një material i shkurtër për jetën dhe veprën e Eqrem Çabejit. | Diskutim paraprak i njohurive, Stuhi mendimi, Hartë konceptesh, Punë në grup. | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit. | Materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimit, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa. |
| 14 | Drejtshkrim | Shkrimi i citimeve | Vepra letrare “Don Kishoti i Mancës” | Puna me fisha, Punë në grup | Vlerësim për dallimin e citimit dhe shkrimin tij, duke përdorur shenjat e duhura të pikësimit. | Teksti mësimor, videoprojektor, fisha, skemë, tabelë, “ <i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe</i> ”, “ <i>Të shkruarit akademik - ide, koncepte, modele</i> ”. |
| 15 | Drejtshkrim | Shkrimi i citimeve | Vepra letrare, shkrime nga interneti. | Stuhi mendimi, Punë në grup | Vlerësim për gjetjen e gabimeve gjuhësore te fragmentet e shkëputura nga librat apo në faqe interneti. | Teksti mësimor, videoprojektor, tabelë, vepra letrare, shkrime nga interneti. |
| 16 | Të dëgjuarit | Strategji dhe teknika për t’u bërë një dëgjues i mirë | Dëgjohen sekuenca të ndryshme tekstesh joletrare dhe u kërkohet nxënësve të mbajnë shënime gjatë dëgjimit. | Stuhi mendimi, Leksion i përqendruar, Organizues grafik, Punë në grupe. | Vlerësim për: - vëmendjen ndaj mesazhit që dëgjojnë; - analizën e qëllimit të informacionit që dëgjojnë; - mbajtjen e shënimeve korrekte rreth materialit të dëgjuar. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra. |

| | | | | | | |
|-----------|---------------------|----------------------------|--|---|---|--|
| 17 | Morfologji | Lakimi i përemrave pronorë | Teksti: “Biografia e Eqrem Çabej”. | Punë në grup | Vlerësim për: - dallimin e përemrave vetorë, rasën dhe vetën e tyre; - përdorimet e gabuara të përemrave pronorë. | Teksti mësimor, videoprojektor, skedë, bllok gramatike, tabelë. |
| 18 | Të shkruarit | Kronika | Lexohen modele kronikash të llojeve të ndryshme. | Stuhi mendimi, Praktikë e drejtuar, Organizues grafik, Punë në grup. | Vlerësim për: - realizimin e hapave të përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, - përdorimin e strategjive të ndryshme për të planifikuar shkrimin, organizimin në mënyrë logjike të mendimeve dhe të ideve; - redaktimin e shkrimit duke përdorur edhe mendimet e të tjerëve; - të shkruarit e qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike. | Modele kronikash, libri i nxënësit, tabela, <i>fleepcharter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 19 | Të shkruarit | Kronika | Lexohen modele kronikash të llojeve të ndryshme. | | | |

| | | | | | | |
|----|--------------------|---|---|---|---|---|
| 20 | Sintaksë | Gjymtyrët e dyta dhe klasifikimi i tyre | | Skelet peshku, Stuhi mendimi, Diagram Veni | Vlerësim për: - dallimin e gjymtyrëve kryesore nga gjymtyrët e dyta. - dallimin e fjalëve drejtuese të kundërvënësve dhe të rrethësorëve. | Teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë, bllok gramatike. |
| 21 | Sintaksë | Gjymtyrët e dyta dhe klasifikimi i tyre | | Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për dallimin e përcaktorëve dhe fjalët e tyre drejtuese. | Teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë, bllok gramatike. |
| | | MODULI III | | | | |
| 22 | Të lexuarit | Vecoritë gjuhësore dhe stilistike të teksteve udhëzuese | Lexohen udhëzime të ndryshme: manuale, kode, ligje, rregullore. | Diskutim njohurish paraprake, Stuhi mendimi, Organizuesi logjik i analogjisë, Punë në grup, Praktikë e drejtuar | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna; - analizën e strukturës së tekstit udhëzues. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleepcharter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |

| | | | | | | |
|----|---------------------------|---|---|--|---|--|
| 23 | Të lexuarit | Teknikat e shkrimit të teksteve udhëzuese | Lexohen fragmente të ndryshme udhëzuese ku janë përdorur teknika të ndryshme shkrimi. | Diskutim njohurish paraprake, Rrjeti i diskutimit, Këmbim njohurish, Punë në grup Praktikë e drejtuar, Di/Dua të di/Mësova | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna; - analizën e teknikave të shkrimit të tekstit | Materiale të ndryshme tekstesh udhëzuese: kode, ligje, rregullore, manuale; libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-chart</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 24 | Përpunim njohurish | Testim | | Punë e pavarur | Vlerësim për materialet e hulumtuara. | Teksti mësimor |

PLANI ANALITIK PËR TREMUJORIN E DYTË (JANAR–MARS)

| Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe | | | | | | |
|---|-----------------------|----------------|---------------------|--|-----------|---------|
| Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës | | | | | | |
| Nr | Kompetenca / Tematika | Temat mësimore | Situata e të nxënës | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi | Burimet |

| | | | | | | |
|----|--------------------|--|--|--|--|---|
| 25 | Të lexuarit | Teknikat e shkrimit të teksteve udhëzuese | Lexohet një fragment. | Stuhi mendimi | Vlerësim për përdorimin e teknikave të shkrimit të teksteve udhëzuese. | Materiale të ndryshme tekstesh udhëzuese: kode, ligje, rregullore, manuale; libri i nxënësit, tabela, <i>sleepcharter</i> . |
| 26 | Drejtshkrim | Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Puna me fisha, Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Punë në grup | Vlerësim për përcaktimin e rasteve kryesore kur fjalët shkruhen njësh. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, fisha, tabelë, <i>"Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe"</i> . |
| 27 | Drejtshkrim | Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Puna me fisha, Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Punë në grup | Vlerësim për përdorimin e saktë të fjalëve, që shkruhen ndaras. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, fisha, tabelë, <i>"Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe"</i> . |
| 28 | Drejtshkrim | Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes | Lexohet një fragment. | Punë në grup | Vlerësim për: - përcaktimin e rasteve kryesore kur fjalët shkruhen me vizë lidhëse në mes; - përdorimin e saktë të fjalëve që shkruhen me vizë lidhëse në mes. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë, <i>"Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe"</i> . |

| | | | | | | |
|----|---------------------|--------------------------------|--|--|--|---|
| 29 | Të shkruarit | Shkruajmë rregullore | Lexohet rregullorja e shkollës dhe vërehen teknikat e shkrimit të saj. | Diskutim paraprak, Udhëzime shkrimi, Punë me shkrim sipas grupeve. | Vlerësim për: - shkrimin e rregullores; - fjalorin e përdorur gjatë shkrimit të rregullores; - respektimin e strukturës së rregullores së shkruar | Fletore të punëve me shkrim, modele rregulloresh, shumësia me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 30 | Të shkruarit | Shkruajmë rregullore | | | | |
| 31 | Morfologji | Shkruajmë rregullore Ndajfolja | Lexohet një fragment. | Di/Dua të di/ Mësova, Pëmë Mendimi, Punë në grup | Vlerësim për përcaktimin e llojit të ndajfoljeve sipas funksionit që kryejnë në fjali. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. |
| 32 | Morfologji | Lokucionet ndajfoljore | Lexohet një fragment. | Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për formimin e lokucioneve ndajfoljore. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. |
| 33 | Leksikologji | Antonimet | Poezi: “Shpella e Dragobisë”, “Syr gjyn vdekur”. | Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për dallimin e antonimeve të plota nga ato të pjesshme. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë, “ <i>Leksikologjia e gjuhës shqipe</i> ”. |

| | | | | | | |
|----|---------------------------|--|--|---|--|---|
| 34 | Sintaksë | Kundrinori, llojet e tij | Lexohet një fragment. | Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për: - dallimin dhe përcaktimin e kundrinorit. - krahasimin e kundrinorit me gjymtyrët e tjera të fjalisë. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. |
| 35 | Përpunim njohurish | Punë me projekt | Prezantimi i temës | | Ora e parë | |
| 36 | Të lexuarit | MODULI IV Tekstet argumentuese | Lexohet një fragment nga një tekst argumentues dhe diskutohet rreth veçorive të tij. | Stuhi mendimi, Hartë semantike, Lexim i drejtuar i tekstit, Punë në çift, Përmbledhje e strukturuar, Punë me shkrim. | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna; - analizën e strukturës së tekstit argumentues. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-chart</i> , shumësia me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 37 | Të lexuarit | Analizë teksti argumentues | Ç' dini për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe për lashtësinë e saj? | Stuhi mendimi, Lexim i drejtuar i tekstit, Punë në çift, Punë në grupe, Përmbledhje e strukturuar, Punë me shkrim. | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-chart</i> , shumësia me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |

| | | | | | | | |
|----|--------------------|----------------------------|---|--|---|---|--|
| 38 | Të lexuarit | Analizë teksti argumentues | | | | | |
| 39 | Të folurit | Të folurit në publik | Dëgjohen sekuenca të ligjëratave të ndryshme të folurit në publik. Mbahen shënime gjatë dëgjimit. | Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup, Diagram Veni, Diskutim në grup. | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>sleep-charter</i> , shumësia me ngjyra. | |
| 40 | Të folurit | Të folurit në publik | | | | | |
| 41 | Morfologji | Klasifikimi i lidhëzave | Teksti “Muzgu i perëndive të stepës” | Stuhi Mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për: - përcaktimin e llojit të lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse; - dallimin e lokucioneve lidhëzore; - krahasimin e lidhëzave me klasat e tjera të fjalëve. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. | |

| | | | | | | |
|----|---------------------|--|--|--|---|--|
| 42 | Të dëgjuarit | Dëgjojmë dhe analizojmë një fjalim | Prezantohet një material me përmbajtje historike. | Diskutim paraprak, Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar, Të dëgjuarit për të vlerësuar, Punë në grupe. | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna. | Materiale të shtypit të shkruar, fjalime, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkurtesa me ngjyra. |
| 43 | Drejtshkrim | Përdorimi i shenjave të pikësimit: tri pikat, kllapat, thonjëzat | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit (tri pikat, kllapat, thonjëzat). | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, “ <i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe</i> ”. |
| 44 | Të folurit | Mënyra për organizimin e një fjalimi | Rilexohet fjalimi i Kadesë dhe përqendrohet vëmendja te koha e rrëfimit. | Stuhi mendimesh, Diskutim dhe bashkëveprim në grup, Prezantim me gojë, Organizues grafk, Punë në grupe. | Vlerësim për: - demonstrimin e strategjive efektive të përcjelljes së mesazhit gojor (organizimi, gjuha e gjesteve, fjalori i përshtatshëm); - përdorimin e një shumëllojshmërie strategjish organizative (tabela, diagrame). | Fjalime, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |

| | | | | | | |
|----|-------------------------------|--|---|--|---|--|
| 45 | Përpunim njohurish | Punë me projekt | Kontroll i ecurisë së punës | | | |
| 46 | Sintaksë | Rrethanori: llojet e tij | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për: - përcaktimin e llojit të rrethanorit; - krahasimin e rrethanorit me gjymtyrët e tjera të fjalisë. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë. |
| 47 | Sintaksë | Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për dallimin e rrethanorit të shkakut nga ai i qëllimit. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë. |
| 48 | Përpunim njohurish | Testim | | Punë e pavarur | Vlerësim për materialet e hulumtuara. | Teksti mësimor |

PLANI ANALITIK PËR TREMUJORIN E TRETË (PRILL – QERSHOR)

| Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe | | | | | | |
|--|-------------------------|-------------------|-----------------------|--|-----------|---------|
| Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës | | | | | | |
| Nr | Kompetenca/ Tematika | Temat mësimore | Situata e të nxënësve | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi | Burimet |

| | | | | | | |
|----|---------------------|-----------------------------------|--|--|---|---|
| 49 | Sintaksë | Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për dallimin e rrethanorit të mënyrës nga ai i sasisë. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë. |
| 50 | Të shkruarit | Si të shkruajmë një fjalim | Prezantohet një material me përmbajtje historike | Diskutim paraprak, Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar, Të dëgjuarit për të vlerësuar, Punë në grupe | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna. | Fjalime, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shumësia me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 51 | Të shkruarit | Si të shkruajmë një fjalim | | | | |
| 52 | Leksikologji | Homonimet | “Dhëpra dhe një shtat”, “Mbi ta”. | Pemë mendimi, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për dallimin e homonimeve të plota nga ato të pjesshme. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë, vargje poetike. |
| 53 | Leksikologji | Homonimet | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Pemë mendimi, Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për përdorimin e homonimeve të plota dhe të pjesshme. | Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. |

| | MODULI V | | | | | |
|-----------|---------------------|--|--|---|--|---|
| 54 | Të lexuarit | Tekstet informuese-paraqitëse | Lexohen fragmente nga lloje të ndryshme tekstesh informuese-paraqitëse: memorandumet, broshurat, fletëpalosjet, CV-të, vërtetimet, kërkesat, raportet vjetore, procesverbalet, relacionet, letrat zyrtare, njoftimet, ftesat, shpalljet, recensione etj. | Diskutim krahasues mbi vëzhgim, Diagrami i Venit, Stuhi mendimi, Skemë rreze, Organizuesi grafik i analogjisë, Praktikë e udhëhequr hap pas hapi, Punë në grupe | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna; - analizën e strukturës së tekstit informues-paraqitës. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 55 | Morfologji | Klasifikimi i paraqitësve sipas rasave | Fragment “Trëndafili në gotë” | Puna me fisha, Pemë mendimi, Punë në grup | Vlerësim për: - dallimin e paraqitësve në fjali; - përcaktimin e rasës së paraqitësve. | Teksti mësimor, videoprojektor, fisha, skemë, tabelë, fragment nga “Trëndafili në gotë”. |
| 56 | Morfologji | Klasifikimi i paraqitësve sipas rasave | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Pemë mendimi, Punë në grup | Vlerësim për: - dallimin e paraqitësve nga ndajfoljet dhe emrat; - përdorimin në fjali të të njëjtës fjale si <i>paraqitës</i> , <i>ndajfolje</i> , <i>emër</i> , <i>paraqitës</i> . | Teksti mësimor, skemë, tabelë. |

| | | | | | | |
|----|--------------------|------------------------------------|---|--|--|---|
| 57 | Të lexuarit | Analizë teksti informues-paraqitës | Shkruhet në tabelë një listë e shkurtimeve që nxënësit përdorin në komunikimin virtual (në <i>Facebook, Instagram, Viber, Whatsapp</i>) me miqtë e tyre. | Përvijim i mendimit, Stuhi mendimi, Lexim i drejtuar, Punë në grup, Punë e pavarur, Diagrami i Venit | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna; - analizën e strukturës së tekstit udhëzues; - analizën gjuhësore të tekstit udhëzues. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shumësia me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 58 | Të lexuarit | Analizë teksti informues-paraqitës | | | | |
| 59 | Të folurit | Prezantimi | Paraqiten në videoprojektor sequenca prezantimesh të ndryshme. | Stuhi mendimi, Leksion i përqendruar, Praktikë e drejtuar, Punë në grupe | Vlerësim për: - pjesëmarrjen në diskutime; - fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna; - analizën e tipareve të të folurit në publik dhe vlerësimin e rëndësisë së tij. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shumësia me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 60 | Sintaksë | Përcaktori | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fishe. | Stuhi mendimi, Punë në grup | Vlerësim për dallimin e përcaktorit dhe llojin e tij. | Teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë. |

| | | | | | | |
|----|---------------------|---|---|--|---|---|
| 61 | Sintaksë | Llojet e përcaktorit | Paraqitet një fragment në videoprojektor ose me fisha. | Stuhi mendimi, Punë në grup | Vlerësim për dallimin e llojeve të përcaktorëve. Vlerësohen nxënësit që tregojnë se me çfarë shprehen përcaktorët. | Teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë. |
| 62 | Të shkruarit | Shkrimi i një eseje informuese-paraqitëse | Lexohen modele të ndryshme esesh informuese-paraqitëse. | Stuhi mendimi, Organizues grafik, Praktikë e udhëhequr hap pas hapi, Diskutim, Punë e pavarur (shkrim i lirë). | Vlerësim për: - realizimin e qëllimit, temës dhe audiencës për të cilën shkruan; - ndjekjen e të gjitha hapave të procesit të të shkruarit; - përzgjedhjen e informacionit në burime të ndryshme; - hartimin e një strukture ose një skede për tekstin që do të shkruajë. | Materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shumësia me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). |
| 63 | Të shkruarit | Shkrimi i një eseje informuese-paraqitëse | | | | |

| | | | | | | |
|----|-------------------|--|---|---|--|---|
| 64 | Sintaksë | Përcaktori kallëzuesor | | Stuhi mendimi, Punë në grup | Vlerësim për dallimin e përcaktorit kallëzuesor dhe për përcaktimin me se është shprehur. | Teksti mësimor, skedë, tabelë, bllok gramatike. |
| 65 | Sintaksë | Përcaktori kallëzuesor | Paraqitet një fragment në videoprojektore ose me fisha. | Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë në grup | Vlerësim për krahasimin e përcaktorit me gjymtyrët e tjera të fjalisë. | Teksti mësimor, skedë, tabelë, bllok gramatike. |
| 66 | Sintaksë | Lidhjet e përcaktorit kallëzuesor në fjali | Paraqitet një fragment në videoprojektore ose me fisha. | Punë në grup | Vlerësim për dallimin e fjalëve drejtuese të përcaktorëve kallëzuesorë. | Teksti mësimor, bllok gramatike, tabelë. |
| 67 | Sintaksë | Lidhjet e përcaktorit kallëzuesor në fjali | | Punë e pavarur dhe në grup | Vlerësim për dallimin e përcaktorit kallëzuesor nga gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror. | Teksti mësimor, bllok gramatike, tabelë. |
| 68 | Drejtskrim | Ligjërata e drejtë | Paraqitet një fragment në videoprojektore. | Stuhi mendimi, Punë në grup | Vlerësim për dallimin e pjesës lajmëruese në ligjëratën të drejtë. | Teksti mësimor, videoprojektore, skemë, tabelë. |
| 69 | Drejtskrim | Ligjërata e zhdrejtë | Paraqitet një fragment në videoprojektore. | Stuhi mendimi, Punë në grup | Vlerësim për kthimin e ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë, dhe ligjëratës së zhdrejtë në të drejtë, duke shpjeguar ndryshimet në formë. | Teksti mësimor, videoprojektore, skemë, tabelë. |

| | | | | | | |
|----|-------------------------------|--------------------|--------------------|--------------|--|--|
| 70 | Përpunim njohurish | Punë me projekt | Prezantim projekti | Ora e tretë | | |
| 71 | Përpunim njohurish | Punë me projekt | Prezantim projekti | Ora e katërt | | |
| 72 | Përpunim njohurish | Testim | | | | |

PLANIFIKIMI I TEMAVE MËSIMORE - Gramatikë

TESTOJMË NJOHURITË GRAMATIKORE NGA KLASA X

1. Shumësi i emrit *argument* është:
a. argumente b. argumenta
2. Cili emër nuk ka dy trajta shumësi:
a. nip b. numër c. qen
3. Çfarë kanë të përbashkët foljet dua, them, shpie?
a. Janë folje të zgjedhimit të dytë.
b. Janë folje që tri temat i ndryshojnë pjesërisht.
c. Janë folje që tri temat i ndryshojnë tërësisht.
d. Janë folje të diatezës pësore.
4. Lidhëzat as...as, edhe, edhe ashtu si janë:
a. bashkërenditëse shtuese
b. bashkërenditëse veçuese
c. bashkërenditëse kundërshtuese
d. bashkërenditëse përmbyllëse
5. Gjymtyra e veçuar në fjalinë “*Mësuesja, me qetësi, u foli nxënësve*”, është:
a. ndajshim
b. përcaktor
c. kundrinor
d. rrethanor
6. Pjesorja e foljes *jam* është:
a. qeshë b. qenë c. qemë
7. Cila është shkruar saktë?
a. Jeronim De Rada
b. Jeronim de Rada
8. Pjesorja e foljes *kam* është:
a. kisha b. pata c. pasur
9. Folja e nënvizuar në fjalinë “*Do të vinte po të kishte kohë*”, është në mënyrën:
a. lidhore b. dëftore c. kushtore
10. Kryefjala në fjalinë “*Kjo është krejtësisht e papritur*”, shprehet me:
a. përemër dëftor b. përemër vetor
c. përemër pyetës
d. përemër të pacaktuar
11. Në fjalinë “*I dukej sikur malet do të zgjatnin dorën për ta kthyer përsëri aty...*”, folja do të zgjatnin është:
a. në kohën e ardhme, mënyra dëftore
b. në kohën e ardhme të përparme, mënyra dëftore
c. në kohën e tashme, mënyra kushtore
d. në kohën e ardhme të së shkuarës, mënyra dëftore
12. Cila është shkruar saktë?
a. liqeni i Shkodrës
b. Liqeni i Shkodrës
13. Gjymtyra homogjene në fjalinë “*Nuk ishin as të vështira as të padëgjues nga nxënësit*” është:
a. raport përmbyllës
b. raport veçues
c. raport shtues
d. raport kundërshtues
14. Në fjalinë “*Dy më të mëdhatë nuk po i mbante vendi*”, mbiemri më të mëdhatë është:
a. emërzim i qëndrueshëm
b. emërzimi kontekstual

15. Në grupet emërore *asnjë nxënës, dëshira për të lexuar, shumë mësues* përcaktori është:
a. me përshtatje b. me drejtim
c. me bashkim d. me ndajshim
16. Cili emër ka dy trajta shumësi:
a. rreth b. fshat c. monument
17. Në fjalinë “*Ajo mund ta realizojë ëndrrën e saj*”, kallëzuesi është:
a. kallëzues foljor i thjeshtë
b. kallëzues foljor i përbërë
c. kallëzues emëror
18. Pjesorja e foljes *ha* është:
a. hëngër b. ngrënë c. hëngra
19. Foljet e nënvizuara në fjalinë:
S’dinë të vishen, të hanë, të flasin, janë në mënyrën:
a. lidhore b. dëftore c. kushtore
20. Në fjalinë *Erdhi u afrua pranë portës*, fjala *portës* është:
a. emër b. parafjalë c. folje
21. Cila është shkruar saktë?
a. malet e Shqipërisë së Veriut
b. malet e Shqipërisë së veriut
c. Malet e Shqipërisë së Veriut
22. Shumësi i emrit *shitës* është:
a. shitësa b. shitës
23. Cili emër ka dy trajta shumësi:
a. vit b. urdhër c. trëndafil
24. Në grupet emërore: *hyjnesha Afërditë, anija “Përparimi”*, përcaktori është:
a. me përshtatje b. me drejtim
c. me bashkim d. me ndajshim
25. Në fjalinë “*Zuri të fliste menjëherë...*”, kallëzuesi është:
a. kallëzues foljor i thjeshtë
b. kallëzues foljor i përbërë
c. kallëzues emëror
26. Pjesorja e foljes *shoh* është:
a. parë b. pamë c. pashë
27. Qarkoni alternativën e saktë:
a. kujdesi i **së** bijës
b. kujdesi i **të** bijës
28. Cila është shkruar saktë?
a. dita e Mësuesit b. Dita e Mësuesit
29. Lidhëzat *prandaj, pra* janë:
a. bashkërenditëse shtuese
b. bashkërenditëse veçuese
c. bashkërenditëse kundërshtuese
d. bashkërenditëse përmyllëse
30. Cila folje është josupletive?:
a. jam b. them c. kam
31. Në grupet emërore *vajza e mësueses, qyteti me muze, zemrën e vajzës*, përcaktori është:
a. me përshtatje b. me drejtim
c. me bashkim d. me ndajshim
32. Lidhëzat *herë...herë, ose, apo, qoftë...* *qoftë* janë:
a. bashkërenditëse shtuese
b. bashkërenditëse veçuese
c. bashkërenditëse kundërshtuese
d. bashkërenditëse përmyllëse
33. Qarkoni alternativën e saktë:
a. Studimi i një kërkuesi **së** universitetit tonë
b. Studimi i një kërkuesi **të** universitetit tonë

34. Fjala e nënvizuar në fjalinë: *E bukura është objekt studimi*, është:
a. emër b. mbiemër i emërzuar
c. mbiemër
35. Gjymtyra e veçuar në fjalinë *Në shkollë, mësimi vijonte si zakonisht*, është:
a. ndajshim
b. përcaktor
c. kundrinor
d. rrethanor
36. Pjesorja e foljes *them* është:
a. thamë b. thënë c. thashë
37. Kryefjala në fjalinë *Dikush po vraponte drejt saj*, shprehet me:
a. përemër dëftor b. përemër vetor
c. përemër pyetës d. përemër të pacaktuar
38. Folja në fjalinë *Lexova gazetën*, është:
a. kalimtare b. jokalistare
39. Qarko fjalën që nuk i përket grupit.
a. pasthirmë b. lidhës
c. pjesëz d. mbiemër
40. Në ndërtimin *Ju ika, ju ika*, fjala **ju** është:
a. përemër dëftor
b. përemër vetor
c. trajtë e shkurtër e përemrit vetor
d. pjesëz
41. Në grupet emërore *punë e ngutshme, qyteti ynë, klasa e dhjetë* përcaktori është:
a. me përshtatje b. me drejtim
c. me bashkim d. me ndajshim
42. Folja në fjalinë *Toka rrotullohet rreth diellit*, është:
a. kalimtare b. jokalistare
43. Cili emër ka dy trajta shumësi:
a. dokument b. frut c. çelës
44. Folja në fjalinë *Unë shkova pranë tij*, është:
a. kalimtare b. jokalistare
45. Cili nuk është emër i dygjinishëm?
a. ndryshimet b. gjuhët c. faktet
46. Qarko fjalën që nuk i përket grupit.
a. ndajfolje b. folje c. përemër d. numëror
47. Lidhëzat *jo aq...sa, por, veç, veçse* janë:
a. bashkërenditëse shtuese
b. bashkërenditëse veçuese
c. bashkërenditëse kundërshtuese
d. bashkërenditëse përmblylëse
48. Qarkoni alternativën e saktë:
a. Libri i gjuhës **së** klasës së dhjetë
b. Libri i gjuhës **të** klasës së dhjetë
49. Qarkoni alternativën e saktë:
a. Kërkesat i përgjigjen detyrës **të të** sotmes **e të së** ardhmes
b. Kërkesat i përgjigjen detyrës **të të** sotmes **e të së** ardhmes
c. Kërkesat i përgjigjen detyrës **të të** sotmes **e të të** ardhmes
50. Gjeni përdorimin e gabuar të foljes **ha**.
a. do të hajnë
b. të hash
c. të ha

PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE PËR TEKSTIN JOLETRAR**MODULI 1**

| | | | |
|--|----------------------------|--|------------------|
| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
| Tema mësimore: Tekstet përshkruese | | Situata e të nxënit: Lexohen paragrafë të ndryshëm përshkrues dhe nxënësit i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit lidhur me objektet dhe mënyrat e përshkrimit. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon karakteristikat strukturore të tekstit përshkrues; - dallon karakteristikat stilistike dhe gjuhësore të tekstit përshkrues; - krahason tiparet midis teksteve përshkruese; - analizon realizimin e përshkrimit sipas perceptimit shqisor; - interpreton ndërtimin gjuhësor të tekstit përshkrues. | | Fjalët kyçe: Përshkrim objektiv Përshkrim subjektiv Perceptim shqisor Rendi i përshkrimit Detaje të përshkrimit | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimit, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive) | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none">• Përvijim i mendimit• Të nxënit ndërveprues• Stuhi mendimi• Hartë konceptesh• Diagram Veni• Punë në grup• Praktikë e drejtuar | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake - Stuhi mendimi


Nëpërmjet videoprojektorit shfaqen pamje të ndryshme në të cilat përshkruhen vende, objekte, njerëz, kafshë. Kërkohej nga nxënësit të përshkruajnë në bazë të perceptimit të tyre shqisor. Dëgjohen përshkrimet dhe jepen vlerësime të shkurtra mes grupeve të vogla pjesëmarrëse.

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë — Shkruhet në tabelën e zezë përkufizimi për tekstin përshkrues.

Teksti përshkrues është një nga llojet e teksteve. Ai mund të përkufizohet si produkt i përshkrimit me fjalë të objektit, vendit, mjedisit apo personit që dikush vrojton. Qëllimi i teksteve përshkruese është paraqitja me hollësi e tipareve që vrojtohen. Hollësitë e shumta e bëjnë më të gjallë dhe më të prekshëm përshkrimin.

Hapi i tretë - Hartë konceptesh



Struktura: Hyrje-zhvillim-mbyllje

Përshkruhen: objekte, vende, njerëz, kafshë.

Bazohet në **perceptimin shqisor**.

Teknikat e përshkrimit: Mund të përshkruhet së brendshmi dhe pastaj së jashtmi, nga lart-poshtë, nga e përgjithshmeja tek e veçanta, e kështu me radhë.

Gjuha: informale (figurative) te tekstet përshkruese subjektive dhe formale te tekstet përshkruese objektive.

Hapi i katërt - Punë e pavarur

Nxënësit punojnë në grupe me ushtrimet në tekst.

Ushtrimi 1- teksti i parë është rrëfyes, në të dominon folja, autori rrëfen ndodhi të jetës së tij. Teksti i dytë është përshkrues. Në të përshkruhet telefoni më i ri i kompanisë “Apple”, *iPhone 7*.

- Fjalët që sjellin perceptimin shqisor:
 - Forma, përmasa, pesha, imazhi optik
 - Fjalët teknike: kompani, risi, alumin, rezistent, buton, bateri, sensorë, megapiksel.
 - Koha e foljeve është e tashme.
 - Dominojnë mbiemrat: i ri, të lavdërueshme, rezistent, i mirëfilltë, por edhe ndajfoljet: më shpejt, më gjatë etj.

Përforcim njohurish

Hapi i pestë — përmbledhen tiparet e tekstit përshkrues

Bëhen diagrame Veni për ta krahasuar atë me lloje të tjera tekstesh.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë tiparet strukturore të tekstit përshkrues;
- dallojnë tiparet gjuhësore të tekstit përshkrues;
- bëjnë krahasime mes llojeve të teksteve.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;
- për përgjigjet e dhëna për ushtrimet e punuara.

Detyra dhe puna e pavarur: Gjeni një tekst përshkrues dhe rendisni të gjitha karakteristikat e tij strukturore dhe ato gjuhësore.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|---|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Analizë: Tekst përshkrues i një vendi. Shqipëria - Kopshti shkëmbor i Evropës juglindore, F. Konica | | Situata e të nxënit: Bëhet një prezantim i shkurtër rreth vlerave të përshkrimit të Konicës në veprën nga është marrë pjesa. Paraqiten nëpërmjet pamjeve apo albumeve sekuenca nga bukuritë natyrore të vendit tonë. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon informacionin e dhënë gjatë përshkrimit; - analizon teknikat përshkruese; - dallon citimet në funksion të përshkrimit; - interpreton informacionin e dhënë në tekstin përshkrues bazuar në njohuritë e veta; - arrin në konkluzione rreth audiencës, lexuesit të tekstit. | | Fjalët kyçe: Këndvështrim përshkrues Referim Citim Alpe | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, albume me pamje nga Shqipëria, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive) | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari Gjeografi Histori | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <ul style="list-style-type: none">Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehuritKompetenca e të menduaritKompetenca e të nxënitKompetenca personaleKompetenca qytetareKompetenca digjitale | | | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

- Të nxënësve ndërveprues
- Prezantim filmik
- Lexim me ndalesa
- Praktikë e drejtuar
- Punë në grupe

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake

Paraqitet një material ku nxënësi njihet me përshkrime të ndryshme nga autorë të ndryshëm kushtuar Shqipërisë. Diskutohet rreth vlerësimeve dhe opinioneve të tyre. Nga moria e materialit të dëgjuar, nxënësi përzgjedh fragmentin përshkrues apo tiparin më interesant që u vishet bukurive të vendit tonë.

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Lexim me ndalesa

Lexohet teksti: *Shqipëria - Kopshti shkëmbor i Evropës juglindore (F. Konica)* në librin e nxënësit.

Në fund të çdo paragrafi ndalohet për të diskutuar informacionin e marrë.

Hapi i tretë - Praktikë e drejtuar

Fragmente ku përshkrimi është objektiv dhe fragmente ku përshkrimi është subjektiv:

Subjektiv: Qoftë i lartë, qoftë i ulët, një mal shqiptar është unik me profilin e prerë pastër dhe ngritjen e thiktë përpjetë mbi tokë. Të lind përshtypja sikur je përballë monumenteve kolosale, të ndërtuara nga vetë natyra.

Objektiv: Po e rikujtojmë që Via Egnatia ka qenë një zgjatim i rrugës së madhe romake Apia, e cila shkonte nga Roma në Brindizi, kapërcente Adriatikun për të ardhur në Durrës dhe vijonte në Elbasan, Ohër, Selanik, Bizant e Jerusalem. Ajo është një xhade që ende, si të thuash, mban gjurmët e legjioneve të Cezarit e të Pompeut.

Hapi i katërt - Punë në grupe

Klasa ndahet në grupe ku secili punon me ushtrimet e dhëna në tekst.

- Çfarë këndvështrimi zgjedh autori për të përshkruar relievin malor të vendit tonë? Si realizohet përshkrimi, duke shkuar nga tiparet e përgjithshme te tiparet e përveçme

apo e anasjella?

- Këndvështrimi është nga e përgjithshmja te e veçanta. Informacionet e përgjithshme pasohen nga detaje të hollësishme:

Tipar karakteristik i klimës së Shqipërisë është larmia e saj. Gjatë bregdetit të Adriatikut ndeshet e ashtuquajtura klimë mesdhetare, që përafërsisht mund të krahasohet me Kaliforninë e Jugut. Bregdeti është i ngrohtë dhe në pjesën më jugore rriten portokaj e agrume të tjera. Në brendësi të vendit klima, siç e quajnë zakonisht gjeografët, është kontinentale. Këtu lartësitë që ngrihen thikë, të shpien tek ajri i ftohtë e gjallërues i maleve.

Përfundim njohurish

Hapi i pestë – Arrihet në konkluzione rreth qëllimit të ushtrimeve:

- Informacioni i marrë nëpërmjet përshkrimit: gjeografik, historik, social.
- Struktura e tekstit.

| |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - Këndvështrimi. - Lexuesi i zakonshëm, i cili njihet me tipare të ndryshme të vendit. |
| Veprimet në situatë Situata konsiderohet e realizuar kur: <ul style="list-style-type: none"> • nxënësit përgjigjen saktë; • dallojnë informacionin e marrë nëpërmjet përshkrimit; • analizojnë teknikat përshkruese; • analizojnë strukturën e tekstit përshkrues. |
| Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen: <ul style="list-style-type: none"> • për pjesëmarrjen në diskutime; • për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja; • për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit, pas zhvillimit të punës në grupe; • për analizën e strukturës së tekstit përshkrues. |
| Detyra dhe puna e pavarur: Ushtrimi 8. Gjeni në tekst të paktën dy detaje, të cilat njihen si të diskutueshme nga shkenca shqiptare sot. Përse mendoni se Konica ka “gabuar” në këto raste gjatë përshkrimit? |

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Përemrat, llojet e tyre | | Situata e të nxënit: Teksti “ <i>Shqipëria - Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore</i> ” | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">dallon dhe përdor në fjali lloje të ndryshme përemrash;përcakton kategorinë gramatikore të përemrave;dallon përemrat vetorë nga ata dëftorë. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">përemra vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronorë, pyetës, lidhorë, të pacaktuarkategori gramatikore | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, fisha, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve***Puna me fisha, Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë në grup*****ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

Veprimtari paraprake

– **(Puna me fisha)**

Teksti i shkëputur nga “*Shqipëria - Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*”, i ndarë në fisha u shpërndahet nxënësve. Fishat mund të paraqiten edhe në videoprojektor, ose flipçart.

Fisha 1.

Në një vend tjetër koloneli Lik bën **këto** vërejtje: “Ndryshe nga turku dembel e fodull ose nga fshatari grek i varfër, që ka humbur gjallërinë si pasojë e mjerimit dhe shtypjes së vazhdueshme, **këta** shqiptarët janë të dalluar për veprimtarinë e **tyre** të palodhur. Çdo pikë mbizotëruese pranë rrugës kam parë se e kanë zënë një ose disa prej **tyre**, në kohën që më dilte para syve dhe dukej se bënë një garë se **kush** do të arrinte më parë.

Fisha 2.

Gjithë pyetjeve për topografinë **ata** i përgjigjen me përpikëri dhe me zgjuarsiri të madhe, ndërsa shpërblimi më i mirë për ta është leja që u jap të shohin goniometrin **tim**. Nuk ka gjëra më të ndryshme nga njëra-tjetra sesa sjellja e shqiptarëve dhe sjellja e osmanëve, që janë qeniet njerëzore më dembele e flegmatike, me përjashtim të çastit kur i lëviz nga vendi **ndonjë** nxitje e jashtëzakonshme”. Hobhauzit, mikut të Bajronit e **që** u quajt më pas lord Brauton, i kishte bërë shumë përshtypje ndjenja kombëtare, si një tipar i shqiptarëve.

Fisha 3.

“Këtu ka, - thotë ai, - një shpirt pavarësie dhe dashuri për atdheun nga **gjithë** populli e **kjo** në një masë të madhe e mënjanon dallimin e thellë që vihet re në pjesët e tjera të Turqisë, ndërmjet pasuesve të dy feve. Kështu, kur banorët e viseve të **tjera** i pyet se çfarë janë, **ata** përgjigjen: “Jemi turq” ose “Jemi të krishterë”, ndërsa banori i **këtij** vendi përgjigjet “Jam shqiptar”... Ndjenja kombëtare bie fort në sy në karakterin e **tyre**. Nëse **ndonjë** prej tyre largohet nga vendi dhe duke rrugëtuar merr vesh se një bashkatdhetar banon në një fshat pranë të **cilit** mund të kalojë, ndonëse nuk e ka parë e as nuk ka dëgjuar ndonjëherë për të, **ai** ndërron rrugë dhe shkon për ta takuar.


Fisha 4.

Disa herë kam qenë dëshmitar i gëzimit që **ata** shprehin kur takohen kështu, rastësisht dhe e shfaqin më haptas sesa i tregojnë ndjenjat dy anglezë miq në **këto** raste. E gjithë mënyra e sjelljes së **tyre** është e përzemërt dhe kur, pas një mungese të shkurtër, ndodh **që** një shqiptar ndesh një të njohur, i jep dorën e djathtë dhe e puth në faqe dhe po kështu bëjnë kur ndahen, ndërsa po të jenë takuar në rrugë, kur largohen ca njëri nga tjetri, qëllojnë me pistoletë ose me pushkë.” Po kështu një autor francez i shekullit të nëntëmbëdhjetë, admiral i Zhyrjen dë Gravjerë, i cili, si komandant i flotës franceze në Mesdheun Lindor për shumë vjet, u kishte bërë një studim të thelluar shqiptarëve, ka vënë në dukje se “kombësia i bashkon shqiptarët shumë më tepër se feja”.

Nxënësit nënvizojnë përemrat dhe tregojnë llojin e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Stuhi mendimi, Diagram Veni.


Me teknikën “Stuhi mendimi” u paraqitet nxënësve në tabelë diagrami i llojeve të përemrave, si dhe disa rregulla gramatikore për përemrat.



Rregulla

- Përemrat kanë përgjithësisht kategoritë gramatikore të gjinisë, numrit dhe rasës, një pjesë të vetës, ndërsa të tjerë mund të mos kenë asnjë kategori dhe janë të pandryshueshëm.
- Përemrat vetorë kanë kategorinë gramatikore të vetës, numrit dhe rasës. Kategorinë gramatikore të gjinisë e ka vetëm veta e tretë: **ai/ajo, ata/ato**.
- Përemrat dëftorë kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit dhe rasës.
- Përemrat pyetës **i cili, i sati** kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit dhe rasës.
- Përemrat pyetës **kush, sa** kanë kategorinë gramatikore të rasës.
- Përemrat pyetës ç', çfarë, se nuk kanë kategori gramatikore.
- Disa përemra të pacaktuar (secili, cilido) kanë kategorinë gramatikore të gjinisë; kurse disa të tjerë (ndonjëri, kushdo) kanë atë të rasës.
- Zakonisht përdoren në të gjitha funksionet sintaksore, në të cilat përdoren edhe emrat, si: kryefjalë, kundrinor, kallëzues emërorë, përcaktorë apo rrethanorë.

Me teknikën “Diagram Veni” u paraqitet nxënësve përdorimi i përemrave **ai/ajo; ata/ato** si përemra vetorë dhe si përemra dëftorë.



Nxënësit shkruajnë diagramet dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të zëvendësojnë emrat në fjalitë me emra me përemra. (f.15)

| | | |
|---------|---------------------|--|
| Përemri | → Fjali me emra: | Babai erdhi papritur. Sytë e tij ishin të bukur. |
| | → Fjali me përemra: | Ai erdhi papritur. Ata sy iu dukën si të sajtë. |

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Punohen në mënyrë të pavarur dhe në grup:

Ushtrimet 1-6, f.16-17.

Diskutimi i ushtrimeve 4 dhe 6:

- plotësimi i përemrit lidhor, që mund të zbërthehet në dy përemra;
- përdorimi i përemrave të pacaktuar në rasën e duhur.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për dallimin dhe përdorimin e saktë të përemrave.

Detyrë shtëpie:

Në tekstin “Shtëpitë shqiptare” (f. 18-19) gjeni përemrat dhe i klasifikoni sipas llojit.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Analizë: tekst përshkrues i një objekti. Shtëpitë shqiptare | | Situata e të nxënës: | |
| Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon karakteristikat e objektit të përshkruar; - dallon paragrafët objektivë dhe subjektivë në përshkrim; - krahason tipare të objektit të përshkruar duke e parë atë në shtrirje horizontale; - interpreton ndërtimin gjuhësor të tekstit përshkrues. | | Fjalët kyçe: Shtëpitë shqiptare Veçori estetike Zbukurime Ndërtesat e vjetra Udhëtarët | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, albume fotografike, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari Gjeografi Histori | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënës• Kompetenca personale | | | |

- Kompetenca qytetare
- Kompetenca digjitale

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

- Të nxënit ndërveprues
- Stuhi mendimi
- Diagram Veni
- Punë në grupe

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake: Stuhi mendimi

Lexohen përshkrime të ndryshme të bëra nga studiues të huaj, të cilët janë marrë me kulturën, traditat dhe historinë e popullit shqiptar.

Xh. K. Hobhauzi

Lord Bajroni

Edit Durham

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Lexim dhe koment

Lexohet teksti: **Shtëpitë shqiptare**, fragment nga *Shqipëria, kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, F. Konica. Gjatë leximit, veçohen informacionet e marra:

- ...gjakmarrja ka qenë një ngjarje e përditshme.
- Kishte një kontrast të madh me shtëpitë malazeze.
- ...arat i kanë disa kilometra më tutje dhe secila zotëron disa dynymë.

Hapi i tretë - Diagram Veni

Informacionet e dhëna nga autori renditen dhe vendosen në diagram, ku krahasohen me njëri-tjetrin.

- Shtëpitë shqiptare janë zakonisht ndërtesa një-a dykatëshe, të bëra prej guri të fortë e të rrethuara me kopshte e oborre.

- Brenda, një shtëpi shqiptare është zakonisht fare e thjeshtë. Pastërtia e zhveshur nuk priset në shumicën e viseve nga asnjë zburim, me përjashtim të ikonës në shtëpitë e krishtera ose të armëve të zjarrit që hijeshojnë muret e shtëpive të myslimanët.

Hapi i katërt - Punë në grupe

Klasa ndahet në grupe, të cilat punojnë me ushtrimet në tekst.

Veçoritë estetike të shtëpive shqiptare:

Një autor tjetër anglez thotë kështu për një banesë shqiptare, ku kaloi një ditë: “Ndonëse ishte e varfër, e kënaqte anën artistike të natyrës sonë jo thjesht nga pamja piktorike, por nga diçka tjetër. Duke e menduar hollë, arrita në përfundimin se më kënaqte fakti që çdo gjë ishte bërë me duart e veta: qilimi mbi të cilin rrinim, i zbukuruar me një lule prej vijash të zeza e ngjyrë qumështi; kapulja e shtrojave; veshjet prej shajaku të endur në vegje, me lesh natyror delesh dhe të pangjyer, që i mbanin si burrat edhe gratë; madje edhe trarët e gdhendur trashë dhe gurët e mëdhenj të mureve. Gjithçka është një punë dore e ndershme, një art i ndershëm, në të vërtetë një art shumë më i mirë sesa i mjaft gjërave që mbajnë po këtë emër, në të ashtuquajturat qarqe artistike të Evropës më të qytetëruar”.

| |
|--|
| <p>Përforcim njohurish Hapi i pestë – Tabelë konceptesh Sintetizohen tiparet e tekstit përshkrues të studiuar. Referenti: Shtëpitë shqiptare Cilësitë dhe veçoritë e tyre. Gjuha e pasur me mbiemra. Kohët foljore të përdorura: e tashme për përshkrime të autorit dhe e kryer e thjeshtë, më se e kryer për përshkrime të referuara nga studiues të tjerë.</p> |
| <p>Veprimet në situatë Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nxënësit përgjigjen saktë; • dallojnë llojet dhe tiparet e tekstit përshkrues; • interpretojnë informacionin e marrë; • bëjnë krahasime rreth llojeve të teksteve. |
| <p>Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për pjesëmarrjen në diskutimin e ushtrimeve të punuara; • për analizën e tekstit përshkrues të një objekti; • për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit; • për interpretimin e informacioneve të marra gjatë përshkrimit. |
| <p>Detyra dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6: Përmbledhjeni me pesëmbëdhjetë fjali tekstin e mësipërm, duke ruajtur tiparet e tekstit përshkrues.</p> |

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Trajtat e shkurtra të bashkuara (ora I) | | Situata e të nxënit: Teksti “Shtëpitë shqiptare”. | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • lakon përemrat vetorë. • dallon bashkimet e trajtave të shkurtra dhe i përdor saktë në fjali. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - përemra vetorë - trajta të shkurtra, trajta të shkurtra të bashkuara | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Punë në grup

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT***Veprimtari paraprahe***

Nxënësit lakojnë përemrat vetorë.

| Rasat | | | | | | | | |
|-----------|------------|-----------|------------|-------------|-----------|-----------|--------------|--------------|
| Emërore | unë | ti | ai | ajo | ne | ju | ata | ato |
| Gjinore | ----- | ----- | i atij | i asaj | ----- | ----- | i atyre | i atyre |
| Dhanore | mua më | ty të | atij, i | asaj, i | neve na | juve ju | atyre, u | atyre, u |
| Kallëzore | mua më | ty të | atë (të) e | atë (të), e | ne na | ju ju | ata (ta), i | ato (to), i |
| Rrjedhore | meje | teje | atij (tij) | asaj (saj) | nesh | jush | atyre (tyre) | atyre (tyre) |

Ndërtimi i njohurive të reja:

Nxënësve u jepen disa rregulla të lakimit të përemrave vetorë.

Rregulla: Karakteristika të lakimit të përemrave vetorë:

- *Përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë, në numrin njëjës dhe shumës nuk kanë rasë gjinore.*
- *Në rasat dhanore dhe kallëzore, përemrat vetorë **mua, ne, neve; juve, ju; atë, atij (asaj), ata (ato), atyre** kanë edhe trajtat e shkurtra përkatëse: **më, na, të, ju, e, i, u**.*

Paraqitja në tabelë e trajtave të shkurtra:

| Numri | Veta | Dhanore | Kallëzore, veta e tretë, njëjës | Trajtë e bashkuar |
|--------|------|---------|---------------------------------|-------------------|
| njëjës | I | më | + e | ma |
| | II | të | | ta |
| | III | i | | ua |
| shumës | I | na | +e | Na e |
| | II | ju | | jua |
| | III | u | | ua |
| Numri | Veta | Dhanore | Kallëzore, veta e tretë, njëjës | Trajtë e bashkuar |
| njëjës | I | më | + i | m'i |
| | II | të | | t'i |
| | III | i | | ia |
| shumës | I | na | +i | na i |
| | II | ju | | jua |
| | III | u | | ua |

Rregulla: Trajtat e shkurtra

- *Trajtat e shkurtra përdoren gjithmonë me foljet. Ato qëndrojnë:*
 - **përpara foljes;**
 - **në trup të foljes;**
 - **në fund të foljes.**
- *Trajtat e shkurtra të bashkuara: **ma, ta** shkruhen pa apostrof, **m'i, t'i** shkruhen me apostrof, ndërsa **na e, na i** shkruhen ndaras.*

Nxënësit shkruajnë tabelat dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i drejton nxënësit te teksti “Shtëpitë shqiptare”, f. 18-19.

Klasa ndahet në dy grupe.

Grupi i parë punon për të gjetur trajtat e shkurtra.

Grupi i dytë punon për të gjetur trajtat e shkurtra të bashkuara.

Kërkoheq që të shpjegohet përdorimi i tyre.


Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për dallimin e trajtave të shkurtra dhe të bashkuara, shpjegimin e përdorimit të tyre.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 5, f. 22. Gjeni shprehje me trajta të shkurtra dhe të bashkuara. Shpjegoni përdorimin e tyre dhe analizojinë ato.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|--|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Trajtat e shkurtra të bashkuara (ora II) | | Situata e të nxënës: | |
| Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Kompetenca e të menduarit - Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit | | | |
| Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> dallon bashkimet e trajtave të shkurtra dhe i përdor saktë në fjali; dallon rastet e gabuara të përdorimit të trajtave të shkurtra/ të bashkuara. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> trajta të shkurtra trajta të shkurtra të bashkuara. | |

| Burimet: teksti mësimor, bllok gramatike, tabelë. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|--|----------------|-----------------|--|--|--|--|--|--|----------------|-----------------|---|--|---|--|--|---|
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Punë në grupe</i> | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme</i></p> <p>Nxënësit plotësojnë diagramin me rregulla të përemrave vetorë dhe të trajtave të shkurtra/ të bashkuara.</p> <div style="text-align: center;">  <p>Përemrat vetorë</p> <p>Trajtat e shkurtra/të</p> </div> <p><i>Diskutim i detyrave të shtëpisë:</i> Nxënësit lexojnë shprehje me trajta të shkurtra dhe të bashkuara, duke shpjeguar përdorimin e tyre dhe duke i analizuar ato.</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja:</p> <p>Nxënësve u jepen disa rregulla mbi shmangien e disa përdorimeve të gabuara të trajtave të shkurta/ të bashkuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> Gabime në numër <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: center;">Trajtë e saktë</th><th style="text-align: center;">Trajtë e gabuar</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>U tha atyre se mësimi fillon menjëherë pas provimeve.</td><td>I tha atyre se mësimi fillon menjëherë pas provimeve.</td></tr> <tr> <td>Ua dha atyre të gjitha të drejtat e botimit të romanit të ri.</td><td>Ia dha atyre të gjitha të drejtat e botimit të romanit të ri.</td></tr> <tr> <td>Na e keni prishur mendjen fare me atë që keni bërë.</td><td>Na i keni prishur mendjen fare me atë që keni bërë.</td></tr> </tbody> </table> <ul style="list-style-type: none"> Gabime në vetë <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: center;">Trajtë e saktë</th><th style="text-align: center;">Trajtë e gabuar</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Ju dhashë juve të gjitha porosinë rreth projektit të ri.</td><td>U dhashë juve të gjitha porosinë rreth projektit të ri.</td></tr> <tr> <td>Jua tregova juve të gjitha detajet e ngjarjes.</td><td>Ua tregova juve të gjitha detajet e ngjarjes.</td></tr> <tr> <td>Ua dhashë atyre të dhënat e modelit të ri të celularit.</td><td>Jua dhashë atyre të dhënat e modelit të ri të celularit.</td></tr> </tbody> </table> <p>Nxënësit shkruajnë rastet e sakta dhe të gabuara të trajtave të shkurta/ të bashkuara në bllokun e gramatikës.</p> | | Trajtë e saktë | Trajtë e gabuar | U tha atyre se mësimi fillon menjëherë pas provimeve. | I tha atyre se mësimi fillon menjëherë pas provimeve. | Ua dha atyre të gjitha të drejtat e botimit të romanit të ri. | Ia dha atyre të gjitha të drejtat e botimit të romanit të ri. | Na e keni prishur mendjen fare me atë që keni bërë. | Na i keni prishur mendjen fare me atë që keni bërë. | Trajtë e saktë | Trajtë e gabuar | Ju dhashë juve të gjitha porosinë rreth projektit të ri. | U dhashë juve të gjitha porosinë rreth projektit të ri. | Jua tregova juve të gjitha detajet e ngjarjes. | Ua tregova juve të gjitha detajet e ngjarjes. | Ua dhashë atyre të dhënat e modelit të ri të celularit. | Jua dhashë atyre të dhënat e modelit të ri të celularit. |
| Trajtë e saktë | Trajtë e gabuar | | | | | | | | | | | | | | | | |
| U tha atyre se mësimi fillon menjëherë pas provimeve. | I tha atyre se mësimi fillon menjëherë pas provimeve. | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Ua dha atyre të gjitha të drejtat e botimit të romanit të ri. | Ia dha atyre të gjitha të drejtat e botimit të romanit të ri. | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Na e keni prishur mendjen fare me atë që keni bërë. | Na i keni prishur mendjen fare me atë që keni bërë. | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Trajtë e saktë | Trajtë e gabuar | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Ju dhashë juve të gjitha porosinë rreth projektit të ri. | U dhashë juve të gjitha porosinë rreth projektit të ri. | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Jua tregova juve të gjitha detajet e ngjarjes. | Ua tregova juve të gjitha detajet e ngjarjes. | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Ua dhashë atyre të dhënat e modelit të ri të celularit. | Jua dhashë atyre të dhënat e modelit të ri të celularit. | | | | | | | | | | | | | | | | |

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimit 3, f. 22.

Nxënësit lexojnë fjalitë dhe korrigjojnë gabimet në vetë ose në numër në përdorimin e trajtave të shkurtra dhe të bashkuara.

Dy nxënësve u kërkohet të krijojnë fjali në tabelë me njësitë **të, i, e**, duke i përdorur si nyje dhe si trajta të shkurtra.

Punohen në grup ushtrimet 8, 9 f. 23.

Diskutohen ushtrimet.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë rastet e gabuara të përdorimit të trajtave të shkurtra dhe të bashkuara.

Vlerësohen nxënësit që përdorin saktë në fjali njësitë **të, i, e**, duke i përdorur si nyje dhe si trajta të shkurtra.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 10, f. 23- Në një artikull të shtypit të përditshëm gjeni dhe diskutoni rastet e përdorimit të saktë apo të gabuar të trajtave të shkurtra/ të bashkuara.

Ose

Ushtrimi 11, f. 23 - Përshkruani një objekt, duke përdorur trajta të shkurtra dhe të bashkuara.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Të shkruarit. Përshkrimi i një vendi | | Situata e të nxënit: Lexohen paragrafë të ndryshëm përshkrues dhe vërehen teknikat e shkrimit, mbiemrat e përdorur. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - shkruan një ese përshkruese duke respektuar temën e shkrimit; - shkruan një ese përshkruese duke respektuar strukturën e saj përkatëse; - shkruan një ese përshkruese duke synuar stil dhe origjinalitet krijues. | | Fjalët kyçe: Hyrje-zhvillim-mbyllje Mbiemra dhe ndajfolje Detajet përshkruese | |

| | |
|--|--|
| <p>Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i>, shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive).</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari Gjeografi</p> |
| <p>Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit • Kompetenca e të menduarit • Kompetenca e të nxënit • Kompetenca personale • Kompetenca qytetare • Kompetenca digjitale | |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të nxënit ndërveprues • Stuhi mendimi • Leksion i përqendruar • Hartë konceptesh • Punë në grup | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>I. Veprimtari paraprake Lexohet modeli i tekstit përshkrues të dhënë për Parkun e Liqenit të Tiranës.</p> <p>II. Zhvillimi i situatës Hapi i dytë – Leksion i përqendruar Diskutohet me nxënësit dhe jepen udhëzime rreth shkrimit të një eseje përshkruese: - Zgjidhni për të përshkruar një vend që e njihni mirë. - Përdorni sa më shumë mbiemra dhe ndajfolje, për të përshkruar pamjen dhe atmosferën e këtij vendi. - Disa prej tyre përdorini në shkallën sipërore. - Shprehni ndjenja personale.</p> <p>Hapi i tretë - Praktikë e drejtuar Vërehen figurat dhe shtohen elemente të tjera në përshkrimin e Parkut të Madh të Liqenit të Tiranës.</p> <p>Hapi i katërt – Punë me shkrim: 1. Vërehet fotografia dhe përshkruhet sipas ndarjeve në kuadrate, duke nisur nga ekstremet drejt qendrës. 2. Duke u bazuar në modelin e dhënë shkruani një tekst përshkrues për vendlindjen tuaj.</p> | |
| <p>Veprimet në situatë Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nxënësit shkruajnë një ese përshkruese duke respektuar strukturën përkatëse; • shkruajnë një ese përshkruese duke synuar stil dhe origjinalitet; • shkruajnë një ese përshkruese duke zbatuar rregullat e standardit. | |

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për shkrimin e esesë sipas formatit të kërkuar;
- për shkrimin e esesë duke përdorur gjuhë korrekte;
- për fjalorin e përdorur gjatë shkrimit të esesë;
- për përdorimin e mjeteve stilistike në paragrafët subjektivë përshkrues.


| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Leksikologji Tema mësimore: Sinonimet | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: • përcakton se çfarë është sinonimia; • dallon fjalët sinonime që kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt; • përcakton se nga dallohen sinonimet ndërmjet tyre; • analizon dhe vlerëson rëndësinë e njohjes dhe të studimit të sinonimeve në gjuhën shqipe. | | Fjalët kyçe: - sinonime (të plota, të përafërta) - nuancë kuptimore - terminologji | |
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, skeda, bllok gramatike, tabelë, “Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe”, “Si të shkruajmë shqip”. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK, gjuhë e huaj | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, DDM | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Veprimtari paraprake Me anë të teknikës “Di, Dua të di, Mësova”, nxënësit kontrollojnë njohuritë e tyre mbi sinonimet. - Si fjalë me kuptim të njëjtë. - Llojet e sinonimeve. - Dallimet mes sinonimeve të përafërta. | | | |

| DI | Dua të di | Mësova |
|---|--|--|
| Sinonimet janë fjalë me kuptim të njëjtë. | Cilat janë dallimet mes sinonimeve të përafërta? | <p>Dallimet mes sinonimeve të përafërta janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në disa nuanca të kuptimit leksikor. - Në ngjyrimet shprehëse emocionale. - Në aftësinë për të krijuar fjalë të reja dhe për t'u lidhur me fjalë të tjera në grupe fjalësh apo në njësi frazeologjike. - Në gjerësinë dhe dendurinë e përdorimit. |
| Sinonimet janë të plota dhe të përafërta. | | |

Tabela e mësipërme plotësohet me pyetje të tjera të bëra nga nxënësit.

Ndërtimi i njohurive të reja: ‘Stuhi mendimi’

Me teknikën “Stuhi mendimi”, mësuesi/ja paraqet në tabelë ose videoprojektor llojet e sinonimeve: të plota dhe të përafërta, si dhe dallimet që shfaqen te sinonimet e përafërta.



Të mbajmë mend!

- *Fjalët sinonime i përkasin së njëjtës pjesë të ligjëratës.*
- *Më shumë sinonime kanë mbiemrat dhe ndajfoljet. Edhe foljet janë të pasura. Më pak sinonime kanë emrat.*
- *Nën ndikimin e gjuhëve të huaja shpesh huazohen fjalë që e kanë gjegjësen e tyre në gjuhën shqipe.*
Fjalët sinonime:
 - mund të fitojnë nuanca të reja kuptimore,
 - mund të përdoren në fusha të ndryshme,
 - mund të dalin nga përdorimi.

Nxënësit shkruajnë diagramin dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimet 1, 2, 3 zhvillohen me gojë, ku nxënësit:

- përjashtojnë në grupet e fjalëve të dhëna atë që nuk është sinonimike me të tjerat;
- plotësojnë vargjet sinonimike, sipas modelit të dhënë.

Të ndarë në grupe, nxënësit zhvillojnë ushtrimet 4, 5, 6, f. 29.

- Zëvendësojnë fjalët e nënvizuara me sinonimet e tyre.
- Krijojnë fjali çifte sinonimike të krijuara nga shprehje frazeologjike.
- Zëvendësojnë fjalët e huaja me fjalët shqipe.

Diskutohen ushtrimet duke iu rikthyer tabelës DDM, për t'u plotësuar më tej.

Për mësuesit, material ndihmës për këtë temë mësimore.

Sinonime nga

J. Thomai, M. Samara, H. Shehu, Th. Feka, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.

| | | | | | |
|----------------------|---|---|-------------------|---|---|
| <i>Administrim</i> | - | mbarështim, përdorim (f.29) | <i>Ballinë</i> | - | ballore, parëse, faqe (f.69) |
| <i>Adresoj</i> | - | drejtoj (f.29) | <i>Emëroj</i> | - | caktoj, bëj, vë (f.241) |
| <i>Angazhoj</i> | - | pajtoj (f.41) | <i>Fantazoj</i> | - | imagjinoj, ëndërroj, trilloj(f.255) |
| <i>Autoritar ,~e</i> | - | i pushtetshëm (f.60) | <i>Mësoj</i> | - | nxë, stërvit, shkolloj, studioj arsimoj, ushtroj(f.517) |
| <i>Ballinë</i> | - | ballore, parëse, faqe (f.69) | <i>Pëlqej</i> | - | kënaq, dua, simpatizoj, shijoj, miratoj(f.653) |
| <i>Bazoj</i> | - | mbështes (f.81) | <i>Tërësor,~e</i> | - | i plotë, i përgjithshëm (f.916) |
| <i>Bëj</i> | - | veproj, kryej, zhvilloj, punoj, realizoj, ndërtoj, shpik (f.86) | <i>Vërtetoj</i> | - | dëshmoj, provoj, argumentoj, mbështet (f.1003) |
| <i>Çështje</i> | - | problem, pikë, kauzë, punë, rast (f.160) | | | |

Tregues i fjalëve të huaja që mund të zëvendësohen plotësisht ose pjesërisht.

Shiko më gjerë:

Gjovalin Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip*, Botimet “Toena”, Tiranë, 2008, f.253-275.

| | | | | | |
|--------------------|---|------------------------------|-----------------------|---|------------------------------|
| <i>Abandonim</i> | - | braktis | <i>Ekuivok,~e</i> | - | i dykuptimshëm, i dykuptimtë |
| <i>Abnegacion</i> | - | vetëmohim | <i>Fasadë</i> | - | ballinë, parëse |
| <i>Abrogoj</i> | - | shfuqizoj | <i>Glosar</i> | - | fjalës |
| <i>Altoparlant</i> | - | fortafolës, zëzmadhues | <i>Iluzor,~e</i> | - | i rremë, i gënjeshtërt |
| <i>Barrier</i> | - | pengesë (Në sport - mur.) | <i>Multilateral~e</i> | - | shumëpalësh~e |
| <i>Biografi</i> | - | jetëshkrim | <i>Novacion</i> | - | risi |
| <i>Bord</i> | - | këshill, komision | <i>Proporcion</i> | - | përpjesëtim |
| <i>Dekadë</i> | - | dhjetëditësh, dhjetëvjeçar | <i>Publikoj</i> | - | botoj |
| <i>Devijoj</i> | - | shmang | <i>Spiker</i> | - | folës |

| | |
|------------------------------|--|
| | Nuk mund të zëvendësohet |
| <i>aksion</i> - veprim | Kur përdoret si term sportive dhe si term i financës |
| <i>Asimiloj</i> - përvetësoj | Kur është fjala për shkrirje e popujve me njëri-tjetrin: asimilim me dhunë, dhunë politike |

Vlerësimi:

- Vlerësohen nxënësit që dallojnë fjalët sinonime që kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt, përcaktojnë se nga dallohen sinonimet ndërmjet tyre.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 7, f. 29, Rishkruani një pjesë të tekstit “Shtëpitë shqiptare”, duke përdorur sinonime pa e prishur kuptimin e tij.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|---------------------|---|-----------|
| Tema mësimore: Rëndësia e të dëgjuarit në komunikimin njerëzor | | Situata e të nxënit: Dëgjojen sekuenca lajmesh, leksionesh, tregimesh. Nga nxënësit kërkohet të ndjekin me vëmendje dhe të riprodhojnë informacionin e dëgjuar. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe kupton tekste të llojeve të ndryshme; - bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve; - mban shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm; - analizon qëllimin e folësit ose të mesazhit që dëgjon. | | Fjalët kyçe: Komunikim i përditshëm Vëmendje Reagim emocional Dëgjues i efektshëm Parafrazim, përmbledhje | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale dëgjimore, CD dëgjimore, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive) | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari Art | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <ul style="list-style-type: none">• Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit• Kompetenca e të menduarit• Kompetenca e të nxënit• Kompetenca personale• Kompetenca qytetare• Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim njohurish paraprake Stuhi mendimi Punë në grup Leksion i përqendruar Përmbledhje e strukturuar Shkrim i shpejtë/Rishikim | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake - Diskutim njohurish paraprake

Drejtohet pyetja:

Sa i rëndësishëm është të dëgjuarit në komunikimin e përditshëm?

Si sinjalizohet të dëgjuarit e efektshëm?

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Leksion i përqendruar

Të dëgjuarit e qëllimshëm është një proces mendor që lidhet me dëgjimin e përqendruar të një teksti. Disa nga tekstet që dëgjojnë, janë: *mësimi, relacioni, njoftimi, bashkëbisedimi, diskutimi, debati, prezantimi, lajmet, emisionet tematike televizive*.

Që të dëgjuarit të jetë i efektshëm, nevojitet: të jemi të përqendruar, pra të vëmendshëm; ta pranojmë informacionin që dëgjojmë; të tregojmë ndjeshmëri ndaj tij, pra të reagojmë emocionalisht.

Hapi i tretë- Dëgjojnë tekstet

MALLI I ATDHEUT FAIK KONICA

Kur vete njeriu, i lirë e i vetëm, larg atdheut - viset e reja, ndryshimi i zakoneve, ëmbëlsia e udhëtimit e një mijë gjëra që vihen re ndër popuj të huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën e të bëjnë jo të harrosh Shqipërinë, po të mos të vejë tek ajo aq dendur mendja. Më tutje, si ngopen sytë së pari ndryshime, gazi shuhet pak nga pak. S[di] ç` të mungon, s`di se ç` të duhet. Një hije trishtimi ta mbulon fytyrën; e, pikë së pari herë-herë, mbastaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtimi i prindërve, i miqve e i shokëve, kujtimi i dheut ku u lindëm e u rritëm, ku qajtëm foshnja e ku lozëm djelm, kujtimi i atyre maleve larg të cilëve nuk rron dot mire një shqiptar, kujtimi i kombit, që, me gjithë ca të liga që ka, është kombi ynë, e më tepër kujtimi e dëshira e etja e gjuhës sonë ta shtrëngojnë e ta dërmojnë me të vërtetë zemrën. Ah, malli i Shqipërisë, malli i atdheut të dashur, i shenjtë mall e dashuri e shenjtë, kush është ai shqiptar që s`e ka pasur në dhe të huaj! Duhet të jesh jashtë Shqipërisë, e të jesh larg, për të kuptuar se ç` forcë e ç`bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri! Ajo më e zbrazura letër, ajo fjala më e vogël, na sjell, kur vjen nga Shqipëria, një gaz të parëfyeshëm, se na sjell si një copë të atdheut...

Dëgjojmë një anekdotë

Armiku në trajtën e shquar

- Agim, si thuhet në dialektin gegë emri në trajtën e shquar armiku? - pyeti arsimtari nxënësin

gjatë orës së mësimi.

- Unmiku, profesor, - u përgjegj Agimi shpejt e shpejt.

- Shumë bukur! Duket qartë që kujtesën e keni të fortë, - plotësoi profesori i gjuhës shqipe.

Beqir Elshani

Hapi i katërt - Punë në grupe

Nxënësi përcakton nivelin e dëgjimit të efektshëm apo të kundërtën duke përdorur një organizues grafik në funksion të vlerësimit:

P.sh.: Kupton tekstin që dëgjohe. 6 pikë
Kupton fjalët, theksin, intonacionin. 8 pikë

Përforcim njohurish

Hapi i pestë – Përmbledhje e strukturuar

Proceset njohëse të të dëgjuarit të efektshëm lidhen me:

- *të pyeturit*, i cili lidhet me nevojën e bërjes së pyetjeve për sqarime;
- *parafrazimin*, i cili lidhet me qartësimin dhe konkretizimin e informacionit;
- *përmbledhjen*, e cila lidhet me strukturimin në mënyrë të përmbledhur, të të gjitha veprimtarive që tregojnë angazhimin e dëgjuesit në bisedë dhe përpjekjet e tij në të.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë llojet dhe tiparet e komunikimit dhe t'i zbërthejnë ato konkretisht;
- flasin dhe prezantojnë me qasje drejt standardit;

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen për:

- tregimin e respektit, empatisë (ndjeshmërisë) dhe interesit ndaj folësit;
- demonstrimin e vullnetit gjatë kryerjes së detyrave;
- ndërmarrjen e iniciativave dhe shprehjen e interesit për çështje të ndryshme;
- përdorimin e imagjinatës dhe kreativitetit për zgjidhjen e problemeve;
- respektimin e parimeve, vlerave, bindjeve dhe kulturës së të tjerëve.

MODULI II

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|---|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve rrëfyese | | Situata e të nxënit: Lexohen fragmente të teksteve rrëfyese dhe diskutohet rreth veçorive të tyre. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - analizon tekstin, veçoritë dhe strukturën e tij; - krahason tekste të llojeve të ndryshme; - identifikon karakteristika të formës së teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti. - analizon veçoritë gjuhësore të një teksti. | | Fjalët kyçe: Teksti rrëfyes Rend kronologjik Strukturë ciklike Strukturë rrethore | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none">• Përvijim i mendimit• Të nxënit ndërveprues• Stuhi mendimi• Hartë semantike• Diagram Veni• Punë në grup• Përmbledhje e strukturuar | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake

Lexohen paragrafë të ndryshëm të teksteve rrëfyese dhe të llojeve të tjera. Bëhet krahasimi mes tyre.

Qëllimi, teknikat, gjuha e tekstit. Analizohet ndërtimi i tyre gjuhësor.

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Leksion i përqendruar

Teksti rrëfyës është teksti në të cilin rrëfëhet një ndodhi, një ngjarje apo një histori e trilluar ose jo, sipas një rendi të caktuar kronologjik. Ai i vendos njerëzit/personazhet në një kohë dhe vend të caktuar.

Teksti rrëfyës mund të ketë strukturë të thjeshtë ose të ndërlikuar. Në një tekst me strukturë të thjeshtë, ngjarjet rrëfëhen sipas rendit kronologjik [hyrja (fillimi), zhvillimi, mbyllja].

Hapi i tretë - Hartë semantike

Harta e tekstit



Koha kur zhvillohen ngjarjet (koha e ngjarjes) dhe kur tregohen ato (koha e rrëfimit).

Personazhet ose njerëzit që marrin pjesë në historinë që po rrëfëhet.

Hyrja ose parashtrimi i problemit/i çështjes për të cilën po rrëfëhet.

Konflikti/synimi ose pika kyçe rreth së cilës organizohet e gjithë historia.

Ngjarjet përbëjnë një ose më shumë përpjekje nga ana e personazhit kryesor, për të arritur synimin ose për të zgjidhur problemin.

Zgjidhja është rezultati i përpjekjeve për të arritur një qëllim të caktuar.

Hapi i katërt- Punë në grupe

Ushtrimi 1:

Teksti rrëfyës letrar: përrallat, legjendat, mitet, tregimet, novelat, romanet etj.

Teksti rrëfyës joletrar: biografia, autobiografia, kujtime, reportazhi, ditari, intervista, kronika etj.

- Teksti në ushtrimin 2 u referohet skulpturave antike.

- Rendi kronologjik shënohet përmes treguesve: *Le ta shohim tani; Njerëzit e asaj kohe; Sot ne e njohim.*

- Kohët foljore: *e tashme, e kryer, e kryer e thjeshtë.*

Ushtrimi 2

Në të shkruarën njohja shkonte: Njerëzit e asaj kohe e kanë vëzhguar trupin në llixha, në vallet e shenjta, në lojërat publike; ata kanë dalluar dhe u kanë dhënë përparësi atyre formave dhe atyre qëndrimeve që shfaqin fuqi, shëndet dhe veprimtari; kanë punuar me

zell të veçantë për të ngulitur ato forma dhe për të mësuar ato qëndrime. Për rreth tre apo katërqind vjet, ata kanë korrigjuar, kanë kulluar dhe kanë zhvilluar idenë e tyre të bukurisë fizike.

Përforcim njohurish

Hapi i pestë – Përmbledhje e strukturuar

- Tekstet rrëfyese shkruhen në vetën e parë ose të tretë. (Ka edhe raste të pazakonta kur rrëfimi

bëhet në vetën e dytë).

- Përdoren përgjithësisht folje të së shkuarës, por edhe në të tashmen. Në këtë rast, e tashmja përdoret brenda kohëve të shkuara.
- Tekstet rrëfyese kanë një denduri të lartë foljesh, të cilat përdoren për të përshkruar veprimet, mendimet dhe ndjenjat.
- Kanë fjalë lidhëse që tregojnë kohën (*pastaj, më tej, pas kësaj, pas një farë kohe* etj).
- Ndër figurat letrare, më të përdorura janë: *metafora, similituda dhe krahasimi*.
- Përdoren fjali të shkurtra, ose të gjata, të cilat shërbejnë për ta çuar rrëfimin përpara, për të shtuar hollësi dhe për të bërë përshkrime.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë veçoritë e tekstit rrëfyës;
- analizojnë strukturën e tekstit rrëfyës.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për analizën e strukturës së tekstit rrëfyës.
- për analizën gjuhësore të tekstit rrëfyës.

Detyra dhe puna e pavarur: Gjeni një tekst rrëfyës joletrar dhe bëni hartën e strukturës së tekstit, sipas modelit të dhënë.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|----------------------------|---|------------------|
| Tema mësimore: Teknikat e shkrimit të kronikës, ditarit, biografisë dhe autobiografisë | | Situata e të nxënit: Lexohen shembuj të ndryshëm të autobiografisë, biografisë, kronikës dhe ditarit. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon llojet e tekstit rrëfimtari; - krahason llojet e teksteve rrëfimtare; | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Biografi • Autobiografi • Ditar • Kronikë • Strukturë rrëfyese | |

| | |
|--|---|
| <p>- analizon teknikat dhe strukturën e teksteve rrëfimore të shqyrtuara;</p> <p>-interpretin informacionin e marrë nëpërmjet teksteve rrëfimore.</p> | |
| <p>Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>flip-chart</i>, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>TIK</p> <p>Qytetari</p> |
| <p>Kompetencat kyçe:</p> <p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</p> <p>Kompetenca e të menduarit</p> <p>Kompetenca e të nxënit</p> <p>Kompetenca personale</p> <p>Kompetenca qytetare</p> <p>Kompetenca digjitale</p> | |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stuhi mendimi • Hartë semantike • Punë e pavarur • Praktikë e drejtuar • Përmbledhje sintetike | |
| <p>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>I. Veprimtari paraprake</p> <p>Nxënësit kanë parapërgatitur materiale dhe kanë sjellë në klasë kronika të ndryshme, biografi, autobiografi. Këto materiale lexohen dhe renditen tiparet e tyre kyçe, në bazë të njohurive të mëparshme.</p> <p>II. Zhvillimi i situatës</p> <p>Hapi i dytë – Hartë semantike</p> <p>Kronika është tekst rrëfyes ku rrëfohen fakte dhe ngjarje të jetës së përditshme, ose historike, të cilat renditen në mënyrë kronologjike.</p> <p>Ditari është një lloj tjetër teksti rrëfyes. Rrëfimi përgjithësisht realizohet në vetë të parë. Ditari ka karakteristikat strukturore të teksteve rrëfuese dhe mund të ketë strukturë të thjeshtë, në rastet kur ndodhitë e përditshmërisë rrëfohen në rend kronologjik, ose strukturë të ndërlikuar, kur rrëfohen disa ngjarje paralelisht, apo një ngjarje brenda një tjetre.</p> <p>Biografia. Qëllimi i biografisë është të rrëfejë jetën dhe veprimtarinë e një njeriu, të njohur ose jo, duke u ndalur te ngjarjet më të rëndësishme, të cilat rrëfohen përgjithësisht sipas një rendi kronologjik.</p> | |

Autobiografia është rrëfimi i dikujt për jetën e tij. Si të gjitha tekstet rrëfyese, autobiografia duhet të strukturohet mirë dhe të rrëfëhet në mënyrë sa më interesante, për të mos humbur interesin e lexuesit. Autobiografia ndalet te vendi/vendet që janë të rëndësishme për shkruesin, te njerëzit që kanë pasur rëndësi dhe kanë shenjuar jetën e autorit, te ngjarjet dhe përvojat më domethënëse.

Hapi i tretë - Praktikë e drejtuar

Ushtrimi 1

Ditari është një tekst joletrar: në të mungon subjekti, mungon elementi i trilluar. Pavarësisht se edhe në veprat letrare autori mbështetet në ngjarje reale, në to kjo ndërthuret me elemente të trilluara. Ndërsa në një ditar rrëfimtari rrëfen me përpikëri ngjarjet.

Hapi i katërt - Punë e pavarur

Ndahet klasa në grupe dhe secili prej tyre punon me ushtrimet në tekst (2-5).

Ushtrimi 5

Teksti i dhënë është një autobiografi. Tema është vajtja e Çelsit, vajzës së Hilari dhe Bill Klintonit, në universitet.

Fjalët lidhëse: *Edhe pse, Sipas, Ndërkohë, Pasi kishte ardhur në përfundimin se.*

Fjalët lidhëse krijojnë lidhjen logjike dhe atë gjuhësore midis paragrafëve dhe fjalive në tekst.

Fjalët që tregojnë gjendjen shpirtërore të rrëfimtares: *...çasti të cilit kisha kohë që i druhesha;*

Shpresonim që; Blerjet dhe përgatitja e valixheve në çastin e fundit më kishin dërrmuar dhe, siç ndodh rëndom me shumë nëna, më kapi ankthi sapo vura këmbën në konvikt.

Përforsim njohurish

Hapi i pestë – Përmbledhje sintetike

Përmbledhen tiparet e llojeve të teksteve të shqyrtuara, duke u ndalur në:

Strukturën

Veçoritë gjuhësore

Tematikën dhe veçoritë formale.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë llojet e teksteve rrëfimtare joletrare;
- rendisin tiparet e secilit prej llojeve të teksteve rrëfimtare joletrare.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;
- për realizimin e hapave të procesit të komunikimit.

Detyra dhe puna e pavarur: Gjeneroni në shtypin e shkruar një kronikë lajmi dhe analizoni strukturën e saj.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Analizë e një teksti rrëfyes | | Situata e të nxënit: Paraqitet një material i shkurtër për jetën dhe veprën e Eqrem Çabejit. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon tiparet kyçe të tekstit rrëfimtar joletrar (biografisë); - analizon raportin përshkrim-rrëfim në tekst; - dallon në tekst elementet subjektive, vlerësimet e autorit; - hulumton dhe përzgjedh informacione rreth autorit; - realizon një përmbledhje të biografisë. | | Fjalët kyçe: Biografi Shkollimi Botimet Linguistikë Albanologji Veprimtari shkencore | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, modele të komunikimit, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive) | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none">Diskutim paraprak i njohuriveStuhi mendimiHartë koncepteshPunë në grup | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <ul style="list-style-type: none">I. Veprimtari paraprake- Diskutim paraprak i njohurive Cilat janë tiparet dalluese të një teksti rrëfimtar joletrar? - Ka një rrëfimtar, “zëri” që merr përsipër misionin e të treguarit të ngjarjes. Ky mund të ketë një pozicion të caktuar në raport me ngjarjen që tregohet; ai mund të jetë jashtë saj (nuk merr pjesë në ngjarje) ose mund të jetë i brendshëm (pjesëmarrës në ngjarje). | | | |

- Gjithashtu, ndihet qëndrimi i autorit, që jep mendimet dhe shpreh ndjenjat e tij ndaj ngjarjes.

- Karakterizohet nga kohësia, pra tregon ngjarje, fakte që kanë vazhdimësi në kohë dhe një kohëzgjatje të caktuar.

- Tregon për personazhe, vende apo ngjarje reale.

- Jepen fakte në lidhje me temën.

- Ngjarjet zakonisht rrëfohen në rend kronologjik.

Cilat janë llojet e teksteve rrëfimore joletrare?

Tekstet rrëfimore joletrare janë të shumta, ndër më të përdorshmet përmendim: kronikën, ditarin, letrat personale, autobiografinë, biografinë, udhëpërshkrimin, reportazhin, intervistat.

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Praktikë e drejtuar

- Fragmente që tregojnë **aspekte personale të jetës së autorit:**

- Para se të hynte në ndonjë shkollë, iu desh të qëndronte një vit pranë familjes Reinmyler, në Seint Peltën afër Vjenës, për të mësuar gjermanishten.

- Por i biri kishte tjetër dëshirë e tjetër mendim. Ai donte të bëhej gjuhëtar. “Gjuhësia është për pasanikët, i tha i ati prerazi, kurse neve na duhet një zanat që të na sigurojë jetën”. Atëherë djali, “i bindur”, u regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Romës. Por këtu ai më fort shkante të studiointe vepra gjuhësore e letrare nëpër bibliotekat romane. Në këto rrethana, babai i urtë e la të lirë të birin të bënte ashtu si donte vetë, por jo pa i thënë: “Paç veten në qafë, o bir!”

Hapi i tretë- Organizues grafik

Veçoritë gjuhësore

- Brenda një teksti rrëfimtar joletrar mund të dallohen gjashtë forma “ligjërimesh”:
 - komentet;
 - përshkrimet;
 - rrëfimi (që i takon tërësisht rrëfimitarit);
 - ligjërata e drejtë (që i takon personazhit);
 - ligjërata e zhdrejtë;
 - ligjërata e zhdrejtë e lirë (që është një bashkëpunim i rrëfimitarit me personazhin).

- Teksti rrëfimtar joletrar shpesh paraqitet i ndërthurur me paragrafë përshkrues, shpjegues, apo informues. Pjesët rrëfimore nga pjesët përshkruese zakonisht dallohen nga këmbimi i kohës së foljeve: nga e pakryera në të kryerën e thjeshtë.

Hapi i katërt - Punë e pavarur

Ushtrimi 10

Autori rrëfen një moment nga jeta e tij:

Tregimet e nënës

Kur babai nuk ndodhej në shtëpi, teksa rrija ulur te tryeza e kuzhinës, ndërsa nëna rrinte me kurriz nga unë, duke qëruar perime, ose duke shtrydhur portokaj, ose duke u dhënë formë qofteve në sipërfaqen e punës, ajo më rrëfente lloj-lloj tregimesh të çuditshme dhe po, të frikshme.

Autori përshkruan:

Tregimet e nënës mund të ishin të çuditshme, të frikshme, por ishin magjepsëse, të mbushura me guva dhe kulla, fshatra të shkretuara dhe ura të thyera, të varura në zbrazëti. Tregimet e saj nuk fillonin nga fillimi apo përfundonin me fund të bukur, por dridheshin në mugëtirë, mbështilleshin rreth vetes, dilnin nga mjegulla për një çast, të mahnitnin, të fusnin të dridhurat në palcë, e pastaj zhdukeshin prapë në errësirë, para se të kishe kohë të shihje çfarë kishe para syve.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë llojet dhe tiparet e teksteve rrëfyese;
- interpretojnë dhe pasurojnë informacionin e dhënë.

Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit;
- për analizën dhe interpretimin e biogrfisë.

Detyra dhe puna e pavarur: Ushtrimi 6. Plotësoni tabelën me të dhënat që përmban teksti, në lidhje me veprimtarinë shkencore dhe studimore të Çabejit.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshtkrim Tema mësimore: Shkrimi i citimeve (Ora I) | | Situata e të nxënit: Vepra letrare “Don Kishoti i Mançes” | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">dallon citimet;përdor drejt shenjat e pikësimit (tri pikat, kllapat, thonjëzat). | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">citimshenja pikësimi | |

| | |
|--|--|
| <p>Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, fisha, skemë, tabelë, “Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe”, “Të shkruarit akademik- ide, koncepte, modele”.</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi</p> |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Puna me fisha, Punë në grup</i></p> | |
| <p>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Veprimtari paraprake</p> <p>Mësuesi/ja paraqet në fisha ose në videoprojektor disa citime të shkëputura nga vepra letrare e studiuar në klasën e dhjetë “Don Kishoti”. U kërkohet nxënësve të shkruajnë një paragraf mbi veprën, duke përfshirë brenda tij një citim të dhënë në fishë.</p> <p>Fisha 1.</p> <div data-bbox="166 701 1199 838" style="border: 1px solid black; padding: 10px;"> <p>“Pasi pagëzoi kalin me këtë emër kaq të pëlqyer vendosi të pagëzojë vetveten dhe me këtë punë u mor nja dhjetë ditë dhe, më në fund e quajti veten Don Kishot.” (“Don Kishoti i Mançes”, Pjesa e parë, Tiranë, 2008, f. 282.)</p> </div> <p>Fisha 2.</p> <div data-bbox="166 875 1199 1045" style="border: 1px solid black; padding: 10px;"> <p>“Don Kishoti vazhdonte i zhytur në mendime udhëtimin e tij dhe përtyppte me vete shakanë e hidhur që i kishin kurdisur magjistarët, duke ia shndërruar zonjën e tij Dylqine në një fshatarkë të shëmtuar, pa ditur sesi e tek të vepronte që t’i kthente asaj trajtën e mëparshme.” (“Don Kishoti i Mançes”, Pjesa e dytë, Tiranë, 2008, f. 96.)</p> </div> <p>Fisha 3.</p> <div data-bbox="166 1079 1199 1280" style="border: 1px solid black; padding: 10px;"> <p>“- Fli, o Sanço, - tha Don Kishoti, - se ti ke lindur që të flesh, kurse unë që të vigjëlloj, ndaj dhe këto orë që kanë mbetur edhe nga nata, do t’i përdor që t’i heq sfratin lumit të mendimeve të mia dhe t’i shpreh në një madrigal të vogël, të cilin e stisa, pa dijeninë tënde, natën që shkoi, me mendjen time.” (“Don Kishoti i Mançes” Pjesa e dytë, Tiranë, 2008, f. 634-635.)</p> </div> <p>Ndërtimi i njohurive të reja: Mësuesi/ja ndërton skemën në tabelë:</p> <div data-bbox="189 1387 1199 1611" style="text-align: center;"> <pre> graph TD A([Autori]) --> B[Kuteli, Mitrush. Në cep të Ilirisë së poshtme: Naim Frashëri, Tiranë, 1983, f.17] B --> C([Titulli]) C --> B D([Sh.]) --> B E([Vendi i botimit]) --> B F([Viti i botimit]) --> B G([Nr. i faqes]) --> B </pre> </div> | |

Të mbajmë mend!

- *Pjesa e marrë nga një burim literature, nga vepra e ndonjë autori, e riprodhuar pa ndryshime, quhet **citim**.*
- *Citimet duhet të jenë identike me origjinalin, duke përdorur dhe duke përmendur në mënyrë të hollësishme burimin.*
- *Gjatë citimeve, shenjat e pikësimit vihen sipas të gjitha rregullave të pikësimit në ligjëratën e drejtë.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimi 1.

Nxënësit dallojnë citimet dhe i shkruajnë duke përdorur shenjat e duhura të pikësimit.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.


Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2002, f.88-94.

- Thonjëzat përdoren në ligjëratë të drejtë për të veçuar e për të dalluar fjalët që riprodhohen nga fjalët e autorit. Ato vendosen në fillim dhe në fund të ligjëratës së drejtë.

- Kur një citim është i gjatë, dy ose tre paragrafë, çdo fillim paragrafi duhet filluar me thonjëza, por thonjëzat mbyllëse duhet të vihen vetëm në fund të tekstit të cituar.

- Duhet të përdoren edhe thonjëzat njëshe, në qoftë se përdoren thonjëzat brenda një teksti të mbyllur në thonjëza.

Irida Hoti, Merita Hysa, *Të shkruarit akademik - ide, koncepte, modele*, Shkodër, 2010, f.87-90.

Diagrami i citimeve

Në këtë lloj citimi jepet fjalë për fjalë mendimi a përkufizimi i marrë nga një studiues tjetër, por duhet pasur kujdes në mënyrën e vendosjes së këtij citimi në tekstin ku duam ta përfshijmë, sepse ai duhet të ketë lidhje me atë që i paraprin dhe atë që do t'i shtohet pas.

Citim brenda citimit

Ka raste kur brenda një citimi të përfshihet një citim tjetër domethënë nga citimi që merret ndodhet edhe një citim tjetër, i specifikuar apo i referuar nga studiuesi, p.sh.:

*“Pjesa më e madhe e kulturës transmetohet përmes fjalës dhe shpesh thuhet që ka qenë zhvillimi i mundësisë së të folurit nga ana e qenieve njerëzore që e bëri të mundshëm zëvendësimin, si faktor mbizotërues në zhvillimin tonë, të ‘**evolucionit biologjik**’, që operon me genet, me ‘**evolucionin kulturor**’, që operon me mendjet. Nuk është e nevojshme të këmbëngulim mbi faktin që gjuha është një përbërës qendror i procesit të shoqërizimit.”*
(Hudson, Sociolinguistika, f. 105)

Citim jo nga origjinali

Citimet duhet të merren gjithmonë nga vepra origjinale, por kur ndodh që nuk mund ta gjejmë veprën, atëherë mund të referohet nga vepra ku e kemi marrë dhe duke shënuar: Cituar nga: p.sh.:

“Këto përjasje nuk i njohin gjuhës së jashtme një status të veçantë, e cila ‘konceptohet pavarësisht nga cilësitë e mendjes, truri’ dhe përbën në vetvete objektin e studimit”
(Chomsky, 1986:20)

Vlerësimi:


Vlerësohen nxënësit që dinë të dallojnë citimin dhe dinë ta shkruajnë duke përdorur shenjat e duhura të pikësimit.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 2, f. 45.

Gjeni informacion në lidhje me gabimet gjuhësore që bëhen në shtyp dhe në media, duke shfrytëzuar tekste librash dhe faqe interneti.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshtkrim Tema mësimore: Shkrimi i citimeve (Ora II) | | Situata e të nxënit: Vepra letrare, shkrime nga interneti. | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--|-----------|--|--|--------|--|--|------------------|--|--|----------------|--|--|-----------------|--|--|-----------------|--|--|
| <p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">dallon gabimet gjuhësore në shkrimin e citimeve që bëhen në shtyp dhe në media, nga tekste librash;përdor drejt shenjat e pikësimit (tri pikat, kllapat, thonjëzat). | <p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none">- citim- shenja pikësimi | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, tabelë, vepra letrare, shkrime nga interneti.</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Letërsi</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Punë në grupe</i></p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme.</i></p> <p>Nxënësit plotësojnë diagramin me rregulla të përdorimit të citimeve dhe shenjave të pikësimit.</p> <div style="text-align: center;"></div> <p>Nxënësit paraqesin informacionet në lidhje me gabimet gjuhësore që bëhen në shtyp dhe në media, nga tekste librash dhe faqet e internetit që ata kanë shfrytëzuar.</p> <ul style="list-style-type: none">Fakte nga librat <table><tr><td>Fragmenti</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Autori</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Titulli i librit</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Viti i botimit</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Vendi i botimit</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Shtëpia Botuese</td><td></td><td></td></tr></table> | | Fragmenti | | | Autori | | | Titulli i librit | | | Viti i botimit | | | Vendi i botimit | | | Shtëpia Botuese | | |
| Fragmenti | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Autori | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Titulli i librit | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti i botimit | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Vendi i botimit | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shtëpia Botuese | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

• **Fakte nga interneti**

| | | |
|--------------------|--|--|
| Fragmenti | | |
| Autori | | |
| Titulli i shkrimit | | |
| Viti i botimit | | |
| Adresa e faqes | | |

Diskutohen rastet e gabimeve gjuhësore të gjetura nga nxënësit.
Ato evidentohen në një tabelë në dërrasën e zezë.

Gabime gjuhësore

- Përdorim i gabuar i thonjëzave
- Përdorim i gabuar i pikës
- Përdorim i gabuar i presjes

Diskutim

Diskutohet rreth teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Nxënësit mbajnë shënim citimet nga njëri-tjetri dhe më pas hartojnë një tekst ku t'i përfshijnë ato.

Lexohen punimet e nxënësve dhe vlerësohen.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që kanë gjetur gabime gjuhësore te fragmentet e shkëputura nga librat apo faqet në internet.

Vlerësohen nxënësit që kanë përfshirë në shkrimin e tyre për teknologjinë citime të shokëve të tyre.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 4, f. 46.

Zgjidhni një temë studimi dhe kërkoni studime letrare apo në internet se çfarë kanë shkruar të tjerët për të. Përzgjidhni dhe shkruani pesë citime.

| | | | |
|---|----------------------------|---|------------------|
| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
| Tema mësimore: Strategji dhe teknika për t'u bërë një dëgjues i mirë | | Situata e të nxënësve: Dëgjojnë sekunca të ndryshme tekstesh joletrare dhe u kërkohet nxënësve të mbajnë shënime gjatë dëgjimit. | |

| | |
|--|--|
| <p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është i vëmendshëm ndaj folësit ose ndaj mesazhit që dëgjon; - demonstroi të dëgjuarit e qëllimshëm, duke mbajtur shënime, duke bërë pyetje dhe duke kërkuar sqarime; - përmbledh idetë e dëgjuara, si dhe diskuton rreth tyre; - analizon qëllimin e folësit ose të mesazhit që dëgjon. | <p>Fjalët kyçe: Strategji të paradëgjimit Strategji gjatë dëgjimit Strategji të pasdëgjimit</p> |
| <p>Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i>, shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari</p> |
| <p>Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale</p> | |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stuhi mendimi • Leksion i përqendruar • Organizues grafik • Punë në grupe | |
| <p>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtari paraprake - Stuhi mendimi <p>I. Dëgjohen disa materiale dhe u kërkohet nxënësve: Identifikohet qëllimi i dhënësit të informacionit dhe specifikohet rrjedha logjike e tekstit, duke përzgjedhur informacionin që dëgjohej: <i>konceptet, faktet, të dhënat</i> etj., duke dalluar informacionet parësore nga ato dytësore.</p> <p>II. Zhvillimi i situatës</p> <p>Hapi i dytë – Leksion i përqendruar</p> <p>Të dëgjuarit është aftësi mendore. Dikush mund të bëhet dëgjues i mirë përmes disa strategjive dhe teknikave të të dëgjuarit. Të dëgjuarit e mirë është mbi të gjitha një përvetësim i vazhdueshëm mendor.</p> | |
| <p>Hapi i tretë- Organizues grafik Strategji të paradëgjimit</p> <p>Qartësoni qëllimin për të cilin po e dëgjoni tekstin: <i>për informacion, për të mësuar, për të marrë udhëzime, për kënaqësi</i> etj. Nëse e keni të qartë qëllimin për të cilin po dëgjoni një tekst, jeni në gjendje të përcaktoni se çfarë do të dëgjoni me më shumë vëmendje.</p> | |

Strategji gjatë dëgjimit

Ndjekja e rrjedhës logjike

Mbajtja e shënimeve

Sjellja: vëmendja

Strategji të pasdëgjimit

Reflektim

Vlerësim

Rishikim

- Ndiqni folësin dhe tregohuni i vëmendshëm, i pranishëm dhe i gatshëm për ta përvetësuar informacionin e dëgjuar.
- Vendosni kontaktin me sy. Qëndroni ballë për ballë, por mos e ndërprisni folësin.
- Dëgjoni dhe fotografoni me mend ato që folësi është duke thënë. Mos e ndërprisni atë dhe mos ndryshoni temë.
- Dëgjoni për mesazhin brenda mesazhit.
- Nëse keni diçka të paqartë, bëni pyetje për të zgjeruar të kuptuarit dhe kërkonit sqarime në momentin e përshtatshëm. Jepini folësit vlerësimin tuaj rreth asaj që dëgjuat.

Hapi i katërt- Punë në grupe

Ushtrimi 1

Ndahet klasa në grupe ku secili punon më ushtrimet në tekst. Dëgjohen materialet e përgatitura dhe mbahen shënime duke përdorur simbole dhe shenja përkatëse.

Ushtrimi 2

Paragrafi 1: Eqrem Çabej solli dhe zbatoi në gjuhësinë shqiptare metodat dhe arritjet shkencore të gjuhësisë evropiane, duke kontribuar shumë në ngritjen e nivelit shkencor të studimeve gjuhësore shqiptare. Eqrem Cabej punoi shumë në disa fusha të dijes, por u shqua sidomos në fushën e historisë së gjuhës, në trajtimin e problemeve të origjinës së gjuhës shqipe...

Paragrafi 2: Veprat themelore të tij janë: “Studime etimologjike në fushë të shqipes”, në shtatë vëllime, I “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe”...

Paragrafi 3: Përveç veprave, ai ka botuar një varg studimesh në revista shkencore brenda e jashtë vendit dhe ka mbajtur dhjetëra referate e kumtesa në kongrese e konferenca kombëtare...

Paragrafi 4: Ai është bashkautor edhe në një varg veprash në fushën e gjuhës së sotme, siç janë...

Paragrafi 5: Veprat e Prof. Eqrem Çabejit janë botuar në tetë vëllime, në Prishtinë, me titullin...

Përforsim njohurish

Hapi i pestë – Tabelë e vlerësimit

Grupet dyshe vlerësojnë (me pikë, nga 1 deri në 10) shokun/shoqen e bankës në lidhje me zbatimin e teknikave të të dëgjuarit gjatë një seance dëgjimi, duke plotësuar tabelën e dhënë në tekst.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- janë të vëmendshëm ndaj folësit ose ndaj mesazhit që dëgjojnë;
- analizojnë qëllimin e folësit ose të mesazhit që dëgjojnë.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për vëmendjen ndaj mesazhit që dëgjojnë;
- për analizën e qëllimit të informacionit që dëgjojnë;
- për mbajtjen e shënimeve korrekte rreth materialit të dëgjuar;
- për vlerësimin ndaj informacionit të dëgjuar.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|------------------------|--|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Lakimi i përemrave pronorë | | Situata e të nxënit: Teksti: “Biografia e Eqrem Çabej”. | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• lakon përemrat pronorë dhe i përdor në trajtën e duhur në fjali.• njeh përdorimet e gabuara të përemrit pronor në rasë dhe në gjini. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">- përemër pronor- lakim | |
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, skedë, bllok gramatike, tabelë | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Punë në grup</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <i>Veprimtari paraprake</i> Mësuesi/ja paraqet tekstin “Biografia e Eqrem Çabej” në videoprojektor dhe u kërkon nxënësve të nënvizojnë në tekstin e tyre përemrat pronorë. Një nxënës i shkruan në tabelë. | | | |
| <i>Ndërtimi i njohurive të reja:</i> Mësuesi/ja ndërton skemën në tabelë: ❖ <i>Trajtat e përemrave pronorë kur përdoren të shoqëruar me emra</i> | | | |

| Veta e parë | | | | Veta e dytë | | | | Veta e tretë | | | |
|----------------|-----------------|------------------|-------------------|-----------------|-----------------|------------------|-------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|--|---|
| Njëjës | | Shumës | | Njëjës | | Shumës | | Njëjës | | Shumës | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| (djali) im | (vajza) ime | (djemtë) e mi | (vajzat) e mia | (djali) yt | (vajza) jote | (djemtë) e tu | (vajzat) e tua | (djali) i tij/ (djali) i saj | (vajza) e tij/ (vajza) e saj | (djemtë) e tij (djemtë) e saj | (vajzat) e tij/ (vajzat) e saj |
| (djali) ynë | (vajza) jonë | (djemtë) tanë | (vajzat) tona | (djali) juaj | (vajza) juaj | (djemtë) tuaj | (vajzat) tuaja | (djali) i tyre | (vajza) e tyre | (djemtë) e tyre | (vajzat) e tyre |

❖ **Trajtat e përemrave pronorë kur përdoren më vete**

| Veta e parë | | | | Veta e dytë | | | | Veta e tretë | | | |
|-------------|---------|--------|-------|-------------|------------|--------|--------|---------------------------------------|---------------------------------------|--|---|
| Njëjës | | Shumës | | Njëjës | | Shumës | | Njëjës | | Shumës | |
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| imi | imja | yni | jona | yti | jotja | juaji | juaja | (djali) i tij/ (djali) i saj | (vajza) e tij/ (vajza) e saj | (djemtë) e tij (djemtë) e saj | (vajzat) e tij/ (vajzat) e saj |
| të mitë | të miat | tanët | tonat | të tutë | të tuat | tuajt | tuajat | (djali) i tyre | (vajza) e tyre | (djemtë) e tyre | (vajzat) e tyre |

Rregulla!

- Përemrat pronorë lakohen së bashku me emrin dhe vendosen pas ose para tij.
- Kur qëndrojnë pas një emri, ky i fundit përdoret në trajtën e shquar: *shoku im, vajza jote*.
- Përemrat pronorë të vetës së tretë kur përcaktojnë një emër të gjinisë mashkullore kanë nyjën *i* (qyteti i tij); kur përcaktojnë një emër të gjinisë femërore kanë nyjën *e* (klasa e tij).

Përdorimet e gabuara të përemrave pronorë

- Mospërshtatja në rasë

time e përdorur gabimisht në vend të *sime*
times e përdorur gabimisht në vend të *simes*
tonë e përdorur gabimisht në vend të *sonë*
tënde e përdorur gabimisht në vend të *sate*
tuaj e përdorur gabimisht në vend të *suaj*.

- Mospërshtatja në gjini

jonë e përdorur gabimisht në vend të *ynë*
tonë / tona e përdorur gabimisht në vend të *tanë*.

Nxënësit shkruajnë tabelat dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimi 1.

Përemrat pronorë nga teksti “Biografia e Eqrem Çabej”, të shkruar në tabelë, plotësohen me vetën dhe rasën e tyre.

Të ndarë në grupe, nxënësit zhvillojnë ushtrimet e tjera në tekst, f. 52.

Diskutohen ushtrimet.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dinë të dallojnë përemrat vetorë, rasën dhe vetën e tyre. Vlerësohen nxënësit që dallojnë përdorimet e gabuara të përemrave pronorë.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 7, f. 52.

Përkthyeri dy pajisje elektronike, duke përdorur sa më shumë përemra pronorë.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Kronika | | Situata e të nxënit: Lexohen modele kronikash të llojeve të ndryshme. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - lidh informacionin e një kronike me imazhin e lidhur me të; - lexon për të kuptuar një kronikë dhe elementet e saj kyçe; - vendos të dhënat e një kronike duke respektuar rendin kronologjik; - shkruan një kronikë. | | Fjalët kyçe: Kronikë Planifikimi i shkrimit Hartimi i shkrimit | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: modele kronikash, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shprehjet me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari Histori Edukim Fizik | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none">Stuhi mendimiPraktikë e drejtuarOrganizues grafikPunë në grup | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT | | | |
| I. Veprimtari paraprake Lidhen përkufizimet me figurat përkatëse të paraqitura në tekstin mësimor. Argumentohet lidhja e imazhit me informacionin e dhënë në paragrafët përkatës. | | | |

I. Zhvillimi i situatës**Leksion i përqendruar**

Hapi i dytë – Kronika është një lloj shkrimi, që u kushtohet lajmeve të përditshme ose ngjarjeve historike. Rrëfimi ndjek një rend kronologjik dhe autori nuk ndalet tek analiza ose tek interpretimi i ngjarjeve, pasi ai duhet të tregohet objektiv dhe i paanshëm.

Hapi i tretë - Lexim dhe koment

Lexohet kronika e dhënë në ushtrimin 2 dhe analizohen elementet e saj: struktura dhe veçoritë gjuhësore.

Veprimtaria: Festivali Folklorik

Koha: maj

Kush mori pjesë: Kampet Rajonale të Restaurimit

Hapi i katërt -Punë me shkrim

Shkruani në fletore kronikën e një ngjarjeje kulturore ose sportive.

Kujdesuni që kronika të përmbajë të gjitha elementet thelbësore të një kronike të mirëndërtuar:

Gjatë ndërtimit të saj përgjigjuni pyetjeve:

Kush?.....

Çfarë?.....

Kur?.....

Ku?.....

Përse?.....

Si?.....

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit realizojnë shkrimin e kronikës sipas hapave përkatës të shkrimit;
- shkruajnë qartë dhe me një stil vetjak;
- shtjellojnë temën dhe e zbërthejnë atë;
- përdorin leksik të pasur gjatë shkrimit të kronikës.

Vlerësimi:


Nxënësit do të vlerësohen:

- për realizimin e hapave të përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, për përdorim e strategjive të ndryshme për të planifikuar shkrimin, organizimin në mënyrë logjike të mendimeve dhe të ideve;
- për redaktimin e shkrimit duke përdorur edhe mendimet e të tjerëve;
- për të shkruarit e qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike, tekste për qëllime dhe për audienca të ndryshme;
- për të shkruarit e teksteve të llojeve të ndryshme për qëllime personale dhe funksionale, duke zbatuar kriteret e domosdoshme për secilin lloj (formë);
- për zbatimin e rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimet e tij dhe në procesin e redaktimit;
- për përdorimin e materialeve të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit të shkrimit.

| | | | |
|---|--------------------------------------|--|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Gjymtyrët e dyta dhe klasifikimi i tyre (ora II) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përcakton gjymtyrët e dyta në një fjali dhe argumenton përgjigjen e tij;• analizon rendin e gjymtyrëve të dyta në fjali. | | Fjalët kyçe: - gjymtyrë kryesore - gjymtyrë të dyta | |
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë, bllok gramatike. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Skelet peshku, Stuhi mendimi, Diagram Veni | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Veprimtari paraprake Mësuesi/ja përmes teknikës “Skelet peshku” paraqet në tabelë gjymtyrët e fjalisë: <i>kryesore</i> dhe të dyta. <div></div> Diskutohet me nxënësit rreth njohurive të tyre të mëparshme. Me se shprehen këto gjymtyrë? <div><div>Kryefjala</div><div>Kallëzuesi</div><div>Kundrinorët</div><div>Rrethandorët</div><div>Përcaktorët</div></div> Nxënësit plotësojnë diagramet. | | | |

Ndërtimi i njohurive të reja:

Mësuesi/ja me Diagram Veni paraqet të përbashkëtat dhe ndryshimet mes gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta.



Të mbajmë mend!

- *Si fjalë drejtuese për kundrinorët dhe rrethanorët mund të shërbejë edhe një gjymtyrë e dytë.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimi 1, f. 57.

Nxënësit dallojnë gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta.

Ushtrimi 2, f. 57.

Nxënësit dallojnë fjalët drejtuese të kundrinorëve dhe të rrethanorëve.

Ushtrimi 3, f. 57.

Nxënësit, duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna, dallojnë gjymtyrët e fjalisë së ndërtuar nga vetë ato.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dinë të dallojnë gjymtyrët kryesore nga gjymtyrët e dyta.

Vlerësohen nxënësit që dinë të dallojnë fjalët drejtuese të kundrinorëve dhe të rrethanoreve.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 7, f.57.

Shkruani një tekst të shkurtër me temë të lirë dhe dalloni aty gjymtyrët e dyta të fjalive, si dhe fjalët e tyre drejtuese.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|-----------------------------|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Gjymtyrët e dyta dhe klasifikimi i tyre (ora II) | | Situata e të nxënit: | |

| | |
|---|---|
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • analizon rendin e gjymtyrëve të dyta në fjali; • dallon përcaktorët dhe fjalët e tyre drejtuese. | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - gjymtyrë kryesore - gjymtyrë të dyta |
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë, bllok gramatike. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Punë e pavarur dhe në grup</i> | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Veprimtari paraprake</i></p> <p>Nxënësit lexojnë tekstet e tyre, ku dallojnë gjymtyrët e dyta të fjalive si dhe fjalët e tyre drejtuese.</p> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja:</i></p> <p>Mësuesi/ja shpjegon marrëdhëniet që shprehin gjymtyrët e dyta me fjalën drejtuese.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kundrinorët shprehin marrëdhënie objektore dhe hyjnë në lidhje drejtimi me fjalën drejtuese. • Rrethanorët shprehin marrëdhënie rrethanore mes një procesi dhe rrethanës në të cilën zhvillohet ai. Mes rrethanorëve dhe fjalëve të tyre drejtuese, realizohet lidhja sintaksore e bashkimit. • Përcaktorët hyjnë në marrëdhënie përcaktore me fjalën drejtuese dhe lidhen me të me anë të lidhjes sintaksore <i>të përshtatjes, drejtimit apo bashkimit</i>. Si fjalë drejtuese mund të shërbejë: <i>një kryefjalë, kundrinor, rrethanor</i>. • Përcaktori kallëzuesor dallon nga gjymtyrët e tjera, pasi del me lidhje të dyfishtë sintaksore: ai lidhet njëkohësisht me kallëzuesin dhe me kryefjalën ose kundrinorin. <p><i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup</i></p> <p>Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.</p> | |

| |
|---|
| <p>Ushtrimi 6, f. 57. Nxënësit dallojnë pohimet e sakta. Ushtrimi 4, f. 57. Nxënësit dallojnë përcaktorët dhe fjalët e tyre drejtuese. Ushtrimi 5, f. 57. Dy nxënës shkruajnë në tabelë shembuj me grupe fjalësh ku të realizohet lidhja sintaksore: me drejtim, me bashkim, me përshtatje.</p> <p>Diskutohen ushtrimet së bashku me nxënësit.</p> |
| <p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit që dinë të dallojnë përcaktorët dhe fjalët e tyre drejtuese.</p> <p>Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst të shkurtër me temë ë lirë me grupe fjalësh ku të realizohet lidhja sintaksore: me drejtim, me bashkim, me përshtatje.</p> |

MODULI III

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|---|---------------------|---|-----------|
| Tema mësimore: Veçoritë gjuhësore dhe stilistike të teksteve udhëzuese | | Situata e të nxënit: Lexohen udhëzime të ndryshme: manuale, kode, ligje, rregullore. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none">merr pjesë në diskutimet në klasë për tekstet, duke marrë në konsideratë qëllimin, karakteristikat dhe situatën e komunikimit në një tekst, si dhe përmbledh përfundimet e një teksti;përdor strategji të të lexuarit si: mbajtja e shënimeve, përmbledhja e informacionit etj., përmes të cilave demonstroi të kuptuarit dhe të reflektuarit për mesazhet që transmeton teksti dhe ndalet në mënyrë të ndërgjegjshme te lloji i standardeve që duhen përdorur për një interpretim cilësor të teksteve të ndryshme;përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të tekstit udhëzues. | | Fjalët kyçe: Teksti udhëzues Rend logjik Strukturë Informacione | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive) | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe | | | |

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
 Kompetenca e të menduarit
 Kompetenca e të nxënësve
 Kompetenca personale
 Kompetenca qytetare
 Kompetenca digjitale

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

- Diskutim njohurish paraprake
- Stuhi mendimi
- Organizuesi logjik i analogjisë
- Punë në grup
- Praktikë e drejtuar
- Rishikim

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake - Stuhi mendimi

Lexohen fragmente të ndryshme tekstesh udhëzuese:

Përdorimi i modemit tuaj USB

Ju lutemi përdorni pajisje origjinale ose pajisje që janë të autorizuar. Përdorimi i ndonjë pajisje të paautorizuar mund të ndikojë në punën e modemit tuaj, dhe të shkelë rregullat përkatëse kombëtare rreth terminaleve të telekomunikacionit.

• Shmangni përdorimin e modemit pranë ose brenda strukturave metalike apo institucioneve që mund të lëshojnë valë elektromagnetike. Në të kundërt, kjo mund të shkaktojë ndërprerjen e sinjalit.

- Kërkohet nga nxënësit që të diskutojnë rreth qëllimit të shkrimit dhe informacionit kyç që ai mbart.

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Leksioni i përqendruar

Tekstet udhëzuese kanë si qëllim të këshillojnë, sugjerojnë, ndihmojnë lexuesin hap pas hapi në lidhje me një veprimtari të caktuar. Në to përfshihen: nenet e ligjeve, manualët mësimore, recetat e gatimit, rregulloret e ndryshme, p.sh.: rregullorja e shkollës, klasës, rregullat e një loje etj., udhëzimet e ilaceve, udhëzimet e hartave, postera me udhëzime etj.

Vërehen në tekst ilustrimet figurative: të drejtat e fëmijëve dhe manuali i përdorimit të një aparati celular.

Hapi i tretë - Organizuesi grafik i analogjisë

Veçoritë gjuhësore dhe stilistike të teksteve udhëzuese

Në tekstet udhëzuese gjuha e përdorur është formale. Përdoren terma teknikë, administrativë apo të fushave të ndryshme, të ndërthurura këto me leksikun e gjuhës së përditshme.

Gjuha është gjithnjë standarde, e thjeshtë dhe e qartë.

- Nga ana sintaksore, përdoren fjalitë me bashkërenditje, por edhe ato me nënrenditje, p.sh.: shkakore, kushtore. Këto fjali janë të qarta, pa nënkuptime dhe kryesisht të shkurtra.

- Në tekstet udhëzuese përdoret mënyra urdhërore dhe ajo lidhore, por edhe dëftore.

Foljet, të cilat janë pjesë dominante e ligjëratës, janë në kohën e tashme, të formës veprorë ose joveprorë. Përdoret veta e tretë dhe format foljore modale: *duhet, do, mund*.

Veçoritë gjuhësore dhe stilistike të teksteve përshkruese
Ky lloj teksti është i pasur me mbiemra dhe fjalë përshkruese.
Përdoren ndajfolje, parafralë, si dhe fraza që tregojnë pozicionin në hapësirë të asaj që përshkruhet.
Foljet janë përgjithësisht në kohën e tashme dhe në të pakryerën.
Tekstet përshkruese objektive karakterizohen nga gjuha formale dhe, herë pas here, kanë fjalë teknike dhe terma.
Tekstet përshkruese subjektive dallohen nga gjuha e figurshme, e pasur me metafora, krahasime dhe epitete, që e bëjnë përshkrimin të gjallë dhe të prekshëm nga lexuesit.

Hapi i tretë - Praktikë e drejtuar dhe rishikim

Pasi lexohet teksti “**Arti i të shkruarit**”, punohet me kërkesat e mëposhtme:

1. Punohet për të nxjerrë kuptimin e tekstit (shpjegohet shkurt se çfarë nxënësit kuptuan dhe çfarë jo nga teksti).
2. Përcaktohen pikat kyçe të informacionit në tekst.
3. Dallohet struktura e tekstit, organizimi i jashtëm, mënyra se si zhvillohet ideja kryesore e autorit.
4. Bëhen disa pyetje rreth tekstit duke lidhur informacionet kryesore me përvojën vetjake.
5. Përmbledhet teksti me fjalë të përgjithshme.

Hapi i katërt- Punë në grupe

Nxënësit punojnë me ushtrimet në tekst:

Grupi I: ushtrimi 1

Grupi II: ushtrimi 2

Grupi III: ushtrimi 3

Grupi IV: ushtrimi 4

- Renditni udhëzimet e tekstit “Arti i të shkruarit”, duke ruajtur vijimësinë logjike të përdorur në fragment. (Secili udhëzim të shprehet me një fjali.)

- Çdo ditë duhet të shkruajmë nga pak, po ashtu si ai sportisti që stërvitet rregullisht për të arritur rezultate të larta në gara.

- Për të pasur sukses në shkrimin e një krijimi, duhet t’u përmbahemi edhe kërkesave e rregullave të caktuara.

- Hapi tjetër është të vendosim përse do të shkruajmë, që të zgjedhim temën (vijohet deri në fund me udhëzimet sipas këtij udhëzimi).

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë veçoritë e tekstit udhëzues;
- analizojnë strukturën e tekstit udhëzues.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për analizën e strukturës së tekstit udhëzues;
- për analizën gjuhësore të tekstit udhëzues.

Detyra dhe puna e pavarur: Shkruani rregulloren e klasës suaj. Mbani parasysh udhëzimet e dhëna nga autori në tekstin e mësipërm.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|---|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Teknikat e shkrimit të teksteve udhëzuese | | Situata e të nxënit: Lexohen fragmente të ndryshme udhëzuese ku janë përdorur teknika të ndryshme shkrimi. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon teknikat e shkrimit të tekstit udhëzues; - dallon udhëzimet e përgjithshme nga ato specifike; - analizon teknikat e përdorura në një tekst udhëzues; - interpreton kuptime të fjalëve në kontekstin e përdorur. | | Fjalët kyçe: Teksti udhëzues Rend logjik Teknika të shkrimit Udhëzime të përgjithshme dhe specifike | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: Materiale të ndryshme tekstesh udhëzuese: kode, ligje, rregullore, manuale; libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Diskutim njohurish paraprake

Rrjeti i diskutimit

Këmbim njohurish

Punë në grup

Praktikë e drejtuar

Di/Dua të di/Mësova

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Leksion i përqendruar

Teknikat e shkrimit të udhëzimeve:

Titulli i udhëzimeve paraqet qartë përmbajtjen e tyre.

Situata e komunikimit synon përcjelljen e informacioneve nga dhënësi te marrësi.

Përdoren folje që i tregojnë lexuesit për të bërë diçka. Shembuj: “hapni valvulën ...”, “shtypni butonin ...” etj.

Renditen udhëzimet hap pas hapi, sipas rëndësisë.

Vendosen shënime dhe paralajmërime në fillim të udhëzimeve (instruksioneve), ose paraqitet lista e objekteve, përbërësve.

Jepen shpjegime specifike dhe të domosdoshme paraprakisht, psh: “Para se të filloni, sigurohuni që ...”

Nuk jepen informacione konceptuale përgjatë udhëzimeve.

Shkruhet në përshtatje me audiencën dhe përdoret një nivel qartësisht i detajuar në përputhje me aftësitë e saj.

Udhëzimet kanë një numër të kufizuar dhe jo të tejzgjatur, në mënyrë që marrësi i informacionit të mos ketë ngarkesë informacioni.

Udhëzimet duhet të jenë të plota dhe të mos kenë paqartësi. Shoqërojnë ato me ilustrime figurative, harta, grafikë, tabela sipas përmbajtjes së tyre.

Hapi i tretë - Di: Dua të di: Mësova:

a. Ç'cilësi fiton teksti nga burime të ndryshme informative?

b. Cilat janë teknikat kyçe të tekstit udhëzues?

Nxënësit punojnë në tabelë për:

1. plotësimin e një skeme për teknikat e shkrimit të tekstit udhëzues;

3. nxjerrjen e konkuzioneve të veprimtarisë.

Grupi 1. Ndërtoni skemën për

Grupi 2. Karakteristikat e tekstit udhëzues

Hapi i katërt - Punë në grupe

Punohen ushtrimet në tekstin e nxënësit.

- Shpjegoni kuptimin leksikor të fjalës *kompetencë*. Zëvendësojeni me një fjalë sinonime, duke ruajtur kuptimin në kontekstin e dhënë.

KOMPETENCË f.

1. Njohuri të thella, të plota e të përpikta që ka dikush në një fushë të dijes ose për një problem të caktuar dhe që i japin atij siguri; aftësi. Flet me kompetencë.
2. E drejtë që ka dikush për të zgjidhur një çështje në bazë të ligjeve e të rregullave në fuqi; rrethi i çështjeve që mund të shqyrtojë e mund të zgjidhë një organ shtetëror a një zyrtar i caktuar. Kompetenca ligjore. Kompetencat e ministrisë (e drejtorisë, e gjyqit). Në kompetencën e... Jashtë kompetencave të mia. Ka kompetencë. Zgjerohet (ngushtohet, kufizohet) kompetencat e dikujt.

KOMPETENCË/AFTËSI**Hapi i pestë – Përforsim njohurish**

Nxënësit punojnë të pavarur dhe përcaktojnë karakteristikat e situatës së komunikimit për tekstin e dhënë, me temë: “Çfarë duhet të bëjmë për të shkruar mirë?” duke iu përgjigjur pyetjeve:

- a) Cili ishte mesazhi?
 - b) Ç’lloj marrësi ishte?
 - c) Kush është dërguesi dhe çfarë qëllimi ka në këtë tekst?
 - ç) Cili është kanali i komunikimit?
 - d) Ç’kod përdor për të dhënë mesazhin?
 - e) Cili ishte objekti i mesazhit të dhënë?
- Nxirren konkluzionet e punës.*

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë veçoritë e tekstit udhëzues;
- analizojnë strukturën e tekstit udhëzues.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për analizën e teknikave të shkrimit të tekstit udhëzues.
- për analizën gjuhësore të tekstit udhëzues.

Detyra dhe puna e pavarur: Lidhni informacionin e tekstit me përvojat tuaja në procesin e të shkruarit. Cilat janë disa udhëzime të tjera që do t’u sugjeronit shokëve tuaj? Shkruani jo më pak se pesë udhëzime.

24. TESTOJMË NJOHURITË GRAMATIKORE

Tremujori I

1. Përemri pyetës që nuk ka kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës është:
a. i cili b. se c. i sati
2. Cila trajtë e shkurtër e bashkuar nuk është shkruar saktë?
a. m'i b. t'i c. t'a
3. Qarko fjalën që nuk është sinonimike me tjerat.
a. vetëdije b. subkoshiençë
c. ndërgjegje
4. Përemri në fjalinë *Atje është mësuesja ime*, është:
a. vetor b. dëftor
5. Përemri lidhor në fjalinë *E pranova ftesën, të cilën po e prisja prej kohësh*, kryen funksionin e:
a. kryefjalës b. kundrinorit të drejtë
6. Qarko alternativën e saktë për të plotësuar fjalinë: '_____ nuk u pëlqeu vendimi im.'
a. Disa b. Disave
7. Gjени trajtën e saktë:
a. Jua thashë juve të vërtetën.
b. Ua thashë juve të vërtetën.
8. Gjegjësjja shqipe e fjalës *barrierë* është:
a. pengesë b. ndalesë
9. Në një citim në fillim shkruhet?
a. t. itulli b. autori
10. Cila është shkruar saktë?
a. Gjuha e një kombi nuk ndalet kurrë ka thënë Naimi ynë.
b. "Gjuha e një kombi nuk ndalet kurrë", - ka thënë Naimi ynë.
11. Cili përemër pyetës ka kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit, rasës?
a. i cili b. se c. çfarë d. ç'
12. Cila trajtë e shkurtër e bashkuar nuk është shkruar saktë?
a. na i b. na'i c. ia
13. Qarko fjalën që nuk është sinonimike me tjerat.
a. rinovoj b. evokoj c. përtërij
14. Përemri në fjalinë: *Ata do të kënaqen në udhëtim*, është:
a. vetor b. dëftor
15. Qarko alternativën e saktë për të plotësuar fjalinë: *Mendimi i _____ ishte të merrnin pjesë*.
a. të gjithë b. të gjithëve
16. Dalloni pohimin e saktë:
a. Mes rrethanorit dhe kallëzuesit vendoset lidhje drejtimi.
b. Mes rrethanorit dhe kallëzuesit nuk vendoset lidhje drejtimi.
17. Gjени trajtën e saktë:
a. Ia tregove atyre të vërtetën.
b. Ua tregove atyre të vërtetën.

18. Gjegjësjja shqipe e fjalës *multilaterale* është:

- a. shumëpalëshe b. shumëplanëshe

19. Qarko përdorimin e saktë të përemrit pronor.

- a. Shoku jot u diplomua.
b. Shoku yt u diplomua.

20. Dalloni pohimin e saktë:

- a. Kallëzuesi mund të shërbejë si fjalë drejtuese për përcaktorët.
b. Kallëzuesi nuk mund të shërbejë si fjalë drejtuese për përcaktorët.

21. Cili përemër pyetës nuk e ka kategorinë gramatikore të rasës?

- a. kush b. se c. sa

22. Dalloni pohimin e saktë:

- a. Fjala drejtuese e drejton kundrinorin në një rasë të caktuar.
b. Fjala drejtuese nuk e drejton kundrinorin në një rasë të caktuar.

23. Qarko fjalën që nuk është sinonimike me tjerat.

- a. administrim b. mbarështim
c. përdorim c. kërkim

24. Përemri në fjalinë *Ajo që më tregove më befaso!*, është:

- a. vetor b. dëftor

25. Qarko përdorimin e saktë të përemrit pronor.

- a. Iu drejtova vajzës suaj.
b. Iu drejtova vajzës tuaj.

26. Qarko përdorimin e saktë të përemrit pronor.

- a. Prej sjelljes tënde u ndëshkua e gjithë klasa.

b. Prej sjelljes sate u ndëshkua e gjithë klasa.

27. Gjeni trajtën e saktë:

- a. Na e keni bërë të vështira provimet.
b. Na i keni bërë të vështira provimet.

28. Qarko fjalën që nuk është sinonimike me tjerat.

- a. emëroj b. caktoj c. vë
c. shkarkoj


29. Dalloni pohimin e saktë:

- a. Numri i kundrinorëve në fjali nuk është i kufizuar.
b. Numri i kundrinorëve në fjali është i kufizuar.

30. Gjeni trajtën e saktë:

- a. Na e keni bërë të vështirë provimin.
b. Na i keni bërë të vështirë provimin.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshkrim Tema mësimore: Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras (ora I) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">përcakton rastet kryesore kur fjalët shkruhen njësh;përdor saktë fjalët që shkruhen njësh. | | Fjalët kyçe: emra, mbiemra, lidhëza, pjesëza, pasthirrma, numërorë, fjalë të përbëra, fjalë me parashtesa, fjalë të përbëra me lidhje përcaktore, fjalë të përbëra me lidhje këputore. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, fisha, tabelë, “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe”. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Puna me fisha, Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Punë në grup | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Veprimtari paraprake Mësuesi/ja shpërndan disa fisha, në të cilat janë të rreshtuara fjalë që shkruhen njësh. Fishat mund të paraqiten edhe me videoprojektor, ose fjalët mund të shkruhen në tabelë. | | | |
| Fisha 1. Mosmarrëveshje, fotoekspozitë, jashtëshkollor, kryeqytet, nëndrejtor, i paafte, juglindje, nëntëmbëdhjetë, aspak, ndonjëherë, kushedi, obobo, mirëdita, kësisoj, ngaqë, gjithçka. | | | |
| Fisha 2. Kryeredaktor, orëndreqës, i porsaardhur, i shumanshëm, trefish, verilindje, asnjëherë, tjetërkush, gjithashtu, përveçqë, pothuaj, vetvetiu, gjësendi, kurrfarë, tatëpjetë. | | | |
| Fisha 3. Liridashës, projektbuxhet, luledelë, marrëveshje, i derisotshëm, parafytyrim, jozyrtar, veriperëndimor, i patëmetë, njëmbëdhjetë, faleminderit, kushdo, gjëgjëzë, matanë. | | | |
| Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”, “Pemë mendimi”. Me teknikën “Stuhi mendimi” ndërtohet diagrami i fjalëve që shkruhen njësh. | | | |




Nxënësit shkruajnë diagramin në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: “Pemë mendimi”, “Punë në grup”

Nxënësit drejtohen edhe një herë drejt fishave, fjalëve në tabelë ose të paraqitura në videoprojektor.

U kërkohet nxënësve që diagramin e mësipërm ta kthejnë në “Pemë mendimi”, duke i vendosur këto fjalë të ndarja e saktë.



Zhvillohen ushtrimet 1, 2, 3 f. 69, ku nxënësit:

- gjejnë dhe formojnë fjalë të përbëra me lidhje përcaktore;
- shprehin me fjalë të tjera shprehjet pasthirmore të dhëna.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.

Ali Dhrimo, Rami Memushaj, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011.

Shembuj fjalësh që shkruhen njësh

(f. 325-327) – joartificial, joekonomik, jolëndor, joestetik, jomuzikor, jonatyror, jonjerëzor, joobjektiv, jopaqësor, joproblematik, joshkencor, joshoqëror, jospecialist, joshterues, jotërheqës.

(f. 486-487) – mirëbesim, mirëdashës, mirëkuptim, mirëdita, mirëmbajtje, mirëmbërma, mirënjohje, mirëpres, mirëqenie, mirësjellje, mirinformim.

(f. 496-497) – mosbarazi, mosbesim, moshyrje, moskufizim, mosdashje, mosmirënjohje, mosparaqitje, mospajtim, mospërkim, mospërhapje, mosplotësim, mosprovim, mospërsëritje.

(f. 574-575) – paracaktoj, paradoksal, paradhënie, paraftalor, paraftazim, paraftytyrim, paragjykim, parakohës, parakuptoj, parakusht, paralajmërim.

(f. 684-694) – riafroj, riaktivizoj, riargumentim, riatdhesim, riautorizim, ridalje, ridetyrim, ribotim, ribisedim, ribërje, rigrupim, rifillim, rikontrolloj, rilexoj, ripajtoj, ripërkthim, riprodhim, ripunim.

Vlerësimi:


Vlerësohen nxënësit, të cilët përcaktojnë rastet kryesore kur fjalët shkruhen njësh.


Vlerësohen nxënësit, të cilët përdorin saktë fjalët që shkruhen njësh.

Detyre shtëpie:

Gjeni një artikull në gazetë dhe qarkoni të gjitha fjalët që shkruhen njësh. Tregoni pse.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|------------------------|----------------------|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshkrim Tema mësimore: Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras (ora II) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |

| | |
|--|---|
| <p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton rastet kryesore kur fjalët shkruhen ndaras; • i përdor saktë fjalët që shkruhen ndaras. | <p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - togfjalësh, shprehje parafjalore ose lidhëzore, pjesëz, ndajfolje, shprehje ndajfoljore. |
| <p>Burimet: Teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, fisha, tabelë, “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe”.</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Puna me fisha, Stuhi mendimi, Pemë mendimi, Punë në grup</p> | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Veprimtari paraprake Nga fragmente të shkëputura në gazeta, nxënësit lexojnë të gjitha fjalët që shkruhen njësh të përdorura në atë shkrim, duke treguar pse.</p> <p>Mësuesi/ja shpërndan disa fisha, në të cilat janë të rreshtuara fjalë që shkruhen ndaras. Fishat mund të paraqiten edhe me videoprojektor, ose fjalët mund të shkruhen në tabelë.</p> <p>Fisha 1.</p> <p>Lule blete, bojë qielli, së bashku, së dyti, së fundi, në qoftë se, gjer në, në mënyrë që, 120 për qind, u lodhëm, një mijë, tridhjetë e dy, për shembull, me radhë, Udhë të mbarë!</p> <p>Fisha 2.</p> <p>Bar zemre, bojë gruri, më së miri, për së largu, kaq sa, deri kur, kurdo që, qind për qind, u nisëm, dy milionë, njëqind e trembëdhjetë, me ngut, me padurim, Mirë se erdhe!</p> <p>Fisha 3.</p> <p>Vaj peshku, bojë vaji, për një, për dy, së pari, ashtu si, ngado që, pesë për qind, u afrova, tri mijë, dy milionë, shtatëdhjetë e tre, me ditë, me kohë, Mirë ardhshi!</p> | |
| <p>Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”, “Pemë mendimi”.</p> <p>Me teknikën “Stuhi mendimi” ndërtohet diagrami i fjalëve që shkruhen ndaras. Nxënësit drejtohen edhe një herë drejt fishave, fjalëve në tabelë ose të paraqitura në videoprojektor.</p>  <pre> graph TD SHKRUHEN_NDARAS[SHKRUHEN NDARAS] --> SHprehjet_parafjalore[Shprehjet parafjalore ose lidhëzore] SHKRUHEN_NDARAS --> Togfjalëshat_Er[Emërore + E.r. rriedhore] SHKRUHEN_NDARAS --> Togfjalëshat_kufim[Togfjalëshat me kufim mbiemëror] SHKRUHEN_NDARAS --> Ndajfoljet[Ndajfoljet dhe shprehjet ndajfoljore] SHKRUHEN_NDARAS --> Shprehjet_ndajfoljore[Shprehjet ndajfoljore të formuara nga dy fjalë] SHKRUHEN_NDARAS --> Shprehjet_pasthirrmore[Shprehjet pasthirrmore] SHKRUHEN_NDARAS --> Shprehjet_emërore[Shprehjet emërore për qind, për mijë] SHKRUHEN_NDARAS --> Numërorët_themelorë[Numërorët themelorë] SHKRUHEN_NDARAS --> Pjesëza_u[Pjesëza u e trajtave pësore-vetvete (para foljeve)] SHKRUHEN_NDARAS --> Ndërtimet_për[Ndërtimet për + emër në kallëzore të pashquar] </pre> | |



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Zhvillohet ushtrimi 4 f. 69, ku nxënësit:

- rishkruajnë fjalitë, duke korrigjuar rastet në të cilat nuk janë zbatuar rregullat e drejtshkrimit.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.

Ali Dhrimo, Rami Memushaj, “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2011.

Shembuj fjalësh që shkruhen ndaras

(f. 43) – ashtu edhe, ashtu që, ashtu si, ashtu siç

(f. 327) – jo vetëm..., por edhe, jo vetëm që..., po(r), jo vetëm që..., po(r) as, jo vetëm që..., po(r) edhe, jo vetëm që..., porse

(f. 602-615) – për dy, për nder, për në, për perëndi, për qind, për tre, për shkak, për shkak se, për së largu, për së mbari, për së gjalli, për së bashku, për së drejti, për së gjeri, për së afërmi

(f. 723-724) – së afërmi, së bashku, së jashtmi, së fundi, së dyti, së gjalli, së këndejmi, së koti, së largu, së pari, së paku, së tepërmi, së treti, së shpejti, së thelli, së voni

(f. 725) – si..., ashtu (e)dhe, si (e)dhe, si dhe, si urdhëron

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit, të cilët përcaktojnë rastet kryesore kur fjalët shkruhen ndaras.

Vlerësohen nxënësit, të cilët përdorin saktë fjalët, që shkruhen ndaras.

Detyrë shtëpie:

Gjeni një artikull në gazetë dhe qarkoni të gjitha fjalët që shkruhen ndaras. Tregoni pse.

| | | | |
|--|--------------------------------------|--|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtskrim Tema mësimore: Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përcakton rastet kryesore kur fjalët shkruhen me vizë lidhëse në mes;• i përdor saktë fjalët që shkruhen me vizë lidhëse në mes. | | Fjalët kyçe: - antonime, numërorë, emërtime, formime, emra të përbërë. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë, “Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe”. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë në grup | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Veprimtari paraprake Nga fragmente të shkëputura në gazeta, nxënësit lexojnë të gjitha fjalët që shkruhen ndaras të përdorura në atë shkrim, duke treguar pse. Ndërtimi i njohurive të reja: Mësuesi/ja në dy tabela paraqet rastet kur fjalët shkruhen me vizë lidhëse në mes dhe shembujt për secilin rast. | | | |

| SHKRUHEN ME VIZË LIDHËSE NË MES | SHEMBUJ |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Formimet e përftuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajta të ndryshme. - Formimet e përftuara nga bashkimi i dy antonimeve. - Formimet e përftuara nga bashkimi i dy numërorëve themelorë. - Formimet onomatopeike të përftuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajtë të ndryshuar. - Emërtimet e përbëra të njësive të matjes. - Emërtimet e përbëra të njësive të ndryshme të klasifikimit. - Formimet e tipit: - Formimet terminologjike të tipit: - Formimet kryesisht mbiemërore, që shprehin marrëdhënie plotësuese ose të ndërsjella. -Formimet që përmbajnë pjesëzën ish- përpara emërtimeve të ndryshme. - Emërtimet e përbëra të pikave të horizontit (fjalë e thjeshtë+fjalë e përbërë). - Emrat e përbërë të krahinave e të fshatrave. - Emrat e përbërë të krahinave e të fshatrave të përbërë gjeografikë të huaj. - Emrat ose mbiemrat e huaj të personave të përbërë prej dy a më shumë pjesësh. - Numërorët rreshtorë, kur vetë numri ose një pjesë e tij shënohet me shifra arabe. - Emërtimet e përvjetorëve dhe formimet e ngjashme me to, kur numërori shënohet me shifër. - Emërtimet e shkurtuara të institucioneve, të zyrave, të organizatave etj. | <ul style="list-style-type: none"> - copë-copë, fije-fije, tufa-tufa, vende-vende, lloj-lloj - aty-këtu, hyrje-dalje, pritje-përcjellje - dy-tri orë, 10-15 vjet, 5-6 ditë. - bam-bam, ham-ham, tik-tak - ditë-punë, vit-dritë, orë-normë. - grup-kulturë, grup-moshë - bar-bufë, hotel-restorant - ajër-ajër, ajër-tokë, tokë-tokë - analitiko-sintetik, ekonomiko-shoqëror - ish-drejtör, ish-ministër - jug-juglindje, veri-verilindje - Bardhaj-Reç, Zall-Herr - Nju-Jork, Hong-Kong - Mak-Donald. - Klasa e dytë, i 74-ti - Shkolla 9-vjeçare - AKP-ja (Agjencia Kombëtare e Provimeve) |

Kujdes!

- Në emërtimet gjeografike, që si pjesë të parë kanë një nyjë të përparme në gjuhët përkatëse, ndërmjet saj dhe pjesës tjetër nuk vihet vizë lidhëse: *Los Anxheles*.
- Pjesët përcaktuese të mbiemrave të personave shkruhen pa vizë lidhëse e pa kllapa: *Gavril Dara i Riu*.
- Kur numërori rreshtor shkruhet me shifër romake, përdoret pa prapashtesë dhe pa nyje të përparme: klasa I, Kreu XVI.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në grupe dhe në punë të pavarur zhvillohen ushtrimet 1, 2, 3, f. 72, ku nxënësit:

- shkruajnë formimet që mund të formohen nga përsëritja e disa fjalëve të dhëna;
- shkruajnë fjalë që mund të përftohen nga bashkimi i antonimeve;
- rishkruajnë shembujt e dhënë, duke i kthyer në numra numërorët e shënuar me fjalë.

Për mësuesit, material ndihmës për këtë temë mësimore

Ali Dhrimo, Rami Memushaj, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011.

Shembuj fjalësh që shkruhen me vizë lidhëse në mes

- (f. 43) ashtu-ashtu, ashtu-kështu
 (f. 120) copë-copë,
 (f. 163) ditë-punë, ditë-njeri
 (f. 168) dora-dorë, dora-dorën, dora-dorës
 (f. 182) dy-tre (djem), dy-tri (vajza)
 (f. 306) hyrje-dalje
 (f. 327) jug-juglindje, jug-jugperëndim
 (f. 353) këmba-këmbës
 (f. 432) liqenor-kënetor
 (f. 439) lule-lule
 (f. 597) peshk-akrep, peshk-flutur, peshk-laraskë, peshk-çekan, peshk-krehër, peshk-hënë.

Vlerësimi:

- Vlerësohen nxënësit, që përcaktojnë rastet kryesore kur fjalët shkruhen me vizë lidhëse në mes.
- Vlerësohen nxënësit, që përdorin saktë fjalët që shkruhen me vizë lidhëse në mes.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 4, f. 72. Rishikoni dhe rishkruani tekstin e dhënë, duke dalluar rastet ku nuk janë zbatuar rregullat e drejtshkrimit.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|---------------------|---|-----------|
| Tema mësimore: Shkruajmë rregullore | | Situata e të nxënit: Lexohet rregullorja e shkollës dhe vërehen teknikat e shkrimit të saj. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, organizon në mënyrë logjike mendimet dhe idetë, - redakton shkrimin duke përdorur edhe mendimet e të tjerëve; - shkruan qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike, tekste për qëllime dhe për audiencën e caktuar; - shkruan tekste të llojeve të ndryshme për qëllime personale dhe funksionale, duke zbatuar kriteret e domosdoshme për rregulloren; - zbaton rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimet e tij dhe në procesin e redaktimit; - përdor materiale të ndryshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit të shkrimit. | | Fjalët kyçe: Teksti udhëzues Rregullore Planifikim Hartim Rishikim | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: fletore të punëve me shkrim, modele rregulloresh, shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive) | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none">Diskutim paraprakUdhëzime shkrimiPunë me shkrim sipas grupeve | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

I. Veprimtari paraprake

Diskutim paraprak

Cilat janë teknikat e përdorura në planifikimin e një shkrimi? Po në hartimin e tij? Rishikim?

II. Zhvillimi i situatës

• Hapi i dytë – Udhëzime shkrimi

Veprimet për çdo hap të procesit të të shkruarit

Parashkrimi:

Rishikimi dhe reflektimi:

Skicimi/draftimi/shestimi:

Redaktimi:

Konsultimi/ndarja me të tjerët:

Hapi i tretë - Punë në grupe

Shkolla ofron shërbime që shërbejnë për zhvillimin e komunitetit, dhe komuniteti është pjesë përbërëse e aktiviteteve që organizon shkolla. Informacionet e mëposhtme janë fokusuar te prindërit, si një nga fuqitë thelbësore përbërëse të komunitetit.

- Prindërit janë pjesë e zhvillimit të jetës së nxënësve në shkollë.
- Prindërit marrin iniciativa për zhvillimin e orëve të hapura mësimore.
- Komuniteti jep ide për planet që ndikojnë në rritjen e performancës së nxënësve.
- Ata marrin pjesë nëpërmjet punëve vullnetare në shkollë, ose në raste të veçanta mundësojnë fonde për zhvillimin e shkollës.
- Prindërit mund të mbledhen në shkollë nëse kanë nevojë për të diskutuar për të përmirësuar kushtet e shkollës apo për të përmirësuar marrëdhëniet mësues-nxënës-prindër.
- Prindërit ofrojnë shërbime në fushat që ata njohin ose punojnë: mjekësi, sport, arte etj.

Informacionet e dhëna shndërrohen në një tekst: rregullorë.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit shkruajnë rregulloren sipas temës së kërkuar;
- zbatojnë strukturën e saj përkatëse;
- analizojnë strukturën e tekstit: rregullorë;
- synojnë stil dhe origjinalitet krijues;
- respektojnë rregullat gramatikore.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për shkrimin e rregullores;
- për materialet e sjella në mbështetje të temës;
- për fjalorin e përdorur gjatë shkrimit të rregullores;
- për respektimin e strukturës së rregullores së shkruar.
- për zbatimin e rregullave drejtshkrimore gjatë shkrimit të rregullores.


| | | | |
|--|--------------------------------------|--|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Ndajfolja | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">dallon ndajfoljet dhe përcakton llojin e tyre;përdor ndajfoljet në fjali në trajtën e duhur;përcakton shkallën e ndajfoljes;krahason shkallët e ndajfoljes me njëra-tjetrën. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">ndajfolja, ndajfolje përcaktore, ndajfolje rrethanore, shkallë të ndajfoljes, lokucione ndajfoljore. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve “Di, Dua të di, Mësova”, “Pemë Mendimi”, “Punë në grup” | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <i>Veprimtari paraprake</i> <ul style="list-style-type: none">Me anë të teknikës “Di, Dua të di, Mësova”, nxënësit kontrollojnë njohuritë e tyre mbi ndajfoljet.Si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës.Përdoren si gjymtyrë më vete, si rrethanorë a përcaktorë.Klasifikimi i ndajfoljeve. | | | |
| DI | Dua të di | Mësova | |
| Ndajfolja është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës. | Klasifikimi i ndajfoljeve. | Sipas funksionit që kryejnë në fjali ndajfoljet ndahen në: përcaktore dhe rrethanore. | |
| Ndajfoljet kanë kuptim të mëvetësishëm leksikor, përdoren si gjymtyrë më vete, si rrethanorë a përcaktorë. | | Sipas mënyrës së fjalëformimit, ndajfoljet i kemi: të parme, të prejardhura, të përngjitura, lokucione ndajfoljore. | |
| Ndajfoljet kanë tri shkallë: pohore, krahasore dhe sipërore. | | | |

Tabela e mësipërme plotësohet me pyetje të tjera të bëra nga nxënësit.

Tabela e mësipërme plotësohet me pyetje të tjera të bëra nga nxënësit.

Ndërtimi i njohurive të reja: “Pemë mendimi”

Me teknikën “Pemë mendimi”, mësuesi/ja paraqet në tabelë ose videoprojektor klasifikimin e ndajfoljeve sipas funksionit që kryejnë në fjali, mënyrës së fjalëformimit, si dhe shkallët e ndajfoljes.



Nxënësit shkruajnë diagramin në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të parë përvetësimin e njohurive gramatikore zhvillohen ushtrimet në f. 78, 79, ku nxënësit:

- gjejnë ndajfoljet dhe përcaktojnë llojin e tyre sipas funksionit që kryejnë në fjali;
- analizojnë ndajfoljet sipas mënyrës së fjalëformimit;
- dallojnë shkallët e ndajfoljes.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që:

- gjejnë ndajfoljet dhe përcaktojnë llojin e tyre sipas funksionit që kryejnë në fjali;
- analizojnë ndajfoljet sipas mënyrës së fjalëformimit.

Detyrë shtëpie:

Usht. 4, 6, f. 79

Formoni fjali me fjalët *shumë pak, mjaft, kaq*, duke i përdorur si *ndajfolje* dhe si *përemra të pacaktuar*.

Formoni fjali me fjalët: *matanë, përtej, sipër, nga*, duke i përdorur si *ndajfolje* dhe si *paraafjalë*.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|------------------------|-----------------------------|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Lokucionet ndajfoljore | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |

| | |
|---|---|
| <p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> tregon ç'janë lokucionet ndajfoljore dhe ndërton fjali me to; përcakton se si janë formuar lokucionet ndajfoljore. | <p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ndajfolja, pjesë ligjërata, lokucion ndajfoljor. |
| <p>Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë.</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup</i></p> | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Veprimtari paraprake</i></p> <p>Nxënësit lexojnë fjalitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> me fjalët <i>shumë pak, mjaft, kaq</i>, të përdorura si <i>ndajfolje</i> dhe si <i>përemra të pacaktuar</i>. me fjalët: <i>matanë, përtej, sipër, nga</i>, duke i përdorur si <i>ndajfolje</i> dhe si <i>parafjalë</i>. <p>Me teknikën “Stuhi mendimi” u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për ndajfoljen, klasifikimin e ndajfoljeve sipas <i>funksonit që kryejnë</i> dhe <i>mënyrës së fjalëformimit</i>, si dhe <i>shkallët e ndajfoljes</i>.</p> <div style="text-align: center; margin: 20px 0;"> <p>NDAJFOLJA</p> </div> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”.</i></p> <p>Drejtohen nxënësit drejt fjalive të dhëna në tekst, f.80., nga ku nënvizohen lokucionet ndajfoljore.</p> <p>Mësuesi jep përkufizimin e lokucioneve ndajfoljore, si grup fjalësh që kanë lidhje të qëndrueshme midis tyre dhe, kuptimisht e gramatikisht, janë të barasvlershme me një ndajfolje.</p> <p>Përmes teknikës “Stuhi mendimi”, mësuesi ndërton diagramin e formimit të lokucioneve ndajfoljore në gjuhën shqipe.</p> <div style="text-align: center; margin-top: 20px;"> </div> | |

Nxënësit shkruajnë diagramin në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Për secilin rast, jepen shembuj.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Diagrami e mësipërm zbërthehet përmes ushtrimeve:

- Ushtrimi 1, f. 81 - nxënësit duhet të japin shembuj për secilin rast.
 - Ushtrimi 3, f. 81 - nxënësit gjejnë lokucionet ndajfoljore dhe tregojnë si janë formuar ato.
 - Ushtrimi 4, f. 81 - Nxënësit krijojnë fjali me lokucionet ndajfoljore.
- Në grup zhvillohet ushtrimi 5, f. 82 - Nxënësit gjejnë shprehje me lokucione ndajfoljore.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit, që tregojnë ç’janë lokucionet ndajfoljore dhe si janë formuar ato.

Vlerësohen nxënësit, që krijojnë fjali me lokucionet ndajfoljore.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 6, f. 82 – Përshkruani një gjendje tuajën emocionale, duke përdorur lokucione ndajfoljore.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|--|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Leksikologji Tema mësimore: Antonimet | | Situata e të nxënësve: Poezi: “Shpella e Dragobisë”, “Syr gjyn vdekur”. | |
| Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> dallon kur antonimet janë të plota dhe kur ato janë të pjesshme. përcakton dhe përdor në komunikim antonimet. analizon dhe vlerëson funksionin e antonimeve. | | Fjalët kyçe: - antonim, antonime të plota, antonime të pjesshme, çift antonimik. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë, “Leksikologjia e gjuhës shqipe”. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Veprimtari paraprake

Nxënësve u kërkohet të kujtojnë vargjet e Nolit, të cilat paraqiten edhe në videoprojektor, ku duhet të dallojnë antonimet: nisi-mbaroi / krisi-pushoi/ qante-qeshnin/ veshte-çveshnin.

Shpella e Dragobisë


Atje **nisi**, atje **mbaroi**,
Atje **krisi**, atje **pushoi**,
Rrufe-shkab' e Malësisë,
Në një shkëmb të Dragobisë.

Syrgjyn vdekur

Se të deshte kur s'të deshnin,
Se të **qante** kur s'të **qeshnin**,
Se të **veshte** kur të çveshnin
Nëno moj, të ra dëshmor.

Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”.

Përmes teknikës “Stuhi mendimi”, mësuesi ndërton diagramin e grupimit të antonimeve.



Kujdes!

- Pjesëzat mohuese **nuk** dhe **s'** nuk përdoren për ndërtimin e antonimeve.
- Nuk janë antonime fjalë që nuk e kanë kundërshtinë kuptimore të plotë.

Nxënësit shkruajnë diagramin dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Nënvizimi i antonimeve dhe shpjegimi i vlerës së tyre stilistike.
- Përcaktimi i antonimeve të plota nga ato të pjesshme.
- Krijimi i çifteve antonimike.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.

Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 158-168.

Shembuj antonimesh shkëputur nga “Juga e bardhë” e Jakov Xoxes

“Kjo duket sikur ia dobësoi kontrastin e thellë në mes të *dritës* së fortë të traktorit dhe *errësisë* së natës... Ylli e kuptoi pse po e *shante natën* qilizmën ky kryetar, që *ditën* nuk e kishte *hequr nga goja*... Përgjegjësit i erdhi *mirë* për *gradimin*, ndërsa Kiut nuk i erdhi *aspak keq* për *degradimin*. Nga kjo lojë *ulje-ngritje* gradash qeshi vetëm brigada...

Gjersa nga *trazira* të dilte *rregulli*, duhej të kalonte kohë... Ylli me Shpresën rrinin e heshtnin. Kontrasti në mes të *zhdërvjelltësisë së jetës*, mu në lulen e saj dhe të *plogështisë së vdekjes* mu në strofkullën e vet, ua kishte vrarë gazin në buzë... Ai i *plogët*, jo sikur të *mernte*, po sikur të *jepte*. Ajo, e *shpejtë* jo sikur të *jepte* por sikur të *mernte*... Sikur qenkësh hapur dera jo *për t'ia lehtësuar* ikjen, por *për t'ia vështirësuar*, u futën me radhë çupat e lagjes. Do *ndreq* këtë, por do *prish* atë...”

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë antonimet e plota nga ato të pjesshme.

Vlerësohen nxënësit që krijojnë fjali me çifte antonimike.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 7, f. 85. – Përshkruani stinën tuaj të preferuar, duke përdorur çifte antonimike.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|--|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Kundrinori i drejtë | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">dallon kundrinorin dhe përcakton llojin e tij;tregon se me çfarë është shprehur;ndërton fjali me kundrinorë të llojeve të ndryshme;krahason kundrinorin me gjymtyrët e tjera të fjalisë. | | Fjalët kyçe: - kundrinor, kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë me parafjalë, kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT


Veprimtari paraprake

Me teknikën “Stuhi mendimi” u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për kundrinorin si gjymtyrë e dytë e fjalisë që lidhet drejtpërdrejt me foljen, qoftë kjo e shtjelluar apo e pashtjelluar, llojet e tij.




Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”.

Përmes “Stuhi mendimi”, mësuesi tregon se me se shprehet kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë.



- Kundrinori i drejtë mund të rimerret (ose jo) nga një trajtë e shkurtër e përemrit vetor.



- Kundrinori i zhdrejtë i shprehur me emër a përemër në rasën dhanore, duhet të rimerret gjithnjë nga një trajtë e shkurtër përemërore, në të kundërt fjalja nuk qëndron.

Kujdes!

- *Vetëm kundrinori i drejtë mund të rimerret nga trajtat e shkurtra përemërore.*
- *Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë nuk rimerret nga trajtat e shkurtra përemërore.*

Nxënësit shkruajnë diagramin dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Gjetja e kundrinorëve të drejtë dhe të zhdrejtë dhe fjalët e tyre drejtuese.
- Rishkrimi i fjalive duke shtuar trajta të shkurtra përemërore.
- Dallimi i kundrinorëve të zhdrejtë me parafjalë nga rrethanaorët.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë kundrinorin, përcaktojnë llojin e tij dhe tregojnë se me se shprehet.

Vlerësohen nxënësit që ndërtojnë fjali me kundrinorë të llojeve të ndryshme.

Vlerësohen nxënësit që krahasojnë kundrinorin me gjymtyrët e tjera të fjalisë.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 9, f. 89 – Në një pjesë gazete apo reviste, vëreni përdorimin e trajtave të shkurtra.

Ose

Ushtrimi 10, f. 89 – Shkruani një tekst me temë të lirë, ku të përdorni të gjithë llojet e kundrinorëve.

MODULI IV

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|---|---------------------|---|-----------|
| Tema mësimore: Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve argumentuese | | Situata e të nxënit: Lexohet një fragment nga një tekst argumentues dhe diskutohet rreth veçorive të tij. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - analizon tekstin, veçoritë dhe strukturën e tij; - krahason tekste të llojeve të ndryshme; - identifikon karakteristika të formës të teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti. -analizon veçoritë gjuhësore të një teksti. | | Fjalët kyçe: Teksti argumentuese Qëllimi Funksioni Lloje tekstesh argumentuese Strukturë (parashtrim, tezë, argumente, antitezë etj.) Veçori gjuhësore dhe stilistike | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK, Histori, Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <ul style="list-style-type: none">• Stuhi mendimi• Hartë semantike• Lexim i drejtuar i tekstit• Punë në çift• Përmbledhje e strukturuar• Punë me shkrim | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT I. Veprimtari paraprake Hapi i parë - Stuhi mendimesh + Harta semantike Teksti argumentues: qëllimi, funksionet, llojet, veçoritë strukturore dhe gjuhësore-stilistike (Rikujtohen njohuri rreth këtij teksti, të marra një vit më parë). - Ç’do të thotë të argumentosh? - Cili është qëllimi i teksteve argumentuese? - Ku gjenden tekstet argumentuese? Cilat janë llojet e tyre? - Cilat janë veçoritë strukturore të këtij lloji teksti? Si ndërtohet ai? | | | |

- Çfarë paraqitet në hyrje (parashtrimi)?

- Ç'është teza?

- Ç'është antiteza?

- Zbërthehet struktura e tekstit argumentues:

Hyrya (tema, problem) + teza + argumente në mbështetje të tezës + antiteza + argumente në mbështetje të antitezës + mbyllja.

- Llojet e argumenteve: argumente që sjellin fakte konkrete, argumente të autoriteteve të fushës përkatëse, argumente logjike, argumente pragmatike etj.

II. Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Lexim i drejtuar i tekstit *Prejardhja e gjuhës shqipe*

Hapi i tretë - Punë në çift

Ushtrimi 1-5:

Përforcim njohurish

Hapi i katërt – Përmbledhje e strukturuar

• Karakteristikat strukturore të teksteve argumentuese

Parashtrimi: pjesa në të cilën paraqitet çështja/tema.

Teza: pikëpamje a ide, që shtrohet si e vërtetë dhe mbrohet me anë të argumenteve.

Argumentet: arsyetimet për të vërtetuar ose për të kundërshtuar një tezë; provat që sillen për të mbrojtur ose për të hedhur poshtë një qëndrim.

Antiteza: gjykimi që i kundërvihet tezës.

Përfundimet: pjesa në të cilën ripohohet teza. Përdoren përgjithësisht folje të së shkuarës, por edhe në të tashmen. Në këtë rast, e tashmja përdoret brenda kohëve të shkuara.

• Karakteristikat gjuhësore e stilistike

- Ndërtohen mbi leksikun e duhur, në varësi të fushës së argumentimit.

- Gjuha mund të ngjallë emocion, në funksion të bindjes së lexuesit.

- Foljet janë të tipit argumentues, si: *gjykoj, vlerësoj, kundërshtoj, bind, mendoj, mbështes, pranoj, argumentoj, vërtetoj* etj.

- Përdoren dendur foljet gjysmëndihmëse *mund dhe duhet*, ose togje fjalësh e ndajfolje që shprehin:

○ mundësinë e ndodhjes së një veprimi: *është e mundshme, është e nevojshme, është e domosdoshme, është e udhës* etj.;

○ shkallën e vërtetësisë së argumentit: *sigurisht, me siguri, domosdo, patjetër, pa fjlë, pa frikë, me çdo kusht, vërtet, në të vërtetë, ndoshta, kushedi, vetëkuptohet, siç duket, sipas të gjitha gjasave, pa dyshim, në fakt, me të drejtë, natyrisht* etj.;

○ lidhje logjike mes argumenteve: *përveç kësaj, krahas kësaj, ndër të tjera, përkundrazi, sidoqoftë, ndërkaq, në këto rrethana, së pari, së dyti, nga njëra anë, nga ana tjetër, rrjedhimisht, për pasojë, bie fjala, për shembull, ta zëmë* etj.

- Mund të përdoren përemra në vetën e parë njëjës ose shumës, për të parashtruar argumentet dhe qëndrimet në mbështetje të tezës.

- Teksti mund të ketë të ndërkallura tekste të tjera me natyrë përshkruese, shpjeguese ose rrëfyese.

- Citohen burime të besueshme ose shkencore. Citimet mund të jenë të drejtpërdrejta mes thonjzash ose në formë të tërthortë, kur autori i referohet një burimi duke e perifrastuar atë.

| |
|--|
| <p>Veprimet në situatë</p> <p>Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nxënësit përgjigjen saktë; • dallojnë veçoritë e tekstit argumentues; • analizojnë strukturën e tekstit argumentues. |
| <p>Vlerësimi:</p> <p>Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për pjesëmarrjen në diskutime; • për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna; • për analizën e strukturës së tekstit argumentues; • për analizën gjuhësore të tekstit argumentues. |
| <p>Detyra dhe puna e pavarur:</p> <p>- Hartoni një tekst argumentues. Mund të përdorni edhe situatën nga ushtrimi 6. Analizoni veçoritë strukturore dhe gjuhësore-stilistike të tekstit tuaj.</p> <p>- Hulumtoni mbi prejardhjen dhe lashtësinë e shqipes.</p> |

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Lashtësia e shqipes (Karakteristikat strukturore, gjuhësore dhe stilistike të teksteve argumentuese) | | Situata e të nxënit: Ç’ dini për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe për lashtësinë e saj? | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - analizon tekstin, veçoritë dhe strukturën e tij; - krahason tekste të llojeve të ndryshme; - identifikon karakteristika të formës së teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti; - analizon veçoritë gjuhësore të një teksti. | | Fjalët kyçe: Teksti argumentues Qëllimi Funksioni Lloje tekstesh argumentuese Strukturë (parashtrim, tezë, argumente, antitezë etj.) Veçori gjuhësore dhe stilistike | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i> , shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK, Histori, Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |

| |
|---|
| <p style="text-align: center;">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stuhi mendimi • Lexim i drejtuar i tekstit • Punë në çift • Punë në grupe • Përmbledhje e strukturuar • Punë me shkrim |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>I. Veprimtari paraprake Hapi i parë - Kontrolli i detyrës së shtëpisë Hapi i dytë - Stuhi mendimesh: - Ç’дини për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe për lashtësinë e saj?</p> <p>II. Zhvillimi i situatës Hapi i tretë – Lexim i drejtuar i tekstit “Lashtësia e shqipes” Hapi i tretë - Punë në çift Ushtrimi 1-3 Hapi i katërt - Punë në grupe Grupi i parë: Ushtrimi 4 Grupi i dytë: Ushtrimi 5 Grupi i tretë: Ushtrimi 6 Hapi i pestë - Kontrolli i punës me grupe</p> <p>III. Përforcim njohurish Hapi i pestë – Përmbledhje e strukturuar Listoni veçoritë strukturore dhe gjuhësore të tekstit “Lashtësia e shqipes”.</p> |
| <p>Veprimet në situatë Situata konsiderohet e realizuar kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nxënësit përgjigjen saktë; • dallojnë veçoritë e tekstit argumentues; • analizojnë strukturën e tekstit argumentues. |
| <p>Vlerësimi: Nxënësit do të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për pjesëmarrjen në diskutime; • për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna; • për analizën e strukturës së tekstit argumentues; • për analizën gjuhësore të tekstit argumentues. |
| <p>Detyra dhe puna e pavarur: Hartoni një tekst argumentues. Mund të përdorni edhe situata nga ushtrimi 7. Analizoni veçoritë strukturore dhe gjuhësore-stilistike të tij.</p> |

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|---|---------------------|---|-----------|
| Tema mësimore: Të folurit në publik | | Situata e të nxënit: Dëgjohen sekuenca të ligjëratave të ndryshme të të folurit në publik. Mbahen shënime gjatë dëgjimit. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - organizon në mënyrë të strukturuar mendimet dhe idetë e tij gjatë të folurit; - përzgjedh fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutime e në prezantime me gojë; - analizon tiparet e të folurit në publik dhe vlerëson rëndësinë e tij; - luan role të ndryshme në një diskutim: rolin e drejtuesit, rolin e dëgjuesit etj.; - respekton dhe vlerëson mendimet e të tjerëve gjatë diskutimeve në grup. | | Fjalët kyçe: Audiençë Mesazh Publik Humor Gjeste Komunikim verbal Mjete audio-vizuale | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive) | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK, Histori, Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup Diagram Veni Diskutim në grup | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT I. Veprimtari paraprake Hapi i parë - Stuhi mendimesh - Cilat janë strategjitë dhe teknikat që i duhen individit për të realizuar një të folur të suksesshëm në publik? Dëgjohen diskutimet e nxënësve. II. Zhvillimi i situatës Hapi i dytë – Praktikë e drejtuar Zgjidhet njëra nga temat alternativë për të folur në publik: | | | |

- **Studimet e larta në Shqipëri apo jashtë saj.**
- **Unë kam një ëndërr.**
- **Për një botë të drejtë.**
- Përpikuni të shmangni emocionet dhe nervozizmin.
- Merrni informacion për të njohur audiencën.
- Organizojini materialet në mënyrë që të arrini qëllimin tuaj.
- Kërkoni vlerësim nga audienca dhe përshtatuni me nevojat e saj.
- Përdorni zërin dhe duart në mënyrë të efektshme.
- Bëni kujdes që si hyrja, edhe mbyllja e fjalës suaj të jenë dinamike.
- Përdorni mjete audio-vizuale.

Hapi i tretë - Diagram Veni

| <i>Të folurit në publik</i> | <i>Bashkëbisedimi</i> |
|--|---|
| Kërkon parapërgatitje. | Është spontan. |
| Shfaqen emocione të forta. | Ruhet qetësia. |
| Kërkon përdorimin e një regjistri formal të gjuhës, në përshtatje me temën. | Realizohet në regjistrin e zakonshëm të të folurit. |
| Përdoret në mënyrë më të kontrolluar gjuha verbale dhe ajo joverbale. | Përdoret dëndur gjuha joverbale. |
| Kërkon përdorimin e shënimeve paraprake. | Artikullohet në kohen kur flitet. |
| Përdoren teknologji për ilustrim. | Nuk përdoren teknologji gjatë kohës që bashkëbisedohet. |
| Kërkon marrjen e roleve të ndryshme, si lider, dëgjues, monitorues etj. | Personat që bashkëbisedojnë janë në pozita të barabarta me njëri-tjetrin. |
| Duhet që personi i cili flet në publik, të kujdeset për paraqitjen e tij të jashtme. | Personat që bashkëbisedojnë kanë paraqitjen e zakonshme. |
| Kërkon përdorimin e gjuhës standarde. | Flitet thjesht dhe përdoren të folmet dialektore. |

Përforcim njohurish

Hapi i katërt – Diskutim në grup

Përkthyeri emocionet që keni përjetuar gjatë një seance të foluri në publik. Tregoni se si arrini t'i kontrolloni emocionet gjatë një seance të foluri në publik. Diskutoni rreth mënyrave të ndryshme që ju ndihmojnë t'i kontrolloni ato.

Nxënësi ndalet në elementet:

- Rregullat e etikës gjatë të folurit
- Respektimi i mendimit të të tjerëve
- Nervozizmi dhe demonstrimi i seriozitetit gjatë të folurit
- Forca e fjalës dhe pasuria leksikore e gjuhës shqipe
- Iniciativa dhe shprehja e interesit për çështje të ndryshme
- Imagjinata dhe kreativiteti për zgjidhjen e problemeve

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përfshihen në diskutime duke dhënë kontributin e tyre, si dhe respektojnë mendimin e të tjerëve;
- analizojnë tiparet e të folurit në publik dhe vlerësojnë rëndësinë e tij;
- luajnë role të ndryshme në një diskutim: rolin e drejtuesit, rolin e dëgjuesit etj.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për vetëbesimin, imagjinatën dhe shpirtin krijues gjatë të folurit;
- për respektimin e parimeve, vlerave, bindjeve dhe kulturës së të tjerëve;
- respektimin e forcës së fjalës dhe pasurisë leksikore të gjuhës shqipe.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Lidhëzat | | Situata e të nxënës: Teksti “Muzgu i perëndive të stepës” | |
| Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• përcakton llojin e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse;• përdor drejt në fjali lidhëzat;• dallon lokucionet lidhëzore dhe përcakton se si janë formuar ato;• krahason lidhëzat me klasat e tjera të fjalëve. | | Fjalët kyçe: - lidhëza, lidhëza bashkërenditëse, lidhëza nënrenditëse, lokucione lidhëzore. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi Mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur dhe në grup</i> | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Veprimtari paraprake

Me teknikën “Stuhi mendimi” u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për lidhëzat si fjalë të pandryshueshme, që lidhin dy gjymtyrë fjalie ose dy pjesë të një fjalie të përbërë.



Paraqitet teksti i shkëputur nga vepra e I. Kadaresë “*Muzgu i perëndive të stepës*” në videoprojektor. Nxënësit në tekstin e tyre nënvizojnë lidhëzat dhe tregojnë llojin e tyre.

Ne luanim pingpong përjashta, fare pranë bregut të detit afër mesnatës, **sepse** kishte dritë të mjaftueshme, **megjithëse** netët e bardha kishin kaluar. Lojërat e fundit, domethënë pas orës njëmbëdhjetë e gjysmë, i bënë ata që i kishin sytë më të fortë, **kurse** ne të tjerët rrinim mbështetur në parmakët e drunj të, vështronim lojën **dhe** korrigjonim ata që ngatërronin pikët. Pas orës dymbëdhjetë, **kur** të gjithë iknin dhe mbi tryezën e pingpongut ngeleshin vetëm raketat, **që** i gjenim shpesh në mëngjes të lagura nga shiu i natës, unë nuk dija **ku** të shkoja, **sepse** nuk më flihej. Vija një copë herë rrotull rreth kopshteve të shtëpisë së pushimit, **që** kishte qenë më parë çiflig i një baroni letonez, shkoja gjer te shatërvani me delfinë, pastaj kthehesha te shtëpia suedeze dhe, më në fund, dilja në breg të Baltikut, **por** natën bënte shumë ftohtë **dhe** ishte e pamundur të rrije atje për një kohë të gjatë.....

Ndërkohë që nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, një nxënës i shkruan në tabelë lidhëzat duke i vendosur sipas llojit: *bashkërenditëse dhe nënrenditëse*.

| Bashkërenditëse | Nënrenditëse |
|-----------------|----------------------------|
| dhe, kurse, por | që, megjithëse, sepse, kur |

Ndërtimi i njohurive të reja: Diagram Veni


Mësuesi/ja paraqet në dy tabela klasifikimin dhe llojin e lidhëzave: *bashkërenditëse dhe nënrenditëse*.

• **Klasifikimi i lidhëzave bashkërenditëse**

| Lloji | Lidhëzat |
|---------------------------|--|
| Shtuese (këpujore) | e, edhe, as, si edhe, edhe... edhe, as... as, jo...vetëm...por, si...ashtu edhe, jo vetëm që...por as, le që...por edhe etj. |
| Veçuese | ose, apo, a, ose...ose, o...o, ja...ja, qoftë...qoftë, herë...herë |
| Kundërshtore | po, por, kurse, mirëpo, veç, veçse, vetëm se, megjithatë, megjithëkëtë, ndërsa, teksa, porsa |
| Përmbyllëse | andaj, ndaj, prandaj, pa |

• **Klasifikimi i lidhëzave nënrenditëse**

| Lloji | Lidhëzat |
|---------------------------|---|
| Ftilluese | se, që, në, nëse |
| Vendore | ku, nga, tek, kudo, ngado, gjer ku etj. |
| Kohore | kur, që kur, derisa, ndërsa, se, pasi, sapo etj. |
| Shkakore | se, sepse, meqenëse, meqë, ngaqë etj. |
| Qëllimore | që, me qëllim që, në mënyrë që etj. |
| Krahasore-mënyrore | si, siç, sa, sikur, ashtu si |
| Rrjedhimore | kështu që, që, sa, saqë, aq sa etj. |
| Kushtore | në, nëse, në qoftë se, në rast se, po, po qe se, me kusht që etj. |
| Lejore | megjithëse, ndonëse, sido që, sado që, edhe pse, edhe në, edhe sikur etj. |
| Kundërvënëse | nëse, në qoftë se, ndërsa, në vend që |



Lokucionet lidhëzore

- Në çdo lokucion lidhëzor zakonisht gjendet një lidhëz ose një fjalë lidhëse.
- Përbëhen prej dy a më shumë fjalësh, të cilat kanë një kuptim të vetëm dhe kryejnë funksionin e një lidhëze.

Me teknikën “Diagram Veni”, mësuesi paraqet dallimin mes lidhëzave dhe parafrjalëve.

Lidhin fjalë që i takojnë së njëjtës pjesë ligjërate.


Janë fjalë homogjene nga pikëpamja sintaksore.

Nuk ndikohen nga rasa e njëjësive që lidhin.

Lidhin dy pjesë të ndryshme të ligjëratës.

Shprehin marrëdhënie sintaksore varësie.

Kërkojnë pranë një emër, përemër a numëror.



Nxënësit shkruajnë tabelat, rregullat dhe diagramin në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup nxënësit u drejtohen ushtrimeve të tekstit, f. 107-108.

- Gjeni lidhëzat dhe përcaktoni llojin e tyre.
- Tregoni ç'pjesë ligjërate janë fjalët e nënvizuara.
- Formoni fjali, në të cilat fjala:
 - **në, tek** të përdoret si parafjalë dhe si lidhëz;
 - **ku** si lidhëz dhe si ndajfolje;
 - **veç** si ndajfolje, parafjalë dhe lidhëz;
 - **që** si përemër lidhor, pjesëz dhe lidhëz.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që përcaktojnë llojin e lidhëzave bashkërenditëse dhe nënrenditëse dhe i përdorin drejt në fjali lidhëzat.

Vlerësohen nxënësit që dallojnë lokucionet lidhëzore dhe përcaktojnë se si janë formuar ato.

Vlerësohen nxënësit që krahasojnë lidhëzat me klasat e tjera të fjalëve.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 1: Në tekstin “Lashtësia e shqipes”, f. 98, nënvizoni lidhëzat dhe përcaktoni llojin e tyre.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|---|---------------------|---|-----------|
| Tema mësimore: Dëgjojmë dhe analizojmë një fjalim | | Situata e të nxënit: Prezantohet një material me përmbajtje historike | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - është i vëmendshëm ndaj folësit ose ndaj mesazhit që dëgjon; - demonstroi të dëgjuarit e qëllimshëm, duke mbajtur shënime, duke bërë pyetje dhe duke kërkuar sqarime; - përmbledhi idetë e dëgjuara, si dhe diskuton rreth tyre; - bën pyetje dhe diskuton rreth tekstit që dëgjon; - zbulon kuptimin e fjalëve të reja nëpërmjet kontekstit në komunikimet gojore; | | Fjalët kyçe: Fjalim Akademi Dëgjim Argument Ballkan Evropë Shqiptar | |

| | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - analizon qëllimin e folësit ose të mesazhit që dëgjon; - krahason dhe analizon informacionet e prezantuara me gojë nga të tjerët; - analizon rastet kur përdoret argumenti në komunikimin gojor. | |
| <p>Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, fjalime, libri i nxënësit, tabela, <i>fleep-charter</i>, shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive)</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK, Histori, Qytetari</p> |
| <p>Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale</p> | |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim paraprak Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar Të dëgjuarit për të vlerësuar Punë në grupe</p> | |
| <p>ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>I. Veprimtari paraprak</p> <p>II. Lexohen sekuenca të ndryshme nga historia e Ballkanit: luftërat, problemet, ndodhitë.</p> <p>Nxënësit dëgjojnë për të kuptuar dhe reflektuar rreth materialit.</p> <p>Hapi i parë - Diskutim paraprak</p> <p>II. Zhvillimi i situatës</p> <p>Hapi i dytë – Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të reflektuar Të dëgjuarit për të vlerësuar</p> <p>Dëgjohet <i>Fjalimi i pranimi të Ismail Kadaresë në Akademinë Franceze.</i></p> <p>Kërkohet nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përmbledhin idetë e dëguara, me qëllim diskutimin e tyre; - të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë rreth tekstit që dëgjojnë; - të zbulojnë kuptimin e fjalëve të reja nëpërmjet kontekstit dhe të analizojë qëllimin e folësit, si dhe të mesazhit që dëgjon. | |

Hapi i tretë: Punë në grupe

Pas dëgjimit të fjalimit të mësipërm, shpjegoni kuptimin e shprehjeve:

“...kur pikërisht midis shtjellës së keqe shfaqet drita”

Përgjigje: Autori i referohet shpresës, asaj që pritët të vijë në të ardhmen. Drita është simbol i së mirës, pozitives, e cila do të dominojë dhe triumfojë përmbi errësirën dhe të shkuarën e errët.

“...diçka e mirë e pret ditën e vet për t’u shfaqur”

Përgjigje: Sipas autorit, ka një kohë optimale për çdo gjë. Ai shpreson se kjo kohë do të vijë, dita e shumëpritur do të bekojë popullin shqiptar.

“...Evropa mbetet përherë një referencë e paluajtshme në mendimet e tyre”

Përgjigje: Evropa mbetet destinacioni i synuar, mbetet ëndrra dhe modeli për ballkanasit.

“...shqiptarët, populli të cilit unë i përkas, e kanë humbur dy herë Evropën: herën e parë në shekullin XV, si gjithë popujt e tjerë ballkanas, herën e dytë pas luftës së Dytë Botërore, kur ranë nën sundimin komunist”

Përgjigje: Autori ndalet në dy momente historike:

- I. Sundimi osman në Shqipëri filloi pas Betejës së Savrës në vitin 1384, kur shumica e prijësve vendas ranë në vasalitetin osman. Osmanët ngritën garnizonet e tyre nëpër Shqipërinë Jugore deri në vitin 1415 dhe themeluan një juridiksion zyrtar mbi shumicën e Shqipërisë deri në vitin 1431. Disa rajone shqiptare u pavarësuan mes viteve 1443 dhe 1479, si pasojë e kryengritjeve të drejtuara nga Skënderbeu. Qytetet e fundit që ranë nën sundimin osman ishin Shkodra (viti 1479) dhe Durrësi (viti 1501). Territori i sotëm i Republikës së Shqipërisë mbeti pjesë e Perandorisë Osmane deri në vitin 1912, kur Shqipëria shpalli pavarësinë.
- II. Rënia e komunizmit në Shqipëri filloi në dhjetor të vitit 1990 me demonstratat antikomuniste studentore. Zgjedhjet e marsit të vitit 1991 i lanë sërish komunistët në pushtet, por një grevë e përgjithshme dhe opozita qytetare, çuan në formimin e një koalicioni i cili përfshiu edhe jokomunistë. Komunistët shqiptarë u mundën nga opozita në zgjedhjet e marsit të vitit 1992, mes kolapsit ekonomik dhe protestave shoqërore.

Regjimi diktatorial i Enver Hoxhës përfundoi në vitin 1985, me vdekjen e tij. Pasardhësi Ramiz Alia përpos disa modernizimeve të lehta ndoqi të njëjtin plan qeverisës autokratik.

Në vitin 1989 filluan revoltat e para qytetare në Shkodër, ku njerëzit filluan të shkatërronin statujën e Josif Stalinit. Protesta ndoqën në qytete të tjera. Regjimi duke parë që fryma e përgjithshme po ndryshonte vullshëm, kreu disa reforma liberalizuese. Gjatë diktaturës komuniste u ekzekutuan, me dhe pa arsye, rreth 5,000 burra e 450 gra. 35,135 njerëz u burgosën dhe 1,000 vdiqën nëpër burgje. Shumë familje ende sot e kësaj dite nuk i kanë akoma eshtrat e të afërmeve të vet dhe janë në kërkim të tyre

“...nuk mund ta dini se ç'është ankthi i popujve që jetojnë në periferi të kontinentit evropian”

Përgjigje: Autori i referohet gjendjes së vështirë të popujve fatkeq të Ballkanit.

Ushtrimi 2, 3 dhe 4

Përforcim njohurish

Hapi i katërt – Përmbledhje e strukturuar

Nxënësit realizojnë një përmbledhje të strukturuar të argumenteve kyçe të fjalimit të dëgjuar.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- reflektojnë rreth fjalimit të dëgjuar;
- vlerësojnë materialin e dëgjuar.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:


- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për analizën e argumenteve të dëgjuara;
- për krahasimin e informacioneve të dëgjuara.

| | | | |
|---|--------------------------------------|---|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshtkrim Tema mësimore: Përdorimi i shenjave të pikësimit: tri pikat, kllapat, thonjëzat | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> përdor drejt shenjat e pikësimit (tri pikat, kllapat, thonjëzat). | | Fjalët kyçe: - tri Pikat, kllapat, thonjëzat. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë, “ <i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe</i> ”. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Punë e pavarur dhe në grup</i> | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Veprimtari paraprake

Me teknikën “Stuhi mendimi”, u kërkohet nxënësve të shprehin raste të përdorimit të shenjave të pikësimit.



Ndërtimi i njohurive të reja:

Mësuesi liston në tabelë rastet e përdorimit të tri pikave, kllapave, thonjëzave.

| <i>Shenjat e pikësimit</i> | Raste të përdorimit |
|-----------------------------------|---|
| <i>Tri pikat</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Në vend të një fjale a të një thënieje që s' duam ta përmendim. - Në shkurtimet e fjalëve a të datave që nuk duam t'i japim të plota ose që s'na kujtohen. - Për të shprehur mungesën ose vonesën e përgjigjes në dialog. - Në një ligjërim pa vijimësi logjike. - Për të shprehur pushime të gjata në të folur me ritëm të ngadaltë. - Pas një numërimi që unk jepet deri në fund. - Në citime ku fjalia nuk jepet e plotë në fillim, në mes a në fund të saj. - Para një fjale me ngarkesë emocionale për të shprehur ndërprerjen e ligjëritimit para saj, me qëllim që të vihet më shumë në dukje. |
| <i>Thonjëzat</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Për të veçuar fjalët e një tjetri në ligjëratën e drejtë. - Për të veçuar citatin. - Për të veçuar emrat e përveçëm a grupet e fjalëve që emërtojnë. - Për të veçuar fjalë që janë përdorur me kuptim jo të zakonshëm, me ngarkesë emocionale, apo me kuptim të veçantë. - Për të veçuar thirrje, porosi, lëvizje, nisma etj. |
| <i>Kllapat</i> | <p>Kllapat e rrumbullakëta ()</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për të mbyllur fjalë e fjali të ndërkallura, që dalin më pak të lidhura me pjesën tjetër të fjalisë. - Për të veçuar treguesit skenikë në veprat teatrale. - Për të mbyllur fjalët që zbërthejnë një emërtim të shkurtuar, për pseudonimet dhe për nëntitujt. - Për të mbyllur referimin e një citati dhe datën e lindjes dhe të vdekjes së një autori. - Për të mbyllur edhe një pikëpyetje ose pikëçuditje, ose dhe të dyja së bashku, kur përdoren për të shprehur mosbesimin, falsitetin, rezervën për vërtetësinë e asaj që është thënë më përpara. <p>Kllapat katrore[]</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për të mbyllur fjalë të shtuara nga botuesi, për ta bërë më të qartë përmbajtjen. - Për të mbyllur emrin e një vendi që njihet e përdoret sot, i shtuar nga botuesi krahas emrit të vjetër që përdoret në dokument. - Për të mbyllur tri pikat, për të treguar që botuesi ka hequr fjalë nga dokumenti. |

Kujdes!

- *Nuk vihen thonjëza dhe shkruhen gjithashtu me shkronjë të madhe emrat: shesh, rrugë, lagje etj., kur ata janë pjesë e emërimit të përveçëm përkatës: Rruga e Dibrës, Hoteli i Gjuetarëve etj.*

Nxënësit shkruajnë diagramin dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet f. 115:

- Përdorni tri pikat.
- Vendosni thonjëzat.
- Shpjegoni përdorimin e kllapave.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Shenjat e pikësimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2002.

Shembuj ilustrues për përdorimin e tri pikave, thonjzave, kllapave.

Tri pikat

(f. 84-87)

- Dola nga takimi me premtimin se do të shkruaja patjetër për këtë përvojë me vlerë të ...*madhe*.
- ...*E sheh këtë libërth?* Është fare i vogël, rëndon sa një pupël zogu, po pati një forcë të shumë të madhe.
- Sadoqë dëshpërohej për fatin e saj të keq, Rina kishte një shpresë të fshehtë: ***“Ja, sa të më rritet djali, pa...”***

Thonjëzat

(f. 88-94)

- ***“Dhe thonë pastaj që fëmijët grinden gjithmonë”***, mendoi Eva e hidhëruar.
- Por përgjigjja kishte qenë: ***“Guxon të të shkojë në mendje të më kritikosh?”***
- ***“Po atëherë, - thashë me vete, - ç’vlerë ka t’i rrisësh ato bimë pa kokrra?”***
- Deshi ta pyeste: “Çfarë je?”, por duke menduar se nuk do të tingëllonte si pyetje e një njeriu të sjellshëm tha thjesht: - Kush je?
- ***“Domethënë rreh gjetskë çekani”***, mendoi me vete djaloshi.

Kllapat

(f.95-101)

- Më priti me përzemërsi (*sidoqoftë pa buzëqeshje të tepruara*) dhe më ftoi të hyja.
- Dhe ja se ç’mora vesh (*nga burime shumë të besueshme*) gjatë muajit të fundit janë bërë edhe disa pranime të reja...
- Kripa e gjellës (*NaCl*)
- Asdreni (*Aleks Stavre Drenova*)
- Ai e paraqiti si “një burrë të dëgjuar për [...] veprat” e tij.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që përdorin drejt shenjat e pikësimit (tri pikat, kllapat, thonjëzat).

Detyrë shtëpie:**Hulumtim**

Kërkoni në gazeta e revista, në libra të ndryshëm dhe në Internet raste të përdorimit të shenjave të pikësimit.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: GJUHA SHQIPE | Shkalla: E PESTË | Klasa: XI |
|--|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Mënyra për organizimin e një fjalimi | | Situata e të nxënit: Rilexohet fjalimi i Kadaresë dhe përqendrohet vëmendja te koha e rrëfimit. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - shprehet qartë, saktë dhe në përputhje me tematikën, qëllimin dhe audiencën; - organizon në mënyrë të strukturuar mendimet dhe idetë e tij gjatë të folurit; - përzgjedh fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutime e në prezantime me gojë; - përfshihet dhe mban një qëndrim të caktuar ndaj një diskutimi në grup. | | Fjalët kyçe: Rend kronologjik Shkak-pasojë Qasje dhe krahasim E veçantë - E përgjithshme - E veçantë | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: fjalime, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter; shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK, Histori, Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh Diskutim dhe bashkëveprim në grup Prezantim me gojë Organizues grafik Punë në grupe | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Hapi i parë - Stuhi mendimesh

Cilat janë karakteristikat e një fjalimi?

- Qëllimi i fjalimit

- Informacionet dhe faktet
- Argumentet logjike
- Subjektiviteti
- Gjuha e formale e integruar me atë joformale

Hapi i dytë - Diskutim dhe bashkëveprim në grup

E shkuar - Kur pak më parë zoti kryetar i Akademisë, duke folur për Gadishullin Ballkanik, shfaqti mendimin e tij se nga ky rajon i botës nuk presim vetëm tmerre dhe prapësira, por edhe shenja të tjera, unë, si i ardhur këtu, pikërisht nga kjo lagje e vështirë e botës, i mora ato fjalë si një mesazh fisnik, drejtuar popujve të kësaj zone.

E tashme - Sot ka shumë egërsi në Gadishullin Ballkanik, ka shumë ankth e sidomos ka shumë marrëzi.

E tashme por që i paraprin një të ardhmeje - Por siç ndodh shpesh, kur pikërisht midis shtjellës se keqe shfaqet drita, të jeni të sigurt se atje diçka e mirë e pret ditën e vet për t'u shfaqur. E ndër shenjat e mira që më sigurojnë për këtë vizion shprese, është dashuria për Evropën.

E përgjithshme -e veçantë

Në antikitet, grekët e vjetër, që janë një ndër popujt më të vjetër të gadishullit, e përfytyronin Evropën si një qenie mitike. Edhe sot, po të lexoni këngët që vazhdojnë të krijohen atje, jo vetëm të grekëve, por edhe të popujve të tjerë ballkanas, dhe ndër këta hyn edhe populli të cilit unë i përkas, vazhdon kjo traditë.

Detaj i veçantë: Evropa vazhdon të përfytyrohet si grua. Një grua e bukur, inteligjente, disi e paarritshme. Dhe, siç ndodh shpesh me gra të tilla, ato nxitin tek adhuruesit ndjenja kundërthënëse: dëshirën për ta dashuruar natyrisht, por në pamundësi të saj, dëshirën për ta përdhunuar. Ballkanasit kanë më shumë se një shekull që e shprehin dashurinë për Evropën në mënyrë pasionale, nervoze. Ajo që duhet të ishte dashuri përfundon në keqkuptim tragjik.

Hapi i tretë - Prezantimi me gojë

- Zgjidhni një nga mënyrat e mësipërme dhe përgatitni një fjalim për një nga çështjet që ngre Kadareja në fjalimin e tij. Mbajeni fjalimin para klasës.

Çështjet:

Probleme të popujve të Gadishullit Ballkanik

Lidhja e fortë e Ballkanit me Evropën

Fati i trishtë i popullit shqiptar

Figura frymëzuese e Nënë Terezës.

Hapi i katërt - Organizues grafik**Punë në grupe**

Analizohen kohët foljore të përdorura në fjalim. Vendosen në një tabelë duke specifikuar edhe kohën të cilës i referohen.

| | | |
|--|---------------------------------|--|
| E shkuar | E tashme | E ardhme |
| Rrëfimi u referohet kohëve të shkuara. | Ngjarjet ndodhin në të tashmen. | Autori aspiro apo parashikon çfarë do të ndodhë në të ardhmen. |

Në varësi të dendurisë së përdorimit, mund të ndërtohet edhe kurba e një grafiku që paraqet përdorimin e foljeve dhe integrimin e dimensioneve që ato shenjojnë.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur nxënësi:






- organizon në mënyrë të strukturuar mendimet dhe idetë e tij gjatë të folurit;
- përzgjedh fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutime e në prezantime me gojë;
- përfshihet dhe mban një qëndrim të caktuar ndaj një diskutimi në grup.

Vlerësimi:


Nxënësit do të vlerësohen:

- për demonstrimin e strategjive efektive të përcjelljes së mesazhit gojor (organizimi, gjuha e gjesteve, fjalori i përshtatshëm);
- për përdorimin e një shumëllojshmërie strategjish organizative (tabela, diagrame, grafikë etj.);
- për shprehjen e alternativës personale mbi çështjen ose temën që diskutohet.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Rrethanori, llojet e tij | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">dallon rrethanorin dhe përcakton llojin e tij; | | Fjalët kyçe: - rrethanor, gjymtyrë e dytë, fjalë drejtuese, formë e pashtjelluar foljore, mbiemër prejfoljor, grup emëror, lokucion ndajfoljor. | |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • përcakton se me çfarë është shprehur rrethanori; • ndërton fjali me rrethanorë të llojeve të ndryshme; • krahason rrethanorin me gjymtyrët e tjera të fjalisë. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur dhe në grup</i> | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Veprimtari paraprake</i></p> <p>Me teknikën “Stuhi mendimi”, u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për rrethanorin si gjymtyrë e dytë e fjalisë që tregon rrethanën e kryerjes së veprimit, si: vend, kohë, mënyrë, shkak, qëllim, sasi.</p> <div style="text-align: center; margin: 20px 0;">  </div> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”.</i></p> <p>Përmes “Stuhi mendimi”, mësuesi tregon se me se shprehet rrethanori i vendit dhe i kohës si dhe fjalët e tyre drejtuese.</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: flex-start; margin-top: 20px;"> <div style="text-align: center;">  </div> <div style="text-align: center;">  </div> </div> <hr style="width: 60%; margin: 20px auto;"/> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: flex-start; margin-top: 20px;"> <div style="text-align: center;">  </div> <div style="text-align: center;">  </div> </div> | |

Krahasimi i rrethanorit dhe gjymtyrëve të tjera të fjalisë.



Ilustrim me shembuj. Kryefjalë: **Nata** ishte me hënë.

Kundrinor: Ku e kaluat **natën**?

Përcaktor: Zhurmat e **natës** mbërrinin njëherësh me errësirën.

Kryefjalë: **Netëve** bënte ftohtë.

Nxënësit shkruajnë diagramet dhe shembujt në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Gjetja e rrethanorëve të vendit dhe të kohës dhe e fjalëve të tyre drejtuese.
- Dallimi i rrethanorëve nga gjymtyrët e tjera të fjalisë.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë rrethanorin, përcaktojnë llojin e tij dhe përcaktojnë se me çfarë është shprehur.

Vlerësohen nxënësit që krahasojnë rrethanorin me gjymtyrët e tjera të fjalisë.


Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 5, f. 121. – Ndërttoni një fjali me katër gjymtyrë të ndryshme dhe rishkruajeni atë sipas të gjitha varianteve të mundshme.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|--|------------------------|--|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">dallon rrethanorin e shkakut dhe qëllimit;përcakton se me çfarë është shprehur rrethanori i shkakut dhe i qëllimit. | | Fjalët kyçe: - rrethanor shkak, rrethanor qëllimi, mbiemër foljor. | |

| | |
|--|---|
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur dhe në grup</i> | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Veprimtari paraprake</i></p> <p>Nxënësit lexojnë fjali me katër gjymtyrë të ndryshme, të rishkuara sipas të gjitha varianteve të mundshme.</p> <p>Me teknikën “Stuhi mendimi”, u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për rrethanorin e shkakut dhe të qëllimit.</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; margin: 20px 0;"> <div style="border: 1px solid gray; border-radius: 50%; width: 150px; height: 100px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; background-color: #f0f0f0;">Rrethanori i shkakut</div> <div style="border: 1px solid gray; border-radius: 50%; width: 150px; height: 100px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; background-color: #f0f0f0;">Rrethanori i qëllimit</div> </div> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”.</i></p> <p>Përmes “Stuhi mendimi”, mësuesi/ja tregon se me se shprehet rrethanori i shkakut dhe i qëllimit, si dhe fjalët e tyre drejtuese.</p> <div style="margin-top: 20px;"> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="text-align: center;"> <div style="border: 1px solid gray; border-radius: 50%; width: 100px; height: 80px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; background-color: #f0f0f0;">Rrethanor i i shkakut</div> <div style="margin-top: 10px;"> <p>Shprehet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndajfolje - Grup emëror - Formë foljore të pashtjelluar </div> </div> <div style="text-align: center;"> <div style="border: 1px solid gray; border-radius: 50%; width: 100px; height: 80px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; background-color: #f0f0f0;">Rrethanori i qëllimit</div> <div style="margin-top: 10px;"> <p>Shprehet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndajfolje - Grup emëror - Formë të pashtjelluar foljore </div> </div> </div> <hr style="border: 0.5px solid gray; margin: 20px 0;"/> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="text-align: center;"> <div style="border: 1px solid gray; border-radius: 50%; width: 100px; height: 80px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; background-color: #f0f0f0;">Rrethanori i shkakut</div> <div style="margin-top: 10px;"> <p>Mund të varet nga një:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Folje - Mbiemër </div> </div> <div style="text-align: center;"> <div style="border: 1px solid gray; border-radius: 50%; width: 100px; height: 80px; display: flex; align-items: center; justify-content: center; background-color: #f0f0f0;">Rrethanori i qëllimit</div> <div style="margin-top: 10px;"> <p>Si fjalë drejtuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Folje - Mbiemër foljor </div> </div> </div> </div> | |

Mësuesi me “Diagram Veni”, së bashku me nxënësit paraqet dallimet mes rrethanorit të shkakut dhe rrethanorit të qëllimit.



Nxënësit shkruajnë diagramet në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Gjetja e rrethanorëve të shkakut dhe të qëllimit dhe fjalët e tyre drejtuese.
- Dallimi i rrethanorëve të shkakut nga rrethanorët e qëllimit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë rrethanorin e shkakut nga ai i qëllimit.

- Vlerësohen nxënësit që përcaktojnë se me çfarë është shprehur rrethanori i shkakut dhe i qëllimit.





Detyrë shtëpie:


Ushtrimi 6, f. 123. – Shkruani një letër të hapur drejtuar shokëve dhe shoqeve të klasës rreth përmirësimit të klimës bashkëpunuese në klasë. Përdorni rrethanorë shkaku dhe qëllimi, si dhe përcaktoni gjymtyrët prej të cilave varen ata.

TESTOJMË NJOHURITË GRAMATIKORE

1. Qarko shkrimin e saktë.
a. proces verbal b. procesverbal
2. Trajta e shkurtër përemërore në fjalinë:
“*Merre shtruar*”, është:
a. para foljes b. pas foljes c. në mes të foljes
3. Qarko shkrimin e saktë.
a. për shembull b. përshembull
4. Qarko alternativën e saktë:
a. Pjesëzat mohuese *nuk* dhe *s’* përdoren për ndërtimin e antonimeve.
b. Pjesëzat mohuese *nuk* dhe *s’* nuk përdoren për ndërtimin e antonimeve.
5. Qarko shkrimin e saktë.
a. ashtusi b. ashtu si
6. Në fjalinë “*Mësimi u kuptua nga nxënësit*”, *nga nxënësit*, është:
a. rrethanor mënyre
b. kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
7. Lidhëzat *që, sa, saqë* janë:
a. nënrenditëse rrjedhimore;
b. nënrenditëse qëllimore;
c. nënrenditëse krahasore-mënyrore.
8. Qarko pohimin e saktë, për: *Në çdo lokucion lidhëzor gjendet zakonisht*:
a. një lidhëz.
b. një fjalë lidhëse
c. një lidhëz ose fjalë lidhëse
9. Rrethanori në fjalinë: “*U shtang nga frika*”, është:
a. rrethanor shkaku
b. rrethanor qëllimi
10. Rrethanori i nënvizuar në fjalinë: “*Sot për sot* kështu janë rezultatet”, shprehet me:
a. formë të pashtjelluar foljore
b. grup emëror
c. lokucion ndajfoljor
11. Qarko shkrimin e saktë.
a. disavjeçar b. disa vjeçar
12. Trajta e shkurtër përemërore në fjalinë: “*Mbyllini dritaret*”, është:
a. para foljes b. pas foljes
c. në mes të foljes
13. Si fjalë drejtuese e rrethanorit të kohës mund të shërbejë një:
a. folje, mbiemër
b. ndajfolje, mbiemër prejfoljor
14. Si fjalë drejtuese e rrethanorit të vendit mund të shërbejë një:
a. folje, mbiemër prejfoljor, formë foljore e pashtjelluar
b. ndajfolje, mbiemër prejfoljor
15. Qarko shkrimin e saktë.
a. së bashku b. sëbashku
16. Rrethanori i shkakut mund të varet nga:
a. folje, mbiemër
b. ndajfolje, mbiemër prejfoljor
17. Rrethanori në fjalinë: “*Të gjithë po punojnë për mbrojtjen e ambientit*”, është:
a. rrethanor shkaku
b. rrethanor qëllimi

18. Qarko shkrimin e saktë.
a. kështuqë b. kështu që
19. Lidhëzat *që, në mënyrë që* janë:
a. nënrenditëse rrjedhimore
b. nënrenditëse qëllimore
c. nënrenditëse krahasore-mënyrore
20. Rrethanori në fjalinë: "*Përse më shikon me habi*", është:
a. rrethanor shkaku
b. rrethanor qëllimi
21. Qarko shkrimin e saktë.
a. përveçqë b. përveç që
22. Në fjalinë: "*Shkruan me kujdes*", *me kujdes* është:
a. rrethanor mënyre
b. kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
23. Lidhëzat *se, sepse, meqenëse* janë:
a. nënrenditëse shkakore
b. nënrenditëse kushtore
24. Qarko pohimin e saktë, për: *Sipas mënyrës së fjalëformimit lidhëzat mund të jenë*:
a. të thjeshta dhe të përngjitura
b. të thjeshta, të përngjitura dhe lokucione
25. Qarko shkrimin e saktë.
a. herëpashere b. herë pas here
26. Në fjalinë: "*Erdhi me nxitim*", *me nxitim* është:
a. rrethanor mënyre
b. kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
27. Trajta e shkurtër përemërore në fjalinë: "*Nuk më besohet kjo gjë*", është:
a. para foljes b. pas foljes
c. në mes të foljes
28. Qarko përdorimin e saktë të kllapës.
a. Bordi zgjodhi një komision [...] për të përzgjedhur punimet.
b. Bordi zgjodhi një komision (...) për të përzgjedhur punimet.
29. Lidhëzat *në, në rast se, me kusht që* janë:
a. nënrenditëse shkakore
b. nënrenditëse kushtore
30. Rrethanori i nënvizuar në fjalinë: "*Rezultatet e nxënësit u përkeqësuan për mungesë kujdesi*", shprehet me:
a. formë të pashtjelluar foljore
b. grup emëror

| | | | |
|--|-------------------------------|---|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Rrethanori i mënyrës dhe sasisë | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Dallon rrethanorin e mënyrës dhe rrethanorin e sasisë.Përcakton se me çfarë është shprehur rrethanori i mënyrës dhe rrethanori i sasisë. | | Fjalët kyçe: - rrethanor, rrethanor mënyre, rrethanor sasië, fjalë drejtuese. | |
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë e pavarur dhe në grup</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Veprimtari paraprake Nxënësit lexojnë letrat e shkruara dhe veçojnë rrethanorët e shkakut dhe rrethanorët e qëllimit. Me teknikën “Stuhi mendimi”, u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për rrethanorin e mënyrës dhe sasisë... | | | |
| <div><div><p>Rrethanori</p></div><div><p>Rrethanori</p></div></div> | | | |
| Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”. Përmes “Stuhisë së mendimit”, mësuesi tregon se me se shprehet rrethanori i mënyrës dhe i sasisë, si dhe fjalët e tyre drejtuese. | | | |
| <div><div><p>Shprehet me:</p><p>Rrethanori i sasisë</p></div><div><p>- Ndajfolje</p><p>- Grup emëror</p></div><div><p>Shprehet me:</p><p>Rrethanori i mënyrës</p></div><div><p>- Ndajfolje</p><p>- Mbiemër</p><p>- Grup emëror</p><p>- Formë të pashtjelluar foljore</p></div></div> | | | |



Nxënësit shkruajnë diagramet në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

- Gjetja e rrethanorëve të mënyrës dhe të sasisë dhe fjalët e tyre drejtuese.
- Dallimi i rrethanorëve të mënyrës nga rrethanorët e sasisë.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit, që dallojnë rrethanorin e mënyrës nga ai i sasisë.

Vlerësohen nxënësit, që përcaktojnë se me çfarë është shprehur rrethanori i e mënyrës dhe i sasisë.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 6, f.125. – Shkruani një koment të shkurtër rreth një problemi që ju shqetëson. Përdorni të gjitha llojet e rrethanorëve dhe gjeni fjalët e tyre drejtuese.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Leksikologji Tema mësimore: Homonimet (ora I) | | Situata e të nxënit: “Dhelpra dhe një shtat”, “Mbi ta”. | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |

| | |
|---|---|
| <p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcakton dhe përdor në komunikim homonimet. • Dallon kur homonimet janë të plota dhe kur ato janë të pjesshme. | <p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - homonime të plota, homonime të pjesshme, homoforma, homograme, homofone. |
| <p>Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë, vargje poetike.</p> | <p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</p> <p>Letërsi</p> |
| <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pemë mendimi, Punë e pavarur dhe në grup</i></p> | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p>Veprimtari paraprake</p> <p>Nxënësve u paraqiten disa vargje poetike në dërrasën e zezë ose në videoprojektor dhe u kërkohet të vërejnë fjalët me të zeza. Çfarë vini re?</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; margin-top: 20px;"> <div style="text-align: center;"> <p><i>Dhelpra dhe një shtat</i></p> <hr style="width: 20%; margin: 10px auto;"/> <p>...tekdo <i>vete</i> thotë me <i>vete</i>.</p> </div> <div style="text-align: center;"> <p><i>Mbi ta</i></p> <hr style="width: 20%; margin: 10px auto;"/> <p>...ku shfren me <i>kob</i> e liga ku ndeshet <i>komb</i> i ngritur krejt.</p> </div> </div> <p style="margin-top: 20px;"><i>Ndërtimi i njohurive të reja: “Pemë mendimi”.</i></p> <p>Përmes “Pemës së mendimit”, mësuesi ndërton diagramin e grupimit të homonimeve, si fjalë me formë të njëjtë e me kuptime të ndryshme.</p> <div style="text-align: center; margin-top: 20px;"> <pre> graph LR A[HOMONIMET] --> B[E PLOTA] A --> C[E PJESSHME] B --> D[I përkasin së njëjtës kategori leksiko – gramatikore.] B --> E[Përputhen në të gjitha format e lakimit apo të zgjedhimit të tyre.] C --> F[Homoformat] C --> G[Homografet] C --> H[Homofonet] </pre> </div> <p>Nxënësit shkruajnë diagramin dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.</p> | |

Mësuesi ilustron me shembuj.

Homofoma

| Folje | Emër |
|-------|-------------------|
| bredh | bredh (dru halor) |
| hap | hap (i shpejtë) |

| Folje | Emër |
|-------|------------------|
| pata | pata (shpend) |
| qepa | qepa (zarzavate) |

| Mbiemër | Emër |
|---------|--------|
| i ri | i ri-u |
| plak | plak-u |

Homografe

ari (kafshë) ari (metal)
pusi (gropë e thellë me ujë) pusi (pritë)

Homofone — *fjalë që përputhen vetëm në shqiptim, por shkruhen ndryshe.*

krim – krimb lag - lak

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

Ushtrimi 1, f. 130 - Në tekstet e dhëna nxënësit gjejnë fjalë që kanë homonime.

Ushtrimi 2, f. 130 - Plotësojnë tabelën e dhënë me kuptimet e fjalëve homonimike, duke treguar nëse janë homonime të plota apo të pjesshme.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.


Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f.138-168.

- Homonimet kanë lindur për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në gjuhë gjatë zhvillimit të saj historik.

- Rrugët e lindjes së homonimisë janë tri: *përputhja fonetike* e fjalëve prej rrënjësh krejt të ndryshme, *shpërbërja e polisemisë* dhe *formimi i fjalëve të reja*.

a. ***Përputhja fonetike*** e fjalëve prej rrënjësh krejt të ndryshme është arritur historikisht, gjatë ndryshimeve fonetike të kryera brenda gjuhës sonë.

b. ***Shpërbërja e polisemisë***. Polisemia zbërthehet kur njëri nga kuptimet e një fjale shumëkuptimshme largohet fare prej të tjerave, aq sa këput lidhjet me to dhe nën po atë veshje tingullore fillon të jetojë në gjuhë si njësi e pavarur, bëhet temë semantike për ngjizjen e kuptimeve të reja dhe, si fjalë më vete, vihet në marrëdhënie sinonimie e antonimie me fjalët e tjera, shërben si temë prodhuese për krijimin e fjalëve të reja, lidhet me të tjera fjalë në togfjalësha e në njësi frazeologjike, pra krijon lidhje të reja polisemantike, pragmatike, sintagmatike e fjalëformuese.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit, që dallojnë homonimet e plota nga ato të pjesshme.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 8, f.131. – Gjeni tituj me fjalë homonimike në gazetë e shtypit të përditshëm, duke shpjeguar kuptimin e tyre.

| | | | |
|--|-------------------------------|---|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Leksikologji Tema mësimore: Homonimet (ora II) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• Dallon homonimet e plota nga ato të pjesshme.• Vlerëson rëndësinë e përdorimeve të ndryshme stilistike të homonimeve. | | Fjalët kyçe: - homonime të plota, homonime të pjesshme, homoforma, homograme, homofone. | |

| | |
|---|---|
| Burimet: teksti mësimor, skeda, bllok gramatike, videoprojektor, tabelë. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pemë mendimi, Punë e pavarur dhe në grup</i> | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Veprimtari paraprake</i></p> <p>Nxënësit lexojnë tituj me fjalë homonimike nga gazetatat e shtypit të përditshëm, duke shpjeguar kuptimin e tyre.</p> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja: “Pemë mendimi”.</i></p> <p>Përmes “Pemës së mendimit”, mësuesi u kërkon nxënësve të plotësojnë diagramin e grupimit të homonimeve, si fjalë me formë të njëjtë e me kuptime të ndryshme.</p> <div data-bbox="159 712 1179 1064" data-label="Diagram"> <pre> graph LR A[HOMONIMET] --> B[E PLOTA] A --> C[E PJESSHME] A --> D[] B --> E[] B --> F[] C --> G[] C --> H[] D --> I[] </pre> </div> <p>Mësuesi u kërkon shembuj të homonimeve të pjesshme: <i>homoforma, homografe, homofone</i>.</p> <p><i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup</i></p> <p>Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:</p> <p>Ushtrimi 3, f. 130 – Gjeni numrin njëjës të emrave të nënvizuar. Çfarë vini re?</p> <p>Ushtrimi 4, f. 130 – Vini në numrin shumës emrat në kllapa dhe shpjegoni kuptimin e tyre leksikor.</p> <p>Ushtrimi 4, f. 130 – Përdorni në fjali homonimet: <i>kap, aparat, kyç, shenjë, anë, qe</i>.</p> <p><i>Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.</i></p> | |
| <p>Jani Thomai, <i>Leksikologjia e gjuhës shqipe</i>, Tiranë, 2006, f.138-168.</p> <p>- Si fjalë të veçanta, homonimet kanë secili zhvillimin e vet, sistemin e vet të lidhjeve me fjalë të tjera dhe mundësitë e veta për të formuar fjalë të tjera.</p> <p>- Në gjuhën e sotme shqipe numërohen rreth 500 çifte e vargje homonimesh të tipave të ndryshëm, që përfshijnë rreth 1050 fjalë.</p> | |

P.sh.:

❖ Fjala **rrjet/ë-a** f. formon togjet *rrjetë volejbolli, rrjetë tenisi, rrjetë flokësh, çorape rrjetë, bėj rrjetë, anoj rrjetën, hedh rrjetën...*

❖ Fjala **rrjet,-i** m. formon togjet *rrjeti hekurudhor, rrjeti ujitës, rrjeti i tregtisë, rrjeti i dyqaneve të shitjes, rrjeti i agjentëve.*

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë homonimet e plota nga ato të pjesshme.

Vlerësohen nxënësit që përdorin në fjali homonimet.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 7, f. 85. – Gjeni shprehje frazeologjike ose të figurshme për kuptimet e fjalëve homonime: *thikë, korr, petë, krah, tokë, orë.*

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: Tekstet informuese paraqitëse | | Situata e të nxënit: Lexohen fragmente nga lloje të ndryshme tekstesh informuese-paraqitëse: <i>memorandumet, broshurat, fletëpalosjet, CV-të, vërtetimet, kërkesat, raportet vjetore, procesverbalet, relacionet, letrat zyrtare, njoftimet, ftesat, shpalljet, recensione etj.</i> | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Përdor strategjitë e të lexuarit dhe bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve. Kupton tekste të llojeve të ndryshme. Analizon tekstin, veçoritë dhe strukturën e tij. Identifikon karakteristika të formës të teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti, evidenca, indeksi, fjalorthi, tabela e përmbajtjes (kapitulli, prologu, epilogu) etj. Analizon veçoritë gjuhësore të një teksti. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Tekst informues-paraqitës, problem-zgjidhje, shkak-pasojë, krahasim-kundërvënie, përshkrim-renditje, ngjyrimë emocionale. | |
| Burimet: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari | |

Kompetencat kyçe:
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Kompetenca e të menduarit
Kompetenca e të nxënit
Kompetenca personale
Kompetenca qytetare
Kompetenca digjitale

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Diskutim krahasues mbi vëzhgim, Diagrami i Venit, Stuhi mendimi, Skemë rreze, Organizuesi grafik i analogjisë, Praktikë e udhëhequr hap pas hapi, Punë në grupe


ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Veprimtari paraprake - Stuhi mendimi

Lexohen fragmente të ndryshme tekstesh informuese-paraqitëse.

Krijohet një mjedis diskutimi krahasues për llojet e teksteve joletrare: përshkrues, rrëfyes, argumentues.

Diagrami i Venit ndihmon aktivizimin e nxënësve në këtë krahasim.




- qëllime të ndryshme;
- elemente të ndryshme strukturore;
- elemente të ndryshme formale.

Zhvillimi i situatës

Hapi i dytë – Leksion i përqendruar

- Llojet e teksteve informuese-paraqitëse.
- Karakteristikat strukturore të teksteve informuese paraqitëse.

Me të dhënat e grumbulluara, si dhe me ndërhyrjet e mësuesit, plotësohet **skema rreze** e mëposhtme:



Problem-zgjidhje: ku autori parashtrohet një problem dhe tregon se si mund të zgjidhet ky problem.

Shkak-pasojë: tregohen shkaqet përse një dukuri ka ndodhur dhe paraqiten pasojat e kësaj dukurie.

Krahasim-kundërvënie: paraqiten të përbashkëtat dhe ndryshimet e dy a më shumë dukurive.

Përshkrim-renditje: të dhënat renditen ose përshkruhen duke u nisur nga e veçanta tek e përgjithshmja ose e anasjella.

Hapi i tretë - Organizuesi grafik i analogjisë

- Elemente të formës së teksteve informuese-paraqitëse.

| <i>Tekstet informuese-paraqitëse</i> | <i>Tekstet argumentuese</i> | <i>Tekstet përshkruese</i> |
|---|---|--|
| <i>Fragmenti:</i> pjesë e marrë veçmas ose e shkëputur nga një tekst burimor. | Struktura e teksteve argumentuese përbëhet nga: | Struktura tipike e një tekstit rrëfyes lidhet me këto elemente: |
| <i>Tabela e përmbajtjes:</i> pjesa që pasqyron strukturën e tekstit, kapitujt dhe nënkapitujt që përbëjnë tekstin. | Parashtrimi: është pjesa në të cilën paraqitet çështja/tema. | Vendi ku po zhvillohen ngjarjet. |
| <i>Prologu:</i> një pjesë hyrëse më vete, që i paraprin tekstit kryesor. | Teza: pikëpamje a ide, që shtrohet si e vërtetë dhe mbrohet me anë të argumenteve. | Koha kur zhvillohen ngjarjet (koha e ngjarjes) dhe kur tregohen ato (koha e rrëfimit). |
| <i>epilogu:</i> pjesa në fund të tekstit që shërben si koment ose si përfundim. | Argumentet: arsyetimet që përdoren për të vërtetuar ose për të kundërshtuar një tezë; provat që sillen për të mbrojtur ose për të hedhur poshtë një qëndrim. | Personazhet ose njerëzit që marrin pjesë në historinë që po rrëfëhet. |
| <i>kapitulli:</i> secila nga pjesët kryesore të njëpasnjëshme, në të cilat ndahet lënda e një libri. | Antiteza: gjykimi që i kundërvihet tezës. | Hyrja ose parashtrimi i problemit/i çështjes për të cilën po rrëfëhet. |
| | Përfundimet: përgjithësisht është pjesa në të cilën ripohohet teza. | Konflikti/synimi ose pika kyçe rreth së cilës organizohet e gjithë historia. |
| | | Ngjarjet përbëjnë një ose më shumë përpjekje nga ana e personazhit kryesor, për të arritur synimin ose për të zgjidhur problemin. |
| | | Zgjidhja është rezultati i përpjekjeve për të arritur një qëllim të caktuar. |

Hapi i katërt - Punë në grupe

Nxënësit punojnë në grupe ushtrimet në tekstin mësimor.

Ushtrimi 1:

Fragmenti 1 është shkëputur nga një memorandum.

Fragmenti 2 është tekst argumentues.

Fragmenti 3 është relacion.

Fragmenti 4 është artikull shkencor.

- Karakteristikat gjuhësore që i bashkojnë fragmentet e ushtrimit 1 janë:
 - Gjuha e përdorur nuk përmban figura letrare.
 - Janë përdorur fjali të gjata me lidhëza bashkërenditëse dhe nënrenditëse.
 - Ka fjali shkakore, filluese.
 - Kanë gjuhë standarde.
 - Kohët foljore janë e kryera, e tashmja, e kryera e thjeshtë.
 - Faktet shprehen nëpërmjet shifrave, emrave të përveçëm.

Ushtrimi 4: Shqyrtohet gjuha e përdorur në tekste e biologjisë, fizikës duke u përqendruar te fjalitë, kohët e foljeve, fjalët teknike, termat) dhe struktura sipas së cilës është dhënë informacioni në tekst.

Vërehet se:

- Gjuha e teksteve informuese-paraqitëse është pa ngjyime emocionale dhe pa figura letrare.
- Tekstet janë të pasura me fjalë teknike dhe terma.
- Nuk janë përdorur përemra në vetën e parë njëjës ose shumës, kështu shmangen gjykimet dhe qëndrimet subjektive ndaj informacionit që paraqitet.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë veçoritë e tekstit;
- analizojnë strukturën e tekstit;
- identifikojnë karakteristika të formës të teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti, evidenca, indeksi, fjalorthi, tabela e përmbajtjes etj.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për analizën e strukturës së tekstit informues-paraqitës;
- për analizën gjuhësore të tekstit informues-paraqitës.

Detyrë shtëpie:

Gjeni në gazetë shkrime me natyrë informuese-paraqitëse nga rubrika e ekonomisë dhe tregoni si përdoren grafikët dhe evidencat.

| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|------------------------|---|-----------|
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Klasifikimi i parafjalëve sipas rasave (ora I) | | Situata e të nxënit: “Trëndafili në gotë” | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Dallon parafjalët në fjali.Përcakton rasën e parafjalëve.Krahason parafjalët me klasat e tjera të fjalëve (pjesët e tjera të ligjëratës). | | Fjalët kyçe: - parafjalë, parafjalë të rasës emërore, parafjalë të rasës gjinore, parafjalë të rasës kallëzore, parafjalë të rasës rrjedhore. | |
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, fisha, skemë, tabelë, fragment nga “Trëndafili në gotë” | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Letërsi | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Puna me fisha, Pemë mendimi, Punë në grup</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <i>Veprimtari paraprahe</i> | | | |
| Mësuesi/ja paraqet në fisha ose në videoprojektor disa fjali të shkëputura nga fragmenti “Trëndafili në gotë”. U kërkohet nxënësve të nënvizojnë parafjalët. | | | |
| Fisha 1. <div>At vit ranë aq shira, sa s’mbahen mend ndonjëherë. Filluan që në janar dhe s’pushuan deri në fund të qershorit. Kjo më kujtohet, pasi ka qenë koha kur kam shkruar më shumë tregime dhe artikuj se çdo herë tjetër, ngaqë nuk dilja nga dhoma për t’u marrë me zbavitje të kota. Prandaj një pjesë e mirë e romaneve dhe tregimeve të kolegëve të mi, që u botuan gjatë atij viti, kishin faqe të tëra me peizazhe me shi dhe erëra.</div> | | | |

Fisha 2.

Atë kohë jetoja **në** një qytet të vogël se kisha marrë një leje të gjatë krijuese për të shkruar një libër **me** tregime. Kisha zënë një dhomë **në** hotel dhe çdo ditë deri natën vonë, shkruaja; kur mërzhitesha lexoja lloj-lloj librash që kisha marrë **me** vete. Drekën dhe darkën i haja **në** restorant, **në** katin e parë të hotelit, kurse mëngjesin zakonisht **në** dhomë. Të gjithë banorët e qytetit më njihnin, kurse **me** njerëzit që shërbenin në hotel e në restorant isha bërë si i shtëpisë.


Fisha 3.

Por nuk e kam fjalën **për** shirat e shumta që ranë atë vit. Desha të tregoj për disa ngjarje të çuditshme që ndodhën **me** mua atë kohë.

Në restorant kisha tryezën time, ku nuk ulej asnjë njeri tjetër. Kamerierja që shërbente ishte një vajzë e re **me** sy të kaltër të bukur dhe **me** një gërshet të gjatë, si ai i heroinave të këngëve të folklorit. Sa vija unë, ajo vraponte **në** kuzhinë dhe porosiste gjellët që më pëlqenin...

Ndërtimi i njohurive të reja: Pemë mendimi,

Mësuesi/ja ndërton skemën në tabelë:

**Të mbajmë mend!**

- *Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shpreh marrëdhënie varësie mes fjalëve që lidhen me anë të saj.*
- *Si rregull, një parafjalë përdoret vetëm në një rasë të caktuar. Bëjnë përjashtim parafjalët **ndaj** dhe **për** që përdoren me dy rasa.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimi 1, f. 140.

Nxënësit grupojnë parafjalët sipas rasave.

Emërore Gjinore Kallëzore Rrjedhore

Diskutohet së bashku me nxënësit.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë parafjalët në fjali.


Vlerësohen nxënësit që përcaktojnë rasën e parafjalëve.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 6, f. 141.

Shkruani një lajm rreth panairit të fundit të librit, duke përdorur parafjalë të rasave të ndryshme.

| | | | |
|--|-------------------------------|---|-----------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Morfologji Tema mësimore: Klasifikimi i parafjalëve sipas rasave (ora II) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Dallon parafjalët nga ndajfoljet dhe emrat.Krahason parafjalët me klasat e tjera të fjalëve (pjesët e tjera të ligjëratës).Përdor në fjali të njëjtën fjalë herë si parafjalë herë si ndajfolje, ose herë si emër herë si parafjalë. | | Fjalët kyçe: - parafjalë, ndajfolje, emra. | |
| Burimet: teksti mësimor, skemë, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pemë mendimi, Punë në grup</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Veprimtari paraprake Nxënësit lexojnë lajmet e shkruara rreth panairit të fundit të librit, duke përdorur parafjalë të rasave të ndryshme. Ndërtimi i njohurive të reja: Pemë mendimi Një nxënës ndërton në tabelë një “Pemë mendimi” për klasifikimin e parafjalëve nga ana sintaksore: | | | |



Të mbajmë mend!

- Fjalët **afër, para, prapa, poshtë, sipër** etj., mund të dalin edhe si ndajfolje, dhe si parafjalë.

*Gjithçka ndodhi papritur, kur ai erdhi **afër**. (Ndajfolje)*

***Afër** shkollës ishte hapur një librari e re. (Parafjalë)*

- Fjalët **buzë, anë, majë** etj., mund të përdoren edhe si emra, edhe si parafjalë.

*I mbeti buzëqeshja në **buzë**. (emër)*

*U ulën **buzë** detit. (Parafjalë)*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

Ushtrimi 2, f. 140.

Nxënësit plotësojnë fjalitë me parafjalët që mungojnë në fjalitë e dhëna.

Ushtrimi 3, f. 141.

Nxënësit tregojnë nëse fjalët e nënvizuara janë emra, parafjalë apo ndajfolje.

Diskutohet së bashku me nxënësit.

Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002, f.381-388.

Nga pikëpamja e **prejardhjes**, parafjalët mund t'i ndajmë në: **të parme** dhe **jo të parme**.

- **Parafjalë të parme** janë: **mbi, me, më, ndaj, ndër, në, nën, pa, prej te(k)**.

Parafjalët e parme ndahen në: **parafjalë ndajfoljore** dhe **parafjalë emërore**.

Parafjalë ndajfoljore. Një numër ndajfoljesh (të thjeshta, të përngjitura ose lokucione) përdoren edhe si parafjalë. p.sh.: **afër, anëmbanë, anës, brenda, drejt gjatë, jashtë, këtej, krahas, larg, matanë, ndanë, nga, para, pas, përballë, përbri, përkrah, përmes, përpara, përposh, përreth, përsipër, poshtë, pranë, prapa, rreth, rrotull, sipër, tatëpjetë, tutje, veç.**

Parafjalë emërore. Përveç emrave që janë shndërruar në parafjalë, pasi janë bërë më parë ndajfolje, si p.sh.: rreth, rrotull ka edhe disa emra të tjerë që janë bërë parafjalë drejtpërdrejt, pa kaluar ndërmjet kategorisë së ndajfoljes. Këta janë: anë, ballë, bri, buzë, faqe, majë, mes, midis, rrëzë etj.

Pjesa më e madhe e parafjalëve emërore paraqiten në formë *lokucionesh* të formuara në këtë mënyrë:

a. Parafjalë + emër: *me anë, me anën, me përjashtim, me rastin, në bazë, në drejtim, në këmbë, në mes, në vend, nga ana, nga shkak, për arsye, për hir, për punë, për shkak* etj.

a. Parafjalë + emër+ parafjalë: *në krahasim me, në kundërshtim me, në lidhje me, në pajtim me, në përputhje me* etj.

- **Parafjalë jo të parme** janë ato që janë formuar me konversion nga pjesë të tjera të ligjëratës, si: *afër, larg, rreth* etj.
- Ka edhe disa **parafjalë të përngjitura** të formuara nga bashkimi i dy parafjalëve, p.sh.: *përmbi, nëpër, përveç* ose nga bashkimi i lidhëzës **si** me parafjalët *pas, mbas: sipas, simbas*.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë parafjalët nga ndajfoljet dhe emrat.

Vlerësohen nxënësit që përdorin në fjali të njëjtën fjalë herë si *parafjalë* herë si *ndajfolje*, ose herë si *emër* herë si *parafjalë*.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 4, 5 f. 141.

Formoni fjali me: afër, pranë...etj., duke i përdorur herë si *parafjalë* herë si *ndajfolje*.

Formoni fjali me: faqe, rreth...etj., duke i përdorur herë si *parafjalë* herë si *emër*.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|-----------------------|--|-----------|
| Tema mësimore: informues paraqitës | Analizë teksti | Situata e të nxënit: Shkruhet në tabelë një listë e shkurtimeve që nxënësit përdorin në komunikimin virtual (në <i>Facebook, Instagram, Viber, Ehatsapp</i>) me miqtë e tyre. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Përdor strategjitë e të lexuarit dhe bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së tekstit. • Kupton tekstin informues-paraqitës. • Analizon tekstin, veçoritë dhe strukturën e tij. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - Interneti, gjuha shqipe, alfabeti latin, sistemi i kodimit UNICODE, teknologjia informative, gjuha standarde. | |

| | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Kanalizon veçoritë gjuhësore tekstit informues-paraqitës të dhënë. • Krahason tekstin e dhënë me një tekst përshkrues. • Dallon informacionet e kërkuara në tekst. • Shpjegon kuptimin e fjalive të përdorura në tekst. • Paraqit informacione rreth temës së kërkuar duke hulumtuar rreth tyre. | |
| Burimet: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shëmbësia me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Gramatika e gjuhës |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Përvijim i mendimit, Stuhi mendimi, Lexim i drejtuar, Punë në grup, Punë e pavarur, Diagrami i Venit f. 101.</i> | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Veprimtari paraprake - Stuhi mendimi Lexohen informacion për zhargonin e të rinjve në Internet dhe për ndikimet që pëson gjuha shqipe në rrafsh sintaksor, gjatë përdorimit të saj në Internet. Zhvillimi i situatës Hapi i dytë - Përvijim i mendimit Drejtohet pyetja: A mendoni se gjuha mund të “prishet” nga të shkruarit me shkurtime? Po nga përdorimi i fjalëve e shprehjeve nga gjuhët e huaja? Lexohen sekuenca nga teksti dhe diskutohet rreth tyre. Dukuria e parë që bie në sy është se në këtë formë të komunikimit ligjërimi është i shkujdesur, pra shfaqet vernakulari i pastër i individit. Vërehet përpjekja për riprodhimin e plotë në formë të shkruar të formës së folur, përdoren format: bon (bën), du (dua), mir (mirë), koma (këmba). Më tutje, ka një prije për t’i shkruar format që shkruhen me apostrof pa apostrof (sdi ose zdi në vend të s’di, skam në vend të s’kam). Në shkrime pothuajse nuk bëhet fare dallimi midis grafemave e/ë dhe c/ç, gjë që ndodh për arsye praktike, pasi në tastierat e zakonshme këto grafema mungojnë. Vërehet mospasqyrimi në shkrim i ë-së së patheksuar dhe shkruhen <i>mir</i> e <i>un</i> në vend të <i>mirë</i> dhe <i>unë</i> , si dhe zëvendësimi i fjalës (numrit, nyjës) <i>një</i> me numrin <i>1</i> , p.sh.: “spo muj 1 her”. Një riprodhim të qëndrueshëm kanë edhe pasthirmat dhe, përveç emotikoneve, edhe format e shkruara, që synojnë të paraqesin gjendjen emocionale të bashkëbiseduesve, si p.sh.: hahaha (të qeshur), mmmm (për të shprehur kënaqësi a shije), hhhmm (për të shprehur dyshim a mendim), ufaaa (për të shprehur lodhje), phh (për të shprehur neveri) etj. | |

Hapi i tretë - Lexim i drejtuar

Lexohet teksti në faqen 143-144: Gjuha shqipe dhe Interneti

Hapi i tretë - Diagrami i Venit

Ushtrimi 2: Çfarë të përbashkëtash ka midis këtij teksti dhe një teksti përshkrues?

- Struktura është: hyrje, zhvillim, mbyllje.
- Në të dy llojet e teksteve jepet informacion.
- Në varësi të temës këto tekste mund të jenë të pasura me fjalë teknike dhe terma.
- Foljet në tekstet informuese-paraqitëse janë përgjithësisht në kohën e tashme, sidomos kur paraqitet informacion për një dukuri që i përket së tashmes, ndërsa e kryera e thjeshtë përdoret kur jepet informacion për dukuri, objekte të së shkuarës.

Hapi i katërt - Punë në grupe

Ndahet klasa në grupe dhe punohet me ushtrimet nga 3-10.

Renditni 8-10 tipare që shfaqen gjatë përdorimit të gjuhës shqipe në Internet.

- Problemi i shkrimit të shkronjave E/e dhe C/c është zgjidhur përmes zëvendësimit me simbole

(E = Alt + 0203, e = Alt + 137; C = Alt + 128, c = Alt + 135).

- Një tjetër arritje është zhvillimi i Fjalorit Elektronik të Shqipes dhe zhvillimi i fjalorëve

dygjuhësh anglisht-shqip/shqip-anglisht, si dhe fjalorë të shqipes e të disa gjuhëve të tjera botërore.

- Së fundi, makina kërkimore *Google* ka futur mundësinë e përkthimeve elektronike për shqipen në shumë gjuhë të botës dhe anasjellas.

- Kjo formë e komunikimit është e ndikuar mjaft nga anglishtja. Ndryshimi i kodit është dukuri që haset shpesh, sidomos kalimi nga shqipja në anglishte, ose ndonjë gjuhë tjetër (gjermanishte, italishte etj.). Këtu po përmendim disa njësi, të cilat janë futur nga anglishtja, sikur edhe në shumë gjuhë të tjera, edhe në shqipe: *ok* (në rregull, mirë), *np* (*no problem* – s'ka problem), *lol* (*laughing out loud* - qesh me të madhe), *yeah* (*yes* - po), *ehazz up* (*ehats up* - ç'kemi), *u* (*you* - ti), *u 2* (*you too* - ti gjithashtu), *4 u* (*for you* - për ty) etj.

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- dallojnë veçoritë e tekstit;
- analizojnë strukturën e tekstit;

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- për analizën e strukturës së tekstit udhëzues;
- për analizën gjuhësore të tekstit udhëzues.

Detyre shtëpie:

Ushtrimi 9.

Bëni një listë të shkurtimeve që ju vetë përdorni në komunikimin virtual (në *Facebook*, *Instagram*, *Viber*, *WhatsApp*) me miqtë tuaj.

| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
|---|---------------------|--|-----------|
| Tema mësimore 59: Prezantimi | | Situata e të nxënit: Paraqiten në videoprojektor sekuenca prezantimesh të ndryshme. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">shprehet qartë, saktë dhe në përputhje me tematikën, qëllimin dhe audiencën; tematikën, qëllimin dhe audiencën;organizon në mënyrë të strukturuar mendimet dhe idetë e tij gjatë të folurit;përzgjedh fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutime e në prezantime me gojë;analizon tiparet e të folurit në publik dhe vlerëson rëndësinë e tij;përcakton ngjashmëritë dhe dallimet mes të folurit në publik dhe bashkëbisedimit; | | Fjalët kyçe: - prezantim, temë, argument, pjesëmarrës | |
| Burimet: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shkumësa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK Qytetari | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Leksion i përqendruar, Praktikë e drejtuar, Punë në grupe. | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT Veprimtari paraprake - Stuhi mendimi Paraqiten me videoprojektor sekuenca prezantimesh të temave të ndryshme: Ndiqni linkun: https://www.slideshare.net Zhvillimi i situatës Hapi i dytë - Leksion i përqendruar Jepet përkufizimi i prezantimit: Prezantimi është një veprimtari paraqitëse të foluri, që realizohet përmes një takimi a ceremonie, ku dikush tregon, përshkruan ose shpjegon diçka për një grup tjetër njerëzish. | | | |

Hapi i tretë - Praktikë e drejtuar

- Hapat për të realizuar një prezantim të mirë

Zgjidhni temën e prezantimit.

Mblidhni materiale që lidhen me temën.

Bëni pyetje paraprake për të njohur interesat e pjesëmarrësve për temën e prezantimit.

- Cilët do të marrin pjesë në këtë prezantim?

- Çfarë dinë ata në lidhje me temën që do të prezantohet?

- Çfarë do të donin pjesëmarrësit të dinin në lidhje me temën që do të prezantohet?

- Çfarë dua unë t'u paraqes atyre në lidhje me temën që do të prezantoj?

Planifikoni prezantimin tuaj, duke mbajtur parasysh se përmbajtja dhe struktura e tij janë të rëndësishme dhe ndikojnë në suksesin e prezantimit (Prezantimi ka: *një hyrje, një problematikë përmbajtësore, një mbyllje të shoqëruar me përfundime.*). Tregoni kujdes me mbingarkesën e materialit, e cila mund të çojë drejt humbjes së interesit nga dëgjuesit. Thjeshtoni përmbajtjen e prezantimit, nëse është e nevojshme.

Hapi i katërt - Punë në grupe

Punohet në grupe më njëhën nga temat:

Zgjidhni njëhën nga temat e mëposhtme për të bërë një prezantim.

Vështirësitë në të lexuar.

Gjuha standarde.

Botimet e reja.

- Shkruani një listë me pyetje të cilave do t'ju jepni përgjigje gjatë prezantimit të temës.

Tema: Botimet e reja

Çfarë e bën një libër të mirë? Fabula, personazhet apo mesazhi? Lloji i librit apo mënyra e përshkrimit? I shërben ngritjes profesionale apo pasurimit emocional?

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit përgjigjen saktë;
- organizojnë në mënyrë të strukturuar mendimet dhe idetë e tyre gjatë të folurit;
- përzgjedhin fjalët e duhura për të shprehur idetë në diskutime e në prezantime me gojë;
- analizojnë tiparet e të folurit në publik dhe vlerësojnë rëndësinë e tij;
- përcaktojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes të folurit në publik dhe bashkëbisedimit.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për pjesëmarrjen në diskutime;
- për materialet e sjella në mbështetje të njohurive të reja;
- për fjalorin e përdorur gjatë diskutimit të ushtrimeve dhe përgjigjet e dhëna;
- analizën e tipareve të të folurit në publik dhe vlerësimin e rëndësisë së tij;


Detyra shtëpie:

Ushtrimi 6: Prezantoni temën tuaj para klasës.

| | | | |
|---|-------------------------------|---|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore 60: Përcaktori | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• Dallon përcaktorin dhe përcakton llojin e tij.• Tregon se me çfarë është shprehur përcaktori.• Formon fjali me përcaktorë të llojeve të ndryshme. | | Fjalët kyçe: - përcaktor, përcaktor me përshtatje, përcaktor me drejtim, përcaktor me bashkim, përcaktor me ndajshim. | |
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Punë në grup</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <i>Veprimtari paraprake</i> Me teknikën ‘Stuhi mendimi’ u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për përcaktorin si gjymtyrë e fjalisë që hyn në marrëdhënie përcaktore me fjalën drejtuese dhe bashkohet me të me lidhje përshtatjeje, drejtimi ose bashkimi. | | | |
| <div><div><div>PËRCAKTORI</div><div>Përcaktor me bashkim</div><div>Përcaktor me drejtim</div><div>Përcaktor me përshtatje</div></div></div> | | | |

Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”.

Përmes ‘Stuhi mendimi’ mësuesi tregon se cilat përdoren si fjalë drejtuese të përcaktorëve.



Të mbajmë mend!

- *Përcaktorët janë pjesë e pandashme e grupeve të fjalëve që lidhen me foljen dhe zhvendosen bashkë me fjalët e tyre drejtuese në fjali.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup, zhvillohen ushtrimet:

Ushtrimi 1, f. 149.

Nxënësit nënvizojnë përcaktorët në pjesën e dhënë.

Ushtrimi 2, f. 149.

Nxënësit klasifikojnë përcaktorët sipas tabelës.

Ushtrimi 3, f. 149.

Nxënësit zgjerojnë grupet e fjalëve me përcaktorë të ndryshëm.

Tre nxënës i zhvillojnë këto ushtrime në tabelë, ndërkohë që nxënësit e tjerë punojnë në grupe dyshe.

Diskutohen ushtrimet.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë përcaktorin dhe përcaktojnë llojin e tij.

Vlerësohen nxënësit që tregojnë fjalët drejtuese të përcaktorëve.

Vlerësohen nxënësit që formojnë fjali me përcaktorë të llojeve të ndryshme.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 5, f. 149.

Nënvizoni përcaktorët dhe qarkoni rrethanorët. Dalloni fjalët e tyre drejtuese.

| | | | |
|---|-------------------------------|--|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Llojet e përcaktorit | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Dallon llojet e përcaktorëve, me çfarë shprehen dhe fjalët e tyre drejtuese.Formon fjali me përcaktorë të llojeve të ndryshme. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">përcaktor, përcaktor me përshtatje, përcaktor me drejtim, përcaktor me bashkim, përcaktor me ndajshim. | |
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Pemë mendimi, Punë në grup</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <i>Veprimtari paraprake</i> Nxënësit lexojnë nga fjalitë e dhëna në detyrë shtëpie përcaktorët dhe rrethanorët, duke dalluar fjalët e tyre drejtuese. <i>Ndërtimi i njohurive të reja: Pemë mendimi</i> Me teknikën ‘Pemë mendimi’ paraqitet në videoprojektor ose ndërtohet në tabelë diagrami i llojeve të përcaktorëve, lidhja me fjalën drejtuese, me se shprehen ato. | | | |
| <div><div>LLOJET E PËRCAKTORËVE</div><div><div><div>Fjala drejtuese (nuk e kushtëzon formën e fjalës së varur)</div><div>Përcaktor me bashkim</div><div>Shprehet me përemër, ndajfolje, forma të pashtjelluara</div></div><div><div>Përcaktor me përshtatje</div><div>Përcaktor me drejtim</div><div><div>Fjala drejtuese (gjini, numër, rasë)</div><div>Shprehet me mbiemër, përemër, numëror</div><div>Fjala drejtuese (rasë)</div><div>Shprehet me emër në rasën gjinore, rriedhore, kallëzore</div></div></div></div></div> | | | |

Të mbajmë mend!

- *Ndajshtimi është një lloj i veçantë përcaktori, i cili shprehet me emër të pashquar dhe përshtatet në numër me fjalën drejtuese: **Nënë** Tereza i donte të gjithë njerëzit.*

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimi 1, f. 150.

Nxënësit dallojnë përcaktorët dhe thonë llojin e tyre.

Ushtrimi 2, f. 151.

Emrave të dhënë u shtojnë nga një përcaktor me përshtatje, drejtim dhe bashkim.

Ushtrimi 3, f. 151.

Nënvizojnë ndajshtimin në fjalitë e dhëna.

Tre nxënës i zhvillojnë këto ushtrime në tabelë, ndërkohë që nxënësit e tjerë punojnë në grupe dyshe.

Diskutohen ushtrimet.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë llojet e përcaktorëve.

Vlerësohen nxënësit që tregojnë se me çfarë shprehen përcaktorët.

Vlerësohen nxënësit që formojnë fjali me përcaktorë të llojeve të ndryshme.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 6, f. 151.

Plotësoni tabelën sipas modelit të dhënë dhe analizoni shembujt që jepni.

| një shportë | e vjetër | e tillë | e frutave | frutash | fruta | me fruta | djathtas | për të qenë |
|--------------|----------|---------|-----------|---------|-------|----------|----------|-------------|
| shportës | | | | | | | | |
| disa shporta | | | | | | | | |
| shportës | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |

- Formoni fjali me grupet e krijuara.

- Dalloni llojet e përcaktorëve.

- Analizoni llojin e lidhjes mes fjalës së varur dhe asaj drejtuese.

| | | | |
|--|----------------------------|---|-----------|
| Fusha: Gjuhët dhe komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Tema mësimore: Shkrimi i një eseje informuese-paraqitëse | | Situata e të nxënit: Lexohen modele të ndryshme esesh informuese-paraqitëse. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• Përcakton qëllimin, temën dhe audiencën për të cilën shkruan.• Ndjek të gjitha hapat e procesit të të shkruarit.• Kërkon dhe përzgjedh informacion në burime të ndryshme (të shtypura ose elektronike) për të mbështetur idetë e tij në punën me shkrim.• Harton një strukturë ose një skedë për tekstin që do të shkruajë. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">- eseja informuese-paraqitëse, raport shkak-pasojë, burime informuese, gjuhë objektive dhe formale, parafrazim. | |
| Burimet dhe mjetet mësimore: materiale të shtypit të shkruar, libri i nxënësit, tabela, fleep-charter, shkurtesa me ngjyra (kur është e mundur projektor ose tabelë interaktive). | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK | |
| Kompetencat kyçe: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit Kompetenca personale Kompetenca qytetare Kompetenca digjitale | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Organizues grafik, Praktikë e udhëhequr hap pas hapi, Diskutim, Punë e pavarur (shkrim i lirë).</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <i>Veprimtari paraprake - Stuhi mendimi</i> Lexohen modele të ndryshme esesh informuese-paraqitëse. Diskutohet rreth tyre. <i>Zhvillimi i situatës</i> <i>Hapi i dytë - Leksion i përqendruar</i> Eseja informuese-paraqitëse është një nga llojet e shkrimit jolettrar në të cilin autori shpjegon, informon, analizon (interpretin një çështje të veçantë në një fushë të caktuar). Në këtë lloj eseje, autori zgjedh të shtjellojë temën në forma të ndryshme, p.sh.: përkufizon, klasifikon, krahason ose e jep dukurinë në procesin shkak-pasojë. Ai e shoqëron tekstin me ilustrime, si: harta, grafike, tabela etj. | | | |

Hapi i dytë - Lexohet shkrimi informues-paraqitës dhe gjehen pesë karakteristika të tij.

1. Në të shpjegohet një fenomen: ndikimi i internetit dhe mediave sociale.
2. Mbështete në fakte dhe informacione.
3. Gjuha është formale dhe objektive.
4. Është i strukturuar në paragrafë.
5. Përdoren lidhëza dhe fjalë lidhëse specifike që krijojnë koherencën tekstuale.

Hapi i tretë - Praktikë e drejtuar

Lexohet eseja informuese-paraqitëse dhe diskutohen tiparet e saj:

Çfarë ndodh gjatë ëndrrës? Ndodh që jemi të lirë! Duket befasuese, madje dhe e pabesueshme. Jemi të lirë kur flemë, nuk mbajmë përgjegjësi për mbijetesë, nuk na duhet të fitojmë asgjë, të mbrohemi apo të përshtatemi, por mendojmë dhe ndjejmë atë që mendojmë dhe ndjejmë. Në gjumë, mendimi dhe ndijimi arrijnë maksimumin e subjektivitetit, nuk na duhet të bëjmë asgjë, mjafton thjesht të jemi. Në gjumë nuk kemi qëllime. E vëzhgojmë botën ashtu si na vjen, siç e shohim në të vërtetë dhe jo siç duhej të na shfaqej, nëse duam të arrijmë këtë apo atë qëllim. Në gjumë, inkoshienca na nxjerr në skenë. Ajo nuk është misterioze: Nënkupton që në gjumë, atë që nuk dimë kur jemi zgjuar, na duket si diçka që e dimë dhe anasjelltas: kur jemi zgjuar nuk dimë atë që, kur flemë e dimë. Me fjalë të tjera: Kur jemi zgjuar është e pavetëdijshme ajo që në gjumë është e vetëdijshme. Pra, ka të bëjë me dy nivele të ndryshme: një i vetëdijshëm ose i pavetëdijshëm në gjumë, tjetri i vetëdijshëm apo i pavetëdijshëm kur jemi zgjuar.

Kjo do të thotë që në gjumë jemi irracionalë dhe u nënshtrohemi impulseve? Shpesh po, por jo gjithmonë dhe as në të shumtën e rasteve, megjithëse Frojdi mbështet idenë, se ëndrra shpreh gjithmonë irracionalen, që i kundërvihet racionale. Ndodh që edhe në gjumë nuk duam të njohim krejtësisht vetveten. Nëse i harrojmë ato ndodh, sepse pjesa më e madhe e atyre që shohim, nuk do të përshtateshin në jetën tonë të përditshme, por do të ishin burime shqetësimesh. Në ëndërr jemi krijues, zotërojmë aftësi artistike që kur jemi zgjuar nuk i kemi, madje as dyshojmë për to.

(Shkëputur nga Erich Fromm: Ëndrra –gjuha universale e njeriut.)

Hapi i katërt - Punë në grupe

Shkruani një ese informuese-paraqitëse me temë: ***“Përdorimi i medias nga të rinjtë”***.

Nxënësit punojnë në grupe duke respektuar hapat e shkrimit të esesë.

Vlerësimi:

| <i>Shtjellimi i idesë</i> | Organizimi dhe struktura e esesë | Stili dhe origjinaliteti | <i>Saktësia gjuhësore</i> |
|----------------------------------|----------------------------------|--------------------------|----------------------------------|
| <i>2 pikë</i> | <i>2 pikë</i> | <i>2 pikë</i> | <i>2 pikë</i> |

Veprimet në situatë

Situata konsiderohet e realizuar kur:

- nxënësit shtjellojnë temën e dhënë për esenë informuese-paraqitëse;
- zbatojnë strukturën e esesë informuese-paraqitëse;
- përdorin stil dhe origjinalitet gjatë të shkruarit;
- zbatojnë rregullat e gramatikës dhe drejtshkrimit.

Vlerësimi:

Nxënësit do të vlerësohen:

- për realizimin e qëllimit, temës dhe audiencës për të cilën shkruan;
- për ndjekjen e të gjitha hapave të procesit të të shkruarit;
- për përzgjedhjen e informacionit në burime të ndryshme;
- për hartimin e një strukture ose një skede për tekstin që do të shkruajë.

| | | | |
|--|-------------------------------|--|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Përcaktori kallëzuesor (ora I) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• Dallon përcaktorin kallëzuesor dhe përcakton se me çfarë është shprehur.• Ndërton fjali me përcaktorë kallëzuesorë. | | Fjalët kyçe: - përcaktor kallëzuesor, përcaktor kallëzuesor i kryefjalës, përcaktor kallëzuesor i kundrinorit. | |
| Burimet: teksti mësimor, skedë, tabelë, bllok gramatike. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Punë në grup</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <i>Veprimtari paraprake</i> Me teknikën “Stuhi mendimi”, u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për <i>përcaktorin kallëzuesor</i> si gjymtyrë e dytë e fjalisë që krijon lidhje dyanësore në fjali: hyn në marrëdhënie rrethore me kallëzuesin dhe në marrëdhënie përcaktore me kryefjalën ose kundrinorin. | | | |
| <div><div><div>Përcaktori kallëzuesor</div><div></div></div><div>me kallëzuesin.</div><div>me kryefjalën ose kundrinorin.</div></div> | | | |


Ndërtimi i njohurive të reja: “Stuhi mendimi”.

Përmes “Stuhisë së mendimit”, mësuesi tregon llojet e përcaktorit kallëzuesor dhe me se shprehet ai.



Mësuesi konkretizon me shembuj: Duart i kishte të ftohta.

Mbiemri: të ftohta → hyn në marrëdhënie rrethimore me kallëzuesin **kishte**.
 → hyn në marrëdhënie përcaktore me kundrinorin **duart**.



Të mbajmë mend!

- *Përcaktori kallëzuesor është gjymtyrë e dytë e fjalisë që krijon lidhje dyanësore në fjali: hyn në marrëdhënie rrethimore me kallëzuesin dhe në marrëdhënie përcaktore me kryefjalën ose kundrinorin.*
- *Pozicioni i përcaktorit kallëzuesor në fjali është zakonisht pas kallëzuesit, por ai mund të zhvendoset lirshëm në fjali.*

Nxënësit shkruajnë diagramin dhe rregullat në skedë ose në bllokun e gramatikës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

Ushtrimi 1, f. 156.

Nxënësit dallojnë përcaktorët kallëzuesorë të kryefjalës nga ata të kundrinorit.

Ushtrimi 5, f. 156.

Nxënësit dallojnë pohimet e sakta mbi përcaktorët kallëzuesorë.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë përcaktorin kallëzuesor dhe përcaktojnë se me çfarë është shprehur.

Vlerësohen nxënësit që ndërtojnë fjali me përcaktorë kallëzuesorë.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 4, f. 156.

Ndërtoni fjali ku përcaktori kallëzuesor të jetë i shprehur me: *emër, grup emëror, mbiemër, përemër, formë të pashtjelluar foljore*.

| | | | |
|---|-------------------------------|--|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Përcaktori kallëzuesor (ora II) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Ndërton fjali me përcaktorë kallëzuesorë.Krahason përcaktorin me gjymtyrët e tjera të fjalisë. | | Fjalët kyçe: - përcaktor kallëzuesor, përcaktor kallëzuesor i kryefjalës, përcaktor kallëzuesor i kundrinorit, rrethanor mënyre. | |
| Burimet: teksti mësimor, skedë, tabelë, bllok gramatike. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Stuhi mendimi, Diagram Veni, Punë në grup</i> | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme.</i> Nxënësit lexojnë fjalitë ku përcaktori kallëzuesor shprehet me: <i>emër; grup emëror; mbiemër; përemër; formë të pashtjelluar foljore.</i> Mësuesi u kërkon nxënësve që ta plotësojnë diagramën: <div><div><div>Shprehet me:</div><div><div>Përcaktori kallëzuesor</div></div></div><div><div>→</div></div><div><div>- Emër</div><div>- Grup emëror</div><div>- Përemër</div><div>- Mbiemër</div><div>- Formë foljore të pashtjelluar</div></div></div> Me teknikën “Diagram Veni”, mësuesi paraqet dallimin mes përcaktorit kallëzuesor dhe rrethanorëve të mënyrës. <div><div><div>Shprehet me</div><div><div>- Emër</div><div>- Emër me parafjalë</div><div>- Emër i shoqëruar me pjesëzën <i>si</i></div><div>- Emër i shoqëruar me pjesën <i>për</i></div><div>- Përemër</div></div></div><div><div><div>Përcaktori kallëzuesor</div><div>Rrethanori i mënyrës</div></div><div><div>↕</div></div><div><div>Shprehen me</div><div><div>- Formë foljore të pashtjelluar</div><div>- Mbiemër</div><div>- Grup emëror</div></div></div><div><div>↙</div></div><div><div>↘</div></div><div><div>Shprehet me</div><div><div>- Ndajfolje</div></div></div></div></div> | | | |

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës, mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimi 3, f. 156.

Nxënësit ndërtojnë fjali me mbiemrat *i kripur, e lehtë*, duke i përdorur si përcaktorë kallëzuesorë dhe si gjymtyrë emërore e kallëzuesit emëror.

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që ndërtojnë fjali me përcaktorë kallëzuesorë

Vlerësohen nxënësit që krahasojnë përcaktorin me gjymtyrët e tjera të fjalisë.

Detyre shtëpie:

Ushtrimi 2, f. 156.

Dalloni përcaktorët kallëzuesorë nga rrethanorët e mënyrës.

| | | | |
|---|-------------------------------|--|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Lidhjet e përcaktorit kallëzuesor në fjali (ora I) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Dallon fjalët drejtuese të përcaktorëve kallëzuesorë.Dallon përshtatjen e përcaktorit kallëzuesor me kryefjalën dhe kundrinorin. | | Fjalët kyçe: - fjalë drejtuese, përcaktor kallëzuesor, kryefjalë, kundrinor. | |
| Burimet: teksti mësimor, bllok gramatike, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Punë në grup</i> | | | |

Veprimtari paraprake

| | | |
|--|---|--|
| Djali u rrit jetim, por u bë zot i vetes. | Djali i rritur jetim u bë zot i vetes. | |
| Shtypi duhet lënë i lirë për të pasur një shoqëri të pjekur. | Lënia e shtypit të lirë, është nevojë e domosdoshme | |

u rrit jetim – *i rritur* jetim

Folja u rrit → mbiemër prejfoljor i rritur
 ↓
 fjalë të varur ←
 ↓
 jetim

❖ E njëjta mënyrë praktikohet së bashku me nxënësit për fjalinë e dytë.

Mësuesi/ja paraqet një model në tabelë për foljen *lë*, e cila:

- mund të kthehet në formë foljore të pashtjelluar (*duke lënë*) dhe merr si gjymtyrë të varur një përcaktor kallëzuesor etj.

| Fjalë drejtuese | Fjalë drejtuese | Fjali |
|------------------------|------------------------|--|
| Folje e shtjelluar | kryefjalë | Shtypi duhet lënë i lirë. |
| | kundrinor | Shtypin duhet ta lënë të lirë. |
| Folje e pashtjelluar | kryefjalë | Duke u lënë shtypi i lirë, fitojnë të gjithë. |
| | kundrinor | Duke e lënë shtypin të lirë, fitojnë të gjithë. |
| Mbiemër prejfoljor | kryefjalë | Shtypi, i lënë i lirë, zhburgos mendje të ngurta. |
| | kundrinor | Nuk ia njihnin shijen shtypit të lënë të lirë. |
| Emër prejfoljor | kryefjalë | Lënia e shtypit të lirë, çliron mendje të ndrydhura. |
| | kundrinor | Lënien e shtypit të lirë, kush e vendos? |

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimi 5, f.159.

Përdorni foljen *dal* dhe plotësoni sipas modelit të dhënë në këtë mësim.

| Fjalë drejtuese | Fjalë drejtuese | Fjali |
|----------------------|-----------------|-------|
| Folje e shtjelluar | kryefjalë | |
| | kundrinor | |
| Folje e pashtjelluar | kryefjalë | |
| | kundrinor | |
| Mbiemër prejfoljor | kryefjalë | |
| | kundrinor | |
| Emër prejfoljor | kryefjalë | |
| | kundrinor | |

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dallojnë fjalët drejtuese të përcaktorëve kallëzuesorë.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 6, f. 159

Shkruani një tekst me temë të lirë dhe bëni analizën e të gjitha gjymtyrëve të dyta. Analizoni lidhjet e tyre me fjalët drejtuese përkatëse.

| | | | |
|---|---|--|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Sintaksë Tema mësimore: Lidhjet e përcaktorit kallëzuesor në fjali (ora II) | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• Dallon llojet e përcaktorëve.• Dallon përcaktorin kallëzuesor nga gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror. | | Fjalët kyçe: - fjalë drejtuese, përcaktorë kallëzuesorë, kryefjalë, kundrinor. | |
| Burimet: teksti mësimor, llok gramatike, tabelë. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve <i>Punë e pavarur dhe në grup</i> | | | |

ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT

Hapi i parë

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme.

Nxënësit lexojnë tekstet me temë të lirë dhe bëjnë analizën e të gjitha gjymtyrëve të dyta. Analizojnë lidhjet e tyre me fjalët drejtuese përkatëse.

Gjymtyrë të dyta

Kundrinor
Rrethanor
Përcaktor

Fjalët drejtuese

Hapi i dytë

Kujtojmë!

- *Ashtu si kallëzuesi, si fjalë drejtuese e përcaktorit kallëzuesor mund të shërbejë edhe një mbiemër prejfoljor.*
- *Përcaktori kallëzuesor- Shprehet me emër; emër me para-fjalë; emër i shoqëruar me pjesëzën **si**; emër i shoqëruar me pjesëzën **për**; grup emëror; përemër; mbiemër; formë foljore të pashtjelluar.*
- *Përcaktori me përshtatje - Shprehet me mbiemër; përemër; numëror.*
- *Përcaktori me drejtim - Shprehet me emër në rasën gjinore; rrjedhore; kallëzore.*
- *Përcaktori me bashkim - Shprehet me përemër; ndajfolje; forma të pashtjelluara.*

Hapi i tretë

Punë e pavarur dhe në grup

Në mënyrë të pavarur dhe në grup zhvillohen ushtrimet:

Ushtrimi 2, f.158.

Rishkruani fjalitë duke i kthyer kundrinorët në kryefjalë.

Ushtrimi 4, f.159.

Dalloni llojet e përcaktorëve (kallëzuesor, me përshtatje, me drejtim, me bashkim).

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që dinë të dallojnë llojet e përcaktorëve.

Vlerësohen nxënësit që dallojnë përcaktorin kallëzuesor nga gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 3 f.159.

Dalloni përcaktorin kallëzuesor nga gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror.

| | | | |
|--|------------------------|---|-----------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshkrim Tema mësimore: Ligjërata e drejtë | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">Dallon në ligjëraten të drejtë pjesën lajmëruese, duke shpjeguar përdorimin e shenjave të pikësimit.Shkruan drejtë ligjëraten e drejtë. | | Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë, pjesa lajmëruese, pjesa e riprodhuar, shenja pikësimi. | |
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Punë në grup | | | |
| ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT | | | |
| Veprimtari paraprake Me teknikën ‘Stuhi mendimi’ u kërkohet nxënësve të paraqesin ç’dinë për ligjëraten e drejtë. Plotësohet në tabelë diagrami. | | | |
| <div><div><div>Ligjërata e drejtë</div><div>Fjalët e autorit, ose pjesa lajmëruese</div><div>Pjesa e riprodhuar Ligjërata e drejtë</div><div>Mund të jetë<ul style="list-style-type: none">Fjali e thjeshtëFjali e përbërëNjë thënie prej disa fjalish</div></div></div> | | | |
| Të mbajmë mend! <ul style="list-style-type: none">Ligjërata e drejtë riprodhon në formë të pandryshuar nga një i tretë apo nga vetë folësi a shkruesi. Pra, në ligjërimin e mëparshëm nuk bëhet asnjë ndërhyrje. | | | |

- Në të folur, ligjërata e drejtë veçohet nga fjalët e autorit me anë të pauzës. Fjalët e riprodhuara shqiptohen me tonin e natyrshëm të bisedës.
- Në të shkruar, ligjërata e drejtë dallohet me anë të shenjave të pikësimit që vendosen sipas rregullave:
 - kur ligjërata e drejtë qëndron para dhe pas fjalëve të autorit;
 - kur fjalët e autorit futen në mes të ligjëratës së drejtë;
 - nëse ligjërata e drejtë është fjali pyetëse ose nxitëse.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup

Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.

Ushtrimi 1, 2, f. 162.

Nxënësit dallojnë në secilën ligjëratë të drejtë pjesën lajmëruese në lidhje me pjesën e riprodhuar, duke shpjeguar përdorimin e shenjave të pikësimit. Nxënësit gjithashtu tregojnë çfarë lloj fjalish janë këto ligjërata të drejta: fjali të thjeshta, fjali të përbëra apo thënie prej disa fjalish.

Vlerësimi:


Vlerësohen nxënësit që dallojnë në ligjëratën të drejtë pjesën lajmëruese, duke shpjeguar përdorimin e shenjave të pikësimit.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 6, f. 162.

Krijoni ligjërata të drejta me secilën nga fjalitë e dhëna.

| | | | |
|---|-------------------------------|---|------------------|
| Fusha: Gjuha e komunikimi | Lënda: Gjuhë shqipe | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Rubrika: Njohuri gjuhësore Drejtshkrim Tema mësimore: Ligjërata e zhdrejtë | | Situata e të nxënit: | |
| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - Kompetenca e të mësuarit për të nxënë. - Kompetenca e të menduarit. - Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit. | | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• Kthen një ligjëratë të drejtë në ligjëratë të zhdrejtë.• Kthen një ligjëratë të zhdrejtë në ligjëratë të drejtë. | | Fjalët kyçe: - ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë, shenja pikësimi. | |

| | |
|--|---|
| Burimet: teksti mësimor, videoprojektor, skemë, tabelë | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimi, Punë në grup | |
| <p style="text-align: center;">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT</p> <p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme.</i></p> <p>Nxënësit lexojnë fjalitë e krijuara (ligjërata të drejta me secilën nga fjalitë e dhëna), pastaj plotësojnë diagramin, duke rikujtuar rregullat.</p> <div style="text-align: center;">  <pre> graph TD A([Ligjërata e drejtë]) --> B[Fjalët e autorit, ose pjesa lajmëruese] A --> C[Mund të jetë - Fjali e thjeshtë - Fjali e përbërë - Një thënie prej disa fjalish] A --> D[Pjesa e riprodhuar Ligjërata e drejtë] </pre> </div> <p><i>Ndërtimi i njohurive të reja:</i></p> <p><u>Të mbajmë mend!</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>Ligjërata e zhdrejtë është riprodhim i fjalëve të një tjetri, ose i fjalëve të vetë folësit, në formë të ndryshuar, por duke e ruajtur të paprekur kuptimin e tyre.</i> <p><i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur dhe në grup</i> Për të përmbledhur njohuritë e marra në mësimin e ditës mësuesi/ja i kushton kohë zgjidhjes së ushtrimeve.</p> <p>Ushtrimi 1, 2, f. 164. Nxënësit kthejnë ligjëratën e drejtë në të zhdrejtë, dhe ligjëratën e zhdrejtë në të drejtë, duke shpjeguar ndryshimet në formë.</p> <p><i>Për mësuesit material ndihmës për këtë temë mësimore.</i></p> <p>Akademia e Shkencave e Shqipërisë, <i>Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe</i>, Tiranë, 2002, f.88-94.</p> <hr/> <p>❖ <i>Thonjëzat përdoren në ligjëratën e drejtë, për të veçuar e për të dalluar fjalët që riprodhohen nga fjalët e autorit. Ato vendosen në fillim dhe në fund të ligjëratës së drejtë.</i></p> | |

Motoja e saj janë fjalët e Naimit: “...dhe drita e diturisë përpara do të na shpjerë!”

“Dhe thonë pastaj që fëmijët grinden gjithmonë”, mendoi Eva e hidhëruar.

Sa për atë, kishte pamjen e njeriut që thotë: “Pa të shohim si do t’ia bësh tani.”

Kësaj unë iu përgjigja me një vështrim që thoshte: “Me mua s’të ecën!” dhe vazhdova rrugën.

A nuk ia kishte përsëritur aq e aq herë: “Eja ti, pa do të gjejmë ne punën?”

- ❖ *Nëse pjesa e mbyllur në thonjëza përbën një periudhë sintaksisht të pavarur nga teksti tjetër, pika që mbyll periudhën vendoset para thonjzave të fundit.*

Një mendim më rrihte si çekan në tru: “Është babai im. Është babai im.”

- ❖ *Kur fjalët që riprodhohen, formojnë fjali dëftore dhe ndodhen para fjalëve të autorit, zakonisht para thonjzave vihet presje. Në këtë rast nuk vendoset vizë mbas thonjzës së dytë.*

“Nervi është i dëmtuar, duhet operuar”, më tha kur u kthye pas pak.

- ❖ *Kur fjalët që riprodhohen ndahen në dy pjesë prej fjalëve të autorit, thonjëzat vihen në fillim e në fund, në qoftë se pas fjalëve të autorit nuk vihet pikë. Në këtë rast fjalët e autorit ndahen me presje dhe vizë nga ligjërata e drejtë.*

“Po,-i ishte përgjigjur Taku para se ta mbyllte telefonin,-më përgatit një raport me të gjitha hollësitat teknike”.

“Po atëherë, - thashë me vete,- ç’vlerë ka t’i rrisësh ato bimë pa kokrra?”

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit që kthejnë ligjëratën e drejtë në të zhdrejtë, dhe ligjëratën e zhdrejtë në të drejtë, duke shpjeguar ndryshimet në formë.

Detyrë shtëpie:

Ushtrimi 3, f. 164.

Gjeni në pjesë letrare një paragraf, ku mund të dalloni 2-3 ligjërata të zhdrejta, duke i kthyer në ligjërata të drejta.

TESTOJMË NJOHURITË GRAMATIKORE

Tremujori III

1. Qarko pohimin e saktë.

Homonimet e plota janë:

- a. Fjalë me përmbajtje leksikore krejt të ndryshueshme, por që tingëllojnë njësoj.
- b. Fjalë që përputhen pjesërisht ndërmjet tyre.

2. Fjala e nënvizuar në fjalinë:

“I mbeti buzëqeshja në buzë.”, është:

- a. emër b. parafjalë

3. Parafjalët: *me, mbi, nën, nëpër*, janë të rasës:

- a. emërore b. gjinore
- c. kallëzore d. rrjedhore

4. Qarko pohimin e saktë.

‘Përcaktori kallëzuesor’:

- a. Vendoset gjithnjë pas kallëzuesit.
- b. Vendoset zakonisht pas kallëzuesit, por ai mund të zhvendoset lirshëm në fjali.

5. Qarko pohimin e saktë.

Homoformat:

- a. Përfaqësojnë përputhjet e formave të veçanta të fjalëve.
- b. Fjalë ose trajta fonetike të njëjta, por që dallojnë nga theksi i ndryshëm.
- c. Fjalë që përputhen vetëm në shqiptim, por shkruhen ndryshe.

6. Fjala e nënvizuar në fjalinë.

“Afër shkollës ishte hapur një librari e re.”, është:

- a. ndajfolje b. parafjalë

7. Cilat fjalë mund të dalin edhe si ndajfolje edhe si parafjalë?

- a. buzë, anë, majë b. afër, para, prapa

8. Në fjalinë: *“Ky libër u bë miku më i ngushtë.”*, përcaktori kallëzuesor është:

- a. përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
- b. përcaktor kallëzuesor i kundrinorit

9. Pohimi:

Ana tha: “Kjo shkollë më pëlqen shumë.” është:

- a. Ligjëratë e drejtë
- b. Ligjëratë e zhdrejtë

10. Qarko pohimin e saktë.

Ligjërata e zhdrejtë është:

- a. Fjali e thjeshtë, fjali e përbërë.
- b. Një thënie prej disa fjalish.
- c. Riprodhim i fjalëve të një tjetri.

11. Qarko pohimin e saktë.

Homonimet e pjesshme janë:

- a. Fjalë me përmbajtje leksikore krejt të ndryshueshme, por që tingëllojnë njësoj.
- b. Fjalë që përputhen pjesërisht ndërmjet tyre.

12. Fjala e nënvizuar në fjalinë.

“U ulën buzë detit.”, është:

- a. emër b. parafjalë

13. Parafjalët: *“anë, majë, buzë, prej, për, ndaj”*, janë të rasës:

- a. emërore b. gjinore
- c. kallëzore d. rrjedhore

14. Si fjalë drejtuese e rrethanorit të mënyrës mund të shërbejë një:

- a. folje, mbiemër prejfoljor
- b. ndajfolje, mbiemër prejfoljor
- c. folje, mbiemër prejfoljor, grup emëror

- 15.** Qarko alternativën e saktë të shkrimit të ligjëratës së drejtë:
- “Motra ime flet shpesh me shumë nxitim,” - kujtoi ajo, - edhe pse e kam këshilluar disa herë.
 - “Motra ime flet shpesh me shumë nxitim, - kujtoi ajo, - edhe pse e kam këshilluar disa herë.”
- 16.** Fjala e nënvizuar në fjalinë.
Gjithçka ndodhi papritur, kur ai erdhi afër është:
- ndajfolje
 - parafjalë
- 17.** Qarko alternativën e saktë të shkrimit të ligjëratës së drejtë:
- “Sa për atë, kishte pamjen e njeriut që thotë: Pa të shohim si do t’ia bësh tani.”
 - Sa për atë, kishte pamjen e njeriut që thotë: “Pa të shohim si do t’ia bësh tani.”
- 18.** Në fjalinë: “*Këtë libër e kishte mikun më të ngushtë.*”, përcaktori kallëzuesor është?
- përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
 - përcaktor kallëzuesor i kundrinorit
- 19.** Cilat fjalë mund të përdoren edhe si emra, edhe si parafjalë?
- buzë, anë, majë
 - afër, para, prapa
- 20.** Qarko pohimin e gabuar.
Ligjërata e drejtë mund të jetë:
- Fjali e thjeshtë, fjali e përbërë, një thënie prej disa fjalish.
 - Riprodhim i fjalëve të një tjetri.
- 21.** Qarko alternativën e saktë të shkrimit të ligjëratës së drejtë:
- “Ke ndonjë ide tjetër?” - pyeti Ana.
 - “Ke ndonjë ide tjetër” - pyeti Ana?
- 22.** Qarko pohimin e saktë.
Homofonet:
- Përfaqësojnë përputhjet e formave të veçanta të fjalëve.
 - Fjalë ose trajta fonetike të njëjta, por që dallojnë nga theksi i ndryshëm.
 - Fjalë që përputhen vetëm në shqiptim, por shkruhen ndryshe.
- 23.** Parafjalët: *nga, tek (te)* janë të rasës:
- emërore
 - gjinore
 - kallëzore
 - rrjedhore
- 24.** Si fjalë drejtuese e rrethanorit të sasisë mund të shërbejë një:
- folje e shtjelluar, folje e pashtjelluar, mbiemër
 - folje, mbiemër prejfoljor, grup emëror
 - folje e shtjelluar, folje e pashtjelluar, mbiemër, ndajfolje
- 25.** Qarko pohimin e saktë.
Homografet:
- Përfaqësojnë përputhjet e formave të veçanta të fjalëve.
 - Fjalë ose trajta fonetike të njëjta, por që dallojnë nga theksi i ndryshëm.
 - Fjalë që përputhen vetëm në shqiptim, por shkruhen ndryshe.
- 26.** Cila parafjalë përdoret vetëm në një rasë të caktuar (jo me dy rasa)?
- ndaj
 - me
 - për
- 27.** Në fjalinë: “*Shikimin e kishte të mjegullt.*”, përcaktori kallëzuesor është:
- përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
 - përcaktor kallëzuesor i kundrinorit
- 28.** Parafjalët: *me anë, me anën, në drejtim, në saje, për shkak* janë të rasës:
- emërore
 - gjinore
 - kallëzore
 - rrjedhore

29. Fjala e nënvizuar në fjalinë.

“Dielli kishte perënduar në rrëzë të malit.”, është:

a. ndajfolje b. parafjalë c. emër

30. Qarko alternativën e saktë të shkrimit të ligjëratës së drejtë:

a. Motoja e saj janë fjalët e Naimit: “... dhe drita e diturisë përpara do të na shpjerë!”

b. “Motoja e saj janë fjalët e Naimit: ... dhe drita e diturisë përpara do të na shpjerë!”

